

**LEKË SHOKOLI
ILIR GËDESHI**



**TRAFIKIMI
RASTI I SHQIPËRISË**



LEKË SOKOLI, ILIR GËDESHI

Trafikimi

Rasti i Shqipërisë

Recensentë:

Eglantina Gjermeni, Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë

Silvana Haxhiaj, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), Tiranë

Korrektore letrare:

Elda Sokoli

Arti grafik:

Orest Muça

Përgatiti për botim:

Instituti i Sociologjisë, Tiranë

ISBN: 99943-937-0-7

© copyright, autorët, 2006

PËRMBAJTJA

Parathënie 5

Pjesa I: Çështje toriko-metodologjike

Hyrje: prezantimi i problemit 7
 Trafikimi, si fenomen global 11
 Trafikimi, një vështrim historik 15
 Trafikimi në Shqipëri. Një panoramë historike 19
 Rreth metodologjisë së zbatuar 23
 Të dhëna për kampionin ‘kombëtar’ dhe ‘rajonal’ të studimit 26
 Kampioni ‘kombëtar’ i studimit 27
 Veçori metodologjike të sondazhit ‘rajonal’ 29
 Profili socio-demografik i kampionit ‘rajonal’ të studimit 32
 Anët e forta dhe kufizimet e vëzhgimeve 36

Pjesa II: Trafikimi, perceptimi i përmasave dhe faktorët ndikues

Perceptimi i përmasave të trafikimit në Shqipëri 41
 Perceptimi i përmasave të trafikimit, në vartësi
 të karakteristikave socio-damografike 43
 Rasti ‘Stela’: Gjithë përmbajëja e fjalës ‘trafikim’ në një shëmbull të vetëm 48
 Perceptimi dhe ngjarjet e përjetuara të lidhura me trafikimin 50
 Perceptimi i trafikimit dhe njohja personale e të trafikuarve 53
 Babai dhe vajza e trafikuar 54

Pjesa III: Njohuritë mbi trafikimin dhe roli i edukimit

Informimi rreth trafikimit dhe burimet e tij 57
 Njohuritë mbi trafikimin, aktivitetet edukative dhe roli i tyre 60
 Përkufizimi më i saktë i trafikimit 61
 Kush mund të jetë viktimë e trafikimit? 65
 Trafikimi dhe shfrytëzimi seksual 66

Trafikimi dhe kontrabanda e qenieve njerëzore	67
Informimi dhe edukimi. Domethënia e një projekti	71

Pjesa IV: Të dhëna socio-demografike mbi të trafikuarit

Grupmoshat e të trafikuarve	76
Të trafikuarit për nga niveli i arsimimit	78
Niveli i punësimit të të trafikuarve	79
Gjendja familjare e të trafikuarve	82

Pjesa V: Mënyrat e trafikimit

Premtimet për martesë, mënyra më e zakonshme e trafikimit	83
Mashërimi për punësim në emigracion	86
Trafikimi me mashtrim për shkollim jashtë shtetit	87

Pjesa VI: Rreth shkaqeve dhe disa pasojave të trafikimit

‘Kurthi’ i varfërisë	91
Debat rreth çështjes “Pse trafikohen shqiptarët?”	93
Rënia morale dhe e krenarisë, si faktorë ndikues mbi trafikimin	96
“Nota” e vlerësimit të faktorëve që ndikojnë në trafikim	99
Trafikimi dhe shndërrimet në fushën e familjes dhe martesës	101
Trafikimi dhe problematikat gjinore	104
Dilema ‘martesë apo bashkëjetesë’ dhe ndikimi i trafikimit	106
Dilemat e vajzave ndaj djemve nën efektin ‘trafikim’	108
Trafikimi në raport me problemet e sotme të Shqipërisë	109
Rreth vicioz i trafikimit ose trafikimi si ‘shkak’ për ritrafikim	113
Pastrafikimi, familja & komuniteti	114
“Nota” e institucioneve të shoqërisë, përkundrejt trafikimit	116
Shkolla, media dhe institucionet e shtetit (refleksione e sugjerime)	117
Trafikimi dhe (mos)siguria për të ardhmen	120
Përfundime e rekomandime	122
Anketa ‘kombëtare’ e përdorur	129
Anketa ‘rajonale’ e përdorur	135
Bibliografia	141

Parathënie

Ky libër mbi trafikimin e qënieve njerëzore është frut i punës shumëvjeçare të autorëve në kuadrin e disa projekteve, mbi njohjen e fenomenit të trafikimit dhe parandalimin e tij. Projektet kanë qenë disa llojesh.

Së pari, janë disa projekte lokale, me të cilat është synuar trajtimi i problemit në komunitetet e disa rretheve të Shqipërisë, sidomos në ato të rretheve Fier, Vlorë, Berat, Korçë, Elbasan, Shkodër, Tiranë etj. Ato kanë mundur njohjen dhe trajtimin konkret të problemit në terrenin shqiptar, njohjen e një mori rasteve konkrete të trafikimit, njohjen e kompleksit të faktorëve që ndikojnë në procesin e trafikimit të qënieve njerëzore, të mënyrave të trafikimit, sikurse edhe të mënyrave e rrugëve të minimizimit apo edhe të eliminimit të këtij fenomeni.

Së dyti, janë disa projekte kombëtare, kryesisht projekte studimi e vëzhgimi, me metoda empirike të dukurisë së trafikimit. Ndër to mund të përmendim, sidomos, një sondazh ‘kombëtar’ mbi perceptimin e trafikimit dhe profilin e rrezikshmërisë së tij, të realizuar në vitin 2005, për llogari të World Learning (Washington). Mund të përmendim, gjithashtu, një numër projektesh studimore mbi varfërinë në Shqipëri, mbi emigracionin, komunitetet etnike (sidomos atë mbi komunitetin rom) etj., të sponsorizuara nga Banka Botërore, UNDP etj., në kuadrin e të cilave është hulumtar edhe problemi i trafikimit të qënieve njerëzore.

Së treti, janë disa projekte ‘rajonale’ e ndërkombëtare të realizuara nga Qendra e Studimeve Ekonomike e Sociale (CSES), ose në bashkëpunim me partnerë të tjerë. Ndër to përmendim sidomos studimin rajonal mbi perceptimin e trafikimit nga nxënësit dhe të rinjtë e Maqedonisë, Serbisë, Kosovës, Malit të Zi, Bosnje-

Harcegovinës dhe Shqipërisë, të realizuar në kuadrin e një projekti të IOM-it, gjatë vitit 2006, në të cilin, veç të tjerave, u anketuan rreth 2400 individë.

Në tërësinë e angazhimeve, studimore e botuese, të realizuara nga Qendra e Studimeve Ekonomike e Sociale, Instituti i Studimeve Politike e Sociale apo i sociologjisë dhe revista shkencore “Politika & Shoqëria”, kemi grumbulluar të dhëna të mjaftueshme, sasiore e cilësore, për një apo edhe më shumë libra mbi trafikimin. Ato janë përdorur kryesisht në raporte, referate, manuale apo edhe artikuj të ndryshëm shkencorë e publicistikë. Një pjesë e tyre është shfrytëzuar edhe për këtë punim. Por, mbi të gjitha, kemi fituar njëfarë përvojë, të cilën e kemi ndarë, kryesisht, me organizatat e shoqërisë civile, sikurse me institucione të ndryshme shqiptare e ndërkombëtare. Tani mendojmë t’u ndajmë këtë përvojë edhe me publikun e gjerë.

Ne falënderojmë të gjithë ata që sponsorizuan projektet tona. Falënderojmë, gjithashtu, partnetët dhe bashkëpunëtorët tanë, pa ndihmën e të cilëve realizimi i tyre do të ishte i pamundur. Falënderojmë, më tej, të gjithë ata individë me të ciltë kemi punuar në kuadrin e projekteve mbi trafikimin, në qytetet dhe fshatrat e Shqipërisë, në vendet e rajonit të Ballkanit e më gjerë.

Autorët

Tiranë, tetor 2006

Pjesa I: Çështje teoriko-metodologjike

Hyrje: prezantimi i problemit

Kujtdo që ka kaluar në Blinisht të Zadrimës, nuk mund të mos i kenë tërhequr vëmendjen tetë kryqe, të emërtuar “Kryqet e vajzave të masakruara”. Ato u kushtohen Gjystinës nga Fushë Arrëzi, Rajmondës nga Elbasani, Erjolës nga Korça, Lidës nga Tirana, Servetes nga Durrësi... Ndonjë prej tyre është pa emër, si për të simbolizuar të trafikuarit e tjerë të shumtë, pak a shumë siç ndodh me “ushtarët e panjohur” që simbolizojnë të rënët në luftë. Pra, viktima të trafikimit, si në një luftë të vërtetë, absurde e krejt të panjohur më parë...

Nga 23 vajza të jetimoreve të Korçës, 15 prej tyre janë trafikuar. Disa janë bërë nëna dhe ende vazhdojnë të (ri)trafikohen¹. Ndër 245 vajza të trafikuar, por të riatdhesuara, 87 prej tyre (pra 35.5 për qind), janë adoleshente, të grupmoshës 13-18 vjeç. Por edhe pjesa tjetër është trafikuar, për herë të parë, brenda kësaj grupmoshe dhe, përgjithësisht, ato kanë përsëritur ciklin e trafikimit disa herë (CRCA, 2003; Vatra, 2002)². Sipas të dhënave zyrtare, që u referohen denoncimeve të familjarëve, mbi 600 femra shqiptare rezultojnë ende të zhdukura³.

Të dhënat për trafikimin në Shqipëri janë mjaft kontradiktore. Është pohuar, për shëmbull, se vetëm në Evropën Perëndimore ka mbi 30 mijë prostituta shqiptare (shih: Çupi, 2001; Zholi, 2002; Sokoli, 2003), pa folur për vendet e tjera, duke përfshirë vetë

¹ Nga intervista me kryetarin e Shoqatës së Jetimëve-Korçë, qershor 2005

² Sipas një studimi të qendrës së riaftësisimit të femrave të riatdhesuara në Shqipëri, pas trafikimit në vendet e tjera “Vatra”-Vlorë (shih).

³ Hoxha, Edmond. 2005. Mbi femrat e zhdukura në Shqipëri. Gazeta *Metropol*, 21 korrik

Shqipërinë. Kjo shifër mund të jetë disi e zmadhuar. Aq më shumë që, sipas policisë së shtetit, numri i të trafikuarave për prostitucion⁴ është rreth pesë mijë⁵. Sidoqoftë, faktet janë tronditëse dhe dëshmojnë se trafikimi ka qenë dhe mbetet një ndër problemet e mprehta sociale të Shqipërisë paskomuniste (Gëdeshi & Sokoli, 2006).

Por trafikimi i qenieve njërëzore, në Shqipëri, ka qenë më shumë i përfolur se i studiuar. Vitet e fundit ka patur, gjithsesi, një sërë publikimesh mbi këtë dukuri, të mundësuar kryesisht nga projekte të ndryshme të organizatave të shoqërisë civile. Sado që një pjesë e tyre vuajnë për nga cilësia apo metodologjia, përsëri një numër jo i vogël studiuesish socialë janë përfshirë në studime mbi këtë tematikë⁶, ose e kanë trajtuar atë si pjesë e punimeve të tjera të tyre. Kjo ka bërë të mundur njohjen e problemit edhe me metoda empirike të hulumtimit sociologjik. Sidoqoftë studimet e derisotme mbi trafikimin janë të pjesëshme. Ato janë bërë, kryesisht, si pjesë e projekteve, të cilat nga ana e tyre janë më shumë lokale, dhe gjithënjë për një fushë konkrete veprimi, për një tematikë të dhënë. Pra ende nuk ka një studim tërësor mbi trafikimin. Nga ana tjetër, studimet e derisotme mbi trafikimin u referohen, kryesisht, viktimave të asistuar të trafikimit, pra atyre që janë kthyer dhe janë pranuar nga qendra të posaçme psiko-sociale, të krijuara vitet e fundit edhe në Shqipëri, sikurse në vendet e tjera të Evropës Juglindore. Por ato përfaqësojnë veçse një pjesë të së tërës, si në numër, ashtu edhe në problematikë.

Studimi që po paraqesim është, gjithësesi, një studim më tërësor. Ai, siç do të shohim, është bazuar në të dhëna cilësore e sasiore, të marra sidomos nga dy sondazhe (njëri ‘kombëtar’, tjetri ‘rajonal’), në të dhënat e investigimeve që autorët kanë kryer në zonat e rajonet më

⁴ Dhe, në perceptimin e shqiptarëve të anketuar, rreth ½ e tyre e konsiderojnë prostitucionin si “një veprimtari të detyruar” (Katro & Shimani, 1999), pra të lidhur me trafikimin.

⁵ Shefi i zyrës së Antitrafikut në Ministrinë e Rendit Publik, A. Jaupllari, ka pohuar se në Evropën Perëndimore ushtrojnë prostitucionin 5192 femra shqiptare (Gazeta *Shekulli*, 25 mars 2003).

⁶ Mund të përmendim, për shëmbull, studiuesit Edmond Dragoti, Zyhdi Dervishi, Gëzim Tushi, Majlinda Bregu, Eglantina Gjermani etj.

problematike në Shqipëri, sikurse në gjithë përvojën e derisotme mbi trafikimin në Shqipëri, në rajonin e Ballkanit dhe, përgjithësisht, në vendet e Evropës Juglindore.

Objekt i tij është, pikërisht, ajo pjesë e grave, adoleshentëve apo individëve shqiptarë që trafikohen, domethënë *që detyrohen nga trafikantët me forcë, me premtime për martesë, për punë apo studime jashtë shtetit, apo me forma të tjera, që të hyjnë në rrjetin e shfrytëzimit, për qëllime fitimi.*

Nga ky studim del se në perceptimin e shqiptarëve, të Shqipërisë e të Kosovës, sikurse të fqinjëve të tyre maqedonas, malazezë, serbë etj., trafikimi vazhdon të jetë mjaft shqetësim⁷. Megjithatë vlerësimet e tyre për trafikimin janë të ndryshme, shpesh, të tejskajshme. Shumica e shqiptarëve të sotëm e percepton trafikimin si një lloj tragjedie, si një “hulokaust shqiptar” (Spekter, 2003). Por ka individë që mendojnë se trafikimi zhvillon ekonominë dhe mirëqenien, e bën jetën më të mirë, më të bukur, më luksoze për shumicën e popullsisë⁸.

Të ndara janë edhe opinionet e studiuesve, për çështje të ndryshme që lidhen me trafikimin. Disa përpiqen të argumentojnë se trafikimi është një fenomen tipik shqiptar⁹. Por, nga studimi ynë, rezulton krejt e kundërta. Të tjerë studiues e lidhin trafikimin me veset e shqiptarëve. Disa, në mënyrë të habitshme, e lidhin këtë fenomen, sikurse fenomene të tjera negative të shoqërisë së sotme shqiptare, edhe me virtytet e cilësitë e tyre morale: besën, fjalën e dhënë, familjen biologjike¹⁰ etj., etj. Sidoqoftë, nga studiuesit socialë dhe opinioni i gjerë, *është pranuar se trafikimi i grave dhe adoleshentëve është një ndër dukuritë më të dhimbshme dhe më tragjike të tranzicionit paskomunist shqiptar.* Për të flitet e shkruhet çdo ditë. Sidomos mediat vazhdojnë të punojnë me kapacitet të plotë. Por analizat dhe komentet janë mbështetur më

⁷ Më shumë se 90 për qind e 1030 të anketuarve që kanë dhënë vlerësim për masën e trafikimit në Shqipëri, për shëmbull, pohojnë se trafikimi i grave dhe adoleshentëve përbën, gjithsesi, shqetësim për komunitetin e tyre.

⁸ Intervistë me një të ri nga Vlora, qershor 2005.

⁹ Shih, për shëmbull, Benzi, 2003: Parathënie

¹⁰ Shih, për shëmbull, Raufer & Quere, 2003.

shumë në histori të izoluara individësh të trafikuar, në dëshmi, gjithsesi, rrënjëthënëse të viktimave shqiptare të trafikimit¹¹, dëshmi të një jete nga e cila nganjëherë vdekja përbën të vetmen rrugëdalje¹².

Vërejmë, gjithashtu, se në studimet empirike, gjithësesi ende të pakta e të cekëta, për këtë dukuri, trafikimi përgjithësisht është identifikuar me dhunën. Dhuna, ana më e prekshme dhe, eventualisht, më e dënueshme e problemit, ka eklipsuar ndikimin e faktorëve ekonomikë, socialë, politikë, juridikë, etiko-moralë etj., që ndikojnë mbi të. Nga ana tjetër, varfëria thuhet të jetë cilësuar si shkak i parë dhe i fundit i trafikimit. Ne nuk na rezulton kështu. Varfëria është më shumë një shkak i përgjithshëm por, veç saj, ka një mori shkaqesh të tjera, të cilat nuk mund të anashkalohen. Për më tepër në njëqind vjetët e fundit, për shëmbull, Shqipëria ka kaluar në tri forma regjimi politik: monarkik (deri më 1939), komunist (deri më 1990) dhe, më pas, demokratik. Por në më të varfërit prej tyre (dy të parët) trafikimi nuk është njohur si fenomen, aq sa vetë fjala trafikim nuk ka figuruar në fjalorin e shqipes¹³. Ka pra edhe faktorë të tjerë. Ne na rezulton, gjithashtu, se shumica e të trafikuarve nuk vijnë nga rajonet më të verfra të Shqipërisë. Ka fshatra në zonat më të thella malore, në të cilat ende janë ruajtur komunitetet dhe zakonet tradicionale dhe që ende thuhet nuk e njohin trafikimin. Në këtë studim janë evidencuar edhe dy faktorë me ndikim jo të vogël në trafikimin e grave dhe

¹¹ Një libër me dëshmi të tilla është ai i disa studiuesve italianë, për shëmbull: Moroli, Emanuela & Sibona, Roberta. 2000. *Skllavet e Perëndimit. Pas gjurmëve të tregtarëve të mishit të bardhë*. Tiranë: Korbi; ose Benzi, Don Oreste. 2003. *Prostitutat do t'ju kalojnë pranë në mbretërinë qiellore*. Tiranë: Marin Barleti.

¹² Ky pohim është, për fat të keq, i vërtetë. Juliana G., 23 vjeçe, u detyrua nga bashkëshorti i saj të vetësakrifikohet, për të mos u shfrytëzuar seksualisht. Ajo i dha fund jetës vetëm një vit pas martesës, për të mos u bërë prostitutë në Itali (shih: “Zgjedh vdekjen në vend të prostitutës”, *Gazeta Korrieri*, 24 dhjetor 2000: 18).

¹³ Ky nuk është një pohim i figurshëm, por praktikisht i vërtetë. Në “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”, botim i Akademisë së Shkencave (1985: 2011), fjalës *trafikim* i është dhënë shpjegimi i vetëm: *lëvizje e njerëzve dhe mjeteve në rrugë tokësore, detare, ajrore; rrjet i qarkullimit*. Falët *trafikanë*, *i trafikuar* etj., nuk figurojnë në të. Në të tjerë fjalorë kjo fjalë ka 12 (Zingarelli, 1970:1849), deri në 20 kuptime (Websæer’s, 1989: 1502).

adoleshentëve shqiptarë: *rënia morale* dhe *rënia e krenarisë* tradicionale. Këto tema thuhet vazhdojnë të konsiderohen tabu.

Por, cila është panorama e trafikimit të grave dhe adoleshentëve në Shqipëri, si perceptohet ai, për nga përmasat dhe shkaqet, nga ç'zona (rajone) vinë të trafikuarit, cila është mosha, niveli i tyre arsimor, niveli i punësimit dhe gjendja e tyre familjare, cilat janë format më të zakonshme të trafikimit, sa të informuar janë të rinjtë, sidomos vajzat, për rreziqet e tij, nga e marrin ata këtë informacion, sa ndikon shkolla dhe edukimi në perceptimin dhe parandalimin e trafikimit, cilët janë faktorët që ndikojnë më negativisht në procesin e trafikimit dhe si vlerësohet, në perceptimet qytetare, puna e institucioneve të shoqërisë (familja, shkolla, feja, masmedia dhe institucionet e shtetit), lidhur me trafikimin?

Mbi të gjitha, ç'të bëjmë, si t'a përballojmë problemin në kushtet kur, siç pohohet, trafikantët janë mirorganizuar, kanë krijuar rrjete dhe janë të aftë për të korrupuar prokurorë, gjyqtarë, policë, politikanë etj¹⁴, kur trafikant mund të jetë kushdo: një djalë apo vajzë, një i afërm e i njohur, një polic¹⁵ apo gjykatës, një deputet apo ministër, një bashkëshort, deri një baba¹⁶ apo edhe një nënë¹⁷(!).

Këto përfaqësojnë, në thelb, objektin e këtij hulumtimi mbi trafikimin e grave dhe adoleshentëve, kryesisht në Shqipëri, por edhe në vendet e tjera të rajonit të Ballkanit.

Trafikimi si fenomen global

Në kohën tonë trafikimi i qenieve njerëzore është shndërruar në një fenomen global. Për këtë arsye të gjitha organizmat më të rëndësishme ndërkombëtare, duke filluar nga OKB-ja, kanë reaguar,

¹⁴ Sipas intervistës me prof. Luan Omari, jurist i së Drejtës, nënkryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, qershor 2005.

¹⁵ "Denoncimi i vajzës. Nis gjyqi për policin mashërues. *Gazeta Express*, 8 korrik 2005.

¹⁶ Shih, për shëmbull, dëshminë e një gruaje nga Korça që përshkruan një transaksion të bërë nga kunata e saj, një nënë që shiti vajzën e saj për prosëitucion... (De Soto, Beddies, Gëdeshi. 2005: 88).

¹⁷ Unë njoh një vajzë që u trafikua në Greqi për disa vite së bashku me të ëmën. Tani punojnë, së bashku, si prostituta në Korçë (Nga një i intervistuar në Korçë, qershor, 2005.

në forma të ndryshme dhe kanë hartuar konventa antitrafikim, për t'u ratifikuar nga vendet anëtare. SHBA-të, nga ana e tyre, përmes Departamentit të Shtetit, publikojnë në vijimësi raportin vjetor mbi trafikimin e qenieve njerëzore. Trafikimi, siç do të shohim në vijim, është i zhvilluar në të gjitha format e tij, por më i përhapuri dhe, rrjedhimisht, më i studiuar është trafikimi për shfrytëzim seksual.

Autorë të ndryshëm pohojnë se tregu i grave është shndërruar në një biznes global. Në *Globalized Female Slavery*, Onnie Wilson thekson se më shumë se katër milion gra janë shitur si skllave të seksit. Sipas vlerësimeve që ka bërë OKB-ja, vetëm në SHBA hyjnë çdo vit mbi 50 mijë gra të shitura¹⁸, që vinë kryesisht nga Ukraina, Shqipëria, Filipinet, Tailanda, Meksika dhe Nigeria. Gra nga Kina, Malejzia, Indonezia, Korea e Jugut, Kolumbia, Vietnami etj., shiten në Australi e gjetkë, për shfrytëzim seksual e pornografi.

Studiuesit pohojnë se sidomos trafikimi i grave, për t'i shfrytëzuar seksualisht, është bërë një treg "hije" multi-bilion dollarësh. Gratë trafikohen prej (vendet e origjinës së trafikimit), për në (vendet e destinacionit të viktimave të trafikimit), apo përmes (vendet e tranzitimit), çdo vendi e rajoni të botës, në mënyra që përfaqësojnë forma të skllavërisë. Vlera e "mallit seks" llogaritet të arrijë deri në 12 bilion dollarë në vit. Ky treg rezulton të jetë më fitimprurës, madje edhe më pak i rrezikshëm, përkundrejt tregut të drogës apo atij të armëve. Parabërësit, përmes këtij trafiku, kanë formuar rrjete transnacionale të trafikantëve e tutorëve që, përgjithësisht, abuzojnë ëndërrën e femrave për punë e të ardhme më të mirë. Veprimtaria e këtij rrjeti kërcënon jo vetëm mirëqenien dhe statusin social të grave, por edhe mirëqenien e stabilitetin social, politik dhe ekonomik të vendeve ku ata veprojnë.

¹⁸ SHBA-të nuk janë, siç pohojnë studiuesit, vendi me përmasat më të larta të trafikimit të grave dhe vajzave. Izraeli, sipas tyre, ka ritme më të larta të trafikimit të grave. Në një libër të botuar nga instituti izraelit "Toda'ah", thuhet se mbi katër milion gra dhe vajza i shtohen, çdo vit, botës së prostitucionit. Afërsisht 1/5 e tyre hynë në tregun e prostitucionit të SHBA-ve dhe, të paktën, tre mijë në atë të Izraelit. Por, nëse krahasojmë popullsinë e SHBA-ve e popullsinë e Izraelit, vijon libri i Toda'ah, del se përmasat e problemit në Izrael janë 2.5 herë më të mëdha se në SHBA.

Trafikimi i qenieve njerëzore është një problem madhor edhe në Evropë. Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) llogarit që në Evropë të janë mbi 2.45 milion njerëz të trafikuar, shumica gra e fëmijë¹⁹. Sidomos trafiku rus, i marrë në tërësinë e tij, është ndër më problematikët. Trafiku i grave për shfytëzim seksual është një pjesë e konsiderueshme e këtij trafiku. Sipas një vlerësimi të National Review²⁰ (janar 2003), dhjetëramijëra gra dhe vajza ruse emigrojnë çdo vit duke furnizuar tregun e prostitucionit të vendeve të Perëndimit.

Por, përgjithësisht, trafiku përfaqëson një zë të rëndësishëm në buxhetin e familjeve ruse. Sipas institutit “MiraMed”, rreth 30 përqind e rusëve kanë një familjar apo të afërm që të jetë trafikant. Kjo favorizohet nga fakti, disi i çuditshëm, se ende Rusia nuk ka ligj kundër trafikimit (!). Pjesë e këtij trafiku është edhe ai i qëneive njerëzore.²¹

Trafikimi është një realitet i të gjitha vendeve evropiane. Shumë organizata, sidomos të grave dhe të të drejtave të njeriut, kanë kërkuar që, për uljen e trafikimit, të legalizohet prostitucioni në të gjitha vendet e Komunitetit Evropian. Që ‘punonjësit e seksit’ të mos jenë më të diskreminuar, që të garantohet ‘e drejta e vetvendosjes’ dhe ‘e drejta private’, për çdo person, për t’u përfshirë apo, në të kundërt, për të mos u përfshirë në prostitucion, sikurse në veprimtaritë e tjera (Drobler 1991: 69). Pra për të kufizuar ato forma të shfrytëzimit që përfaqësojnë trafikim²². Por rezulton se edhe në vendet ku është legalizuar prostitucioni, trafikimi i femrave, për shfrytëzim seksual, është maft

¹⁹ Citimi është marrë nga: Këshilli i Evropës, Konventa mbi trafikimin e qenieve njerëzore. Tiranë, 2006, fq. 5.

²⁰ Sipas National Review, janar 2003, <http://www.nationalreview.com>. Kjo është reditja që ka bërë vetë sociologja kanadeze Onnie Wilson (2003).

²¹ Nuk është e rastit që prostitucioni i grave dhe fëmijëve ka qenë edhe në axhendën e bisedimeve të presidentëve të SHBA-ve dhe atij të Rusisë (Bush-Putin, 2003).

²² Komiteti i Grave të Parlamentit Evropian, për shëmbull, u ka kërkuar shtateve anëtare që të dekriminalizojnë prostitucionin, duke nënvizuar që “realiteti i zymtë në të cilin punojnë prostitutat, në kushtet e prostitucionit ilegal apo gjysëm legal, inkurajojnë abuzimet, si shtrëngimi e detyrimi, degradimi i kësaj veprimtarie si punë, kushtet e vështira të jetesës së prostitutave, keqtrajtimet, dhunimet deri vrasjet e tyre”. (Nursing Times ‘Into Europe’ Oct. 24, 1990).

i zhvilluar. Të marrim një shëmbull nga Holanda, “vendi i lirive seksuale”. Një OJQ-je holandeze ka evidencuar mbi 400 prostituta të mitura nigeriane (pra nga një vend i vetëm), të trafikuar, që prostitutojnë atje, të sjalla nga tregtarë të paskrupuj. Të tilla raportime bëhen nga organizata të shoqërisë civile apo institute studimore në Gjermani²³ e vende të tjera evropiane, në të cilat prostitucioni është i legalizuar.

Sipas Këshillit të Evropës, në numrin e njerëzve që, çdo vit, bien viktima të trafikimit, shumica (43 për qind, tab. 1), trafikohen për shfrytëzim seksual. Por, në shumë raste, përfundohet në punë të paguara pak ose aspak, në punë të paligjshme, nëpër ferma, punishte që shfrytëzojnë krahun e punës dhe në shtëpitë private (32 për qind) etj.

Tabela 1: Qëllimi i trafikimit për në Evropën Perëndimore

Qëllimi i trafikimit	Përqindja
Për prostitucion e shfytëzim seksual	43
Për punë të papaguar, të paguar keq, të kundraligjshme	32
Qëllime të tjera	25

(Burimi: Këshilli i Evropës. 2006. Trafikimi i qenieve njerëzore, broshurë, shih edhe www.coe.int/trafficking)

Sipas Këshillit të Evropës, trafikimi i qenieve njerëzore është i lidhur edhe me krimin e organizuar. Ndaj ai ‘duhet të luftohet me të njëjtin intensitet si edhe fenmeni i drogës apo pasërimi i parave’ (KE, 2006. 8).

Dëshmi e përhapjes së fenomenit të trafikimit në Evropë është edhe numri i viktimave të asistuar të trafikimit, për pesë vitet e fundit (tab. 2).

Trafikimi i qenieve njerëzore është i përhapur, gjithashtu, në vendet e rajonit të Ballkanit, të cilat janë kryesisht vende të origjinës e të tranzitimit të të trafikuarve. Në një masë më të kufizuar ato janë edhe vende të destinacionit të trafikimit. Pavarësisht përmasave,

²³ Vetëm gjatë Kampionatit Botëror të Futbollit (2006), u ‘aktivizuan’ mbi 40 mijë prostitute, një pjesë e tyre të trafikuar, aq sa kjo u bë temë diskutimi në Evropë dhe botë, duke përfshirë edhe takimin e nivelit të lartë SHBA-Gjermani, Bush-Merkel.

rezulton se në të gjitha vendet e rajonit ekziston edhe trafikimi i brendshëm.

Tabela 2: Numri i viktimave të asistuara të trafikimit²⁴ në vendet e Evropës Juglindore

Vendi i origjinës	2000	2001	Viti 2002	2003	2004	Shuma
Shqipëria	219	445	375	345	366	1750
Moldavia	319	382	329	313	300	1643
Rumania	163	261	243	194	193	1054
Bullgaria	46	96	164	172	143	621
Kosova	54	67	165	192	90	568
B-Herzegovina	0	0	8	17	29	54
Serbia	0	1	10	13	21	45
Maqedonia	0	0	0	14	12	26
Mali i Zi	0	0	2	3	5	10
Kroacia	0	0	1	1	6	8
Shuma	801	1252	1297	1264	1165	5779

Tabela (këtu e shkurtuar), vijon me numrin e viktimave të trafikimit, të asistuara në vendet e Evropës Juglindore, por me prejardhje nga vende të tjera, si Ukraina, Rusia, Bjellorusia, Gjeorgjia, Çekia, Hungaria, Lituania, Mongolia, Sllovakia, Sllovenia, Italia, Iraku, Maroku, Uzbekistani, Kina, Kazakistani, Tailanda, Greqia, Gjermania, Polonia dhe shumë shtete të tjera.

Burimi: Second Annual Report on Victims of Trafficking in South-Eastern Europe, 2005, fq. 31

Të dhënat për vlerësimin e numrit të viktimave të trafikimit në rajonin tonë, sado kontradiktore, janë për t'u vlerësuar. Për shëmbull, është pohuar se vetëm përmes trekëndëshit Mali i Zi - Kosovë – Serbi, kanë kaluar rreth 700 mijë femra (pa përmendur të tjerët), të destinuar për në tregun evropian të prostitucionit (Kallaba, 2002).

Trafikimi, një vështrim historik

Sot trafikimi i qenieve njerëzore përfaqëson një problem të mprehtë social. Kjo sepse: ai ka prekur një numër të konsiderueshëm personash

²⁴ Numri i 'viktimave të asistuara të trafikimit' ndryshon dhe është shumë më i vogël se numri i 'viktimave të trafikimit'. Tabela 2 u referohet vetëm atyre 'viktimave të trafikimit' që janë shkëputur nga rrjeti i trafikimit dhe janë pritur e trainuar (asistuar), në qendrat e ngritura, për këtë qëllim, në vendet e rajonit. Fakti që në disa vende nuk ka (në vite të caktuar) viktimave të asistuara (tabela), lidhet edhe me mungesën e qendrave psiko-sociale, për atë kohë.

(1), në një mënyrë që konsiderohet si e papranueshme (2), se kundrejt tij mund të reagohet (3), përmes një veprimi kolektiv e të organizuar (4). Këto, sipas studiuesve socialë, përfaqësojnë katër kushte që një problem i dhënë të klasifikohet si ‘social’²⁵. Nga krahasimi i këtij përkufizimi të problemeve sociale, me atë të trafikimit (shih, në pjesa III, ‘Përkufizimi më i saktë i trafikimit), del se trafikimi i qenieve njerëzore nuk ka qenë gjithmonë një problem social. Përgjatë historisë ka patur periudha në të cilat të ishe skllav, për shëmbull, ishte njësoj ‘normale’ sikurse edhe pronar skllavërisht. Njerëzit janë përdorur, gjithashtu, si ‘mish për top’, për shumëçka: nga fusha e luftës, deri te shtrati.

Trafikimi është shndërruar në një problem social në fazat e vonshme të zhvillimit të shoqërisë, në kohën e shembjes së skllavërisë në përgjithësi, më tej në fazat e qytetërimit e të iluminizimit, të shndërrimit të lirisë në një aspiratë universale njerëzore, sidomos me daljen në skenë të shtetit të së drejtës, me theksimin e të drejtave themelore të njeriut etj. Reagimi ndaj trafikimit mori tiparet e një veprimi kolektiv e të organizuar sidomos gjatë shekullit XX, me krijimin e institucioneve ndërkombëtare, si Lidhja e Kombeve (më pas OKB-ja), apo ato evropiane (Këshilli i Evropës, BE-ja etj.), pas Luftës së Dytë Botërore²⁶, për të mos shkuar më tej.

Nga të gjitha format e trafikimit, ai për shfrytëzim seksual është më i zakonshmi dhe më i studiuar. Prej tij mund të nxjerrim, drejtpërdrejt apo edhe tërthorazi, përfundime edhe mbi trafikimin në përgjithësi. Sepse, nga njëra anë, është pranuar, madje thuhet njëzëri, që prostitucioni është “profesioni më i vjetër në botë” (Bryan, 1968: 257). Nga ana tjetër, është provuar se prostitutat vullnetare nuk kanë mjaftuar kurrë për të ‘ngopur’ tregun e tij. Rekrutimi, përmes trafikimit, është pikërisht përgjigja ndaj kësaj kërkese.

²⁵ Sipas përkufizimit të problemeve sociale, shih: Horton B. Paul, Leslie R. Gerald, Larson F. Larson. 1991. *The Sociology of Social Problems*, New Jersey: Prentice-Hall, Inc.

²⁶ Në fakt Shqipëria, për shëmbull, ka aderuar në Konventën Ndërkombëtare për zhdukjen e tregtisë së grave e të fëmijëve, para Luftës së Dytë Botërore, qysh në tetor të vitit 1937.

Nga interesi, thuajse i jashtëzakonshëm, shkencor për të studiuar dukurinë e prostitucionit, mund të përfitohet edhe për të nxjerrë përfundime rreth mënyrave të rekrutimit të grave dhe vajzave, përgjatë historisë.²⁷ Ata që janë marrë me historinë e Romës, për shëmbull, me shkëlqimin dhe rënien e saj (Robinson, 1963; Monteskjë, 2004 etj.), kanë theksuar edhe aspekte të trajtimit e të skllavërimit të grave, pra në gjuhën e sotme, aspekte të veçanta të trafikimit²⁸.

Të dhëna interesante për rregullimin ligjor të prostitucionit femëror në Romë, afërsisht në vitet 200 para Krishtit deri në 250 pas Tij, na jep studiuesi Thomas McGinn (2002), në një libër mbi prostitucionin, seksin dhe ligjin²⁹. Në të pasqyrohet hartimi dhe përmbajtja e saktë e normave ligjore mbi prostitucionin, parë në kontekst social. Studimi, ndoshta unikal, i McGinn-it eksploron ‘përkimin’ ndërmjet sistemit ligjor dhe realitetit social – ekonomik dhe hedh dritë mbi një varg çështjesh të rëndësishme lidhur me shëresëzimin social, grupet sociale, martesën, sjelljen seksuale, familjen, skllavërinë dhe trafikimin e grave, statusin qytetar, veçanërisht statusin e gruas etj., etj.

Ende më i studiuar është, nga kjo pikëpamje, antikiteti grek. Studiuesit socialë kanë argumentuar se lindja e prostitucionit, pra edhe skllavërimi i grave për shfytëzim seksual, lidhet, së pari, me përmbysjen e raporteve midis burrave e grave, pikërisht me kalimin nga e drejta amëtare (matriarkati), në të drejtën atërore (patriarkati).

²⁷ Një numër i madh autorësh kanë studiuar përhapjen që kishte prostitucioni në Athinë e në mbarë Greqinë antike, helenike, madje edhe parahelenike (Beard & Henderson, 1997; Fantham, 1975; Houser, 1998 etj.), apo veçmas, reflektimet e tij në komeditë greke (Brown, 1990 e 1993). Të tjerë kanë studiuar këtë dukuri në Romën e lashtë apo, përgjithësisht, në botën latine (Bagnall, 1962; Edwards, 1997; Flamming etj.). Është studiuar, më tej, rregullimi ligjor i prostitucionit në qytetërimin antik mesdhetar (Ford, 1993), në Perandorinë Bizantine, në Mesopotaminë e vjetër etj. (Për më tepër shih: Sokoli, Lekë. 2006. *Prostitucioni si profesion...* Tiranë: Rinia & Instituti i Sociologjisë.

²⁸ Për shëmbull, në *Madhështia dhe rënia e romakëve* studiuesi i famshëm francez Charl Montesjè thotë (2004: 7): “Romuli dhe pasardhësit e tij ishin pothuaj përherë në luftë me fqinjët e tyre, ose për kamjen e qytetarëve, ose *për femra* (nënvizimi ynë), ose për troje dhe ktheheshin, më pas, në qytet me prenë e tyre...”

²⁹ McGinn, Thomas, A.J. 2002. *Prostitution, Sexuality, and the Law in Ancient Rome*: Vanderbilt University

Ky hap shënoi, siç thotë Engëls (1974: 226), disfatën e madhe historike të seksit femëror. Gruaja humbi, kështu, pozitën e vet të respektuar, u kthye në shërbëtore, në skllave të epsheve të burrit.

Kjo pozitë e poshtëruar e gruas shfaqet lakuriq sidomos te grekët. Te Homeri, për shëmbull, gratë e reja që kapeshin në luftë (robinat), bëheshin viktimat e epsheve të fitimtarëve. Krerët ushtarakë zgjidhnin më të bukurat me radhë, sipas rangut të tyre. Gjithë “Iliada” është thurur mbi një grindje midis Akilit dhe Agamemnonit për një skllave të tillë. Bashkë me çdo hero, pak a shumë të shënuar, të Homerit përmendet edhe ‘robina’ e tij e luftës.

Për të mos u zgjatur me shembuj të tjerë, aq të shumtë përgjatë historisë, po i referohemi Anglisë së ‘epokës viktoriane’³⁰. Studiuesit³¹ i krahasojnë përmasat e prostitucionit të kësaj periudhe me ato të tempujve të Babilonisë. Ata theksojnë, në veçanti, faktin se viktimat e para të këtij prostitucioni ishin vajzat e rrëmbyera, në gjuhën e sotme, të trafikuarat. Studiuesi anglez Rush (1980: 63-64), shkruan, për shëmbull:

Për të plotësuar kërkesat e epokës viktoriane ‘prostitutat vullnetare’ nuk mjaftonin kurrë. Meshkujt që donin seks me vajza të vogla ishin të përgatitur për të paguar një çmim të kripur...”.

Në fillim të shekullit XX, shumë njerëz vazhdonin të besonin se sëmundjet veneriane mund të kuroheshin ‘përmes aktit seksual me femijë’ (Eliade, cituar nga DeMause, 1982, fq. 58). Ndaj shumë prostituta ishin të infektuara nga sifilizi, ende pa mbushur moshën 18 vjeç (Rush, 1980). Vetë shtëpitë publike të kësaj epoke ishin qendra dhunimi e trafikimi, në kuptimin më të plotë të fjalës. Ja si e ka përshkruar një reportues (cituar nga Tenot, 1960, p.54), gjendjen e

³⁰ Kjo epokë lidhet me emrin e mbretëreshës Viktoria, e cila sundoi nga viti 1837 deri më 1901, pra plot 63 vjet. Gjatë kësaj periudhe ndikimi i rreptësisë morale të oborrit mbretëror mbi zakonet angleze që mjaft i thellë. Por pikërisht në këtë periudhë lulëzoi edhe prostitucioni dhe trafikimi më i egër i grave dhe vajzave.

³¹ Libri i Judith R. Walkowitz, me titull “Prostitution and Victorian Society. Women, Class, and the State”, është vetëm një ndër librat e shumtë, dedikuar kësaj periudhe.

shtëpive publike të epokës viktoriane, duke marrë si shëmbull atë me pronare një femër me emrin Jeffrles:

Rrahjet dhe fshikullimet në to ishin në një shkallë të paimagjinueshme. Dhomat e znj. Jeffrles kishin pajisjet e dhomave të torturave.... Në tavane kishte unaza për të varur nga kyçet e duarve gratë dhe vajzat, litarë për t'i lidhur ato në çdo qoshe, vende të ngushta ku i fushnin viktimat, që të mos mund të lëviznin gjatë aktit seksual. Ndër pajisjet e “qefit” bënin pjesë thuprat, kamxhikët, rrypat, deri prangat prej hekuri për të lidhur femrat...”

Gjurmte e trafikimit të epokës viktoriane, sidomos për trafikimin e minoreneve, gjenden edhe sot. Shfrytëzimi seksual i fëmijëve është forma më e qartë e trafikimit. Sepse ata nuk janë në moshë për vendosur për jetën e vet. Nga rreth 2,600 prostituta të arrestuara në Paris, për shëmbull, 1,500 ishin minorene (Bebel, cituar nga Rush). Ennew (1986) theksonte se gjatë epokës viktoriane ndjenjat dhe ndërjegjja publike për këtë gjendje të mjerueshme të shfrytëzimit seksual të fëmijëve nuk arriti ta frenonte atë. Përfshirja e sotme e fëmijëve në prostitucion nuk është, pra, pa precedentë. Nga epoka viktoriane vjen jehona e një oqeani faji e mëkatesh ndaj viktimave të trafikimit, sidomos të shfrytëzimit barbar të fëmijëve. Pra avazi vazhdon...

Shkurt, nëpër botë mund të gjesh një pafundësi informacioni për forma të ndryshme të trafikimit, të ushtruar përgjatë historisë. Po në Shqipëri?

Trafikimi në Shqipëri, një panoramë historike

Në studimet e disa autorëve shqiptarë, të cilave iu jemi referuar, është pohuar se në Shqipëri trafikimi, për qëllim prostitucioni apo forma të tjera shfrytëzimi për përfitim material, “nuk ka histori”. Të paktën ai nuk është kurrsesi një fenomen tipik shqipëar³². Nuk rezulton

³² Shih, për shëmbull, Sokoli, Lekë. 2005b. Prostitucioni profesionist në Shqipëri dhe debatet rreth (kqë)vlerësimit ‘prostitucioni është një fenomen tipik shqiptar’. Revisëa *Të drejtat e njeriut*. Nr. 2(42), fq. 55-72.

që ky fenomen të ketë patur përhapje të krahasueshme me shumë vende të tjera evropiane, siç është për shembull, Greqia apo Italia fqinje, vende të tjera mesdhetare, Anglia etj., në të cilat trafikimi, sidomos ai i femrave, ka lulëzuar në çdo fazë të qytetërimit të tyre. Të paktën trafikimi nuk përmendet në librat mbi historinë e Shqipërisë, në të drejtën zakonore të shqiptarëve, në libra kronikanësh, gjeografësh, albanologësh, në folklorin shqiptar etj. Ky ‘përjashtim’ lidhet, para së gjithash, me njëfarë puritanizmi karakteristik, përgjithësisht me jetën tradicionale të shqiptarëve, një jetë e mbyllur, ‘në mbrojtje’ (edhe në kuptimin ushtarak të fjalës), në një familje të mbyllur, patriarkale, në të cilën gjithçka, përfshirë edhe jetën seksuale të pjesëtarëve të saj, ishte rreptësisht e koduar dhe e kontrolluar.

Pohimi se trafikimi “nuk ka histori” duhet kuptuar si një fakt: Shqipëria, përgjithësisht, nuk ka prodhuar të tilla dukuri “së brendëshmi”. Megjithatë, Shqipëria ka qenë në udhëkryqe historike e gjeografike dhe është ‘populluar’ nga pushtues të kulturave të ndryshme: kristiano-romake, turko-islame, austro-hungareze, sllavobullgare apo sllavo-serbomalazeze, greke, italiane, gjermane etj. Rruga “Egnatia”, për shembull, që përshkon Shqipërinë, mbart një histori mbi 23 shekulle dhe, siç është logjike apo edhe siç theksohet në burime të ndryshme, përgjatë saj ka patur motele e hane në të cilat edhe seksi është ofruar si shërbim. Pohohet, madje, se në hanet e udhëtarëve këtë prostitucion e kanë ushëruar kryesisht vajza jetime, të cilat e bënin këtë shërbim veç punës së tyre³³. Por ato mund të kenë qenë edhe objekt trafikimi, në kuptimin që ka marrë sot kjo fjalë.

Shqipëria ka qenë, madje për shumë kohë, arenë luftrash të të tjerëve apo një vend i pushtuar. Megjithatë shqiptarët kanë ruajtur identitetin e tyre ‘vendor’: gjuhën, zakonet, kodin e tyre etiko-moral etj. Falë imunitetit kulturor të shqiptarëve dhe paraardhësve të tyre, pushtimet nuk ka lënë gjurmë të qenësishme, megjithë ndikimin e pamohueshëm. Këtë pohim e gjejmë edhe për pushtimin pesëshekullor osman. Por kjo periudhë, edhe përsa i përket trafikimit të grave, nuk ka kaluar pa lënë gjurmë. Në forma të ndryshme është pohuar se ka patur

³³ Cit. “Prostitucioni, holokausti shqiptar”, Revista *Spektër*, Nr. 171, 19 prill 2001, fq. 19-21.

njerëz, të vlerësuar si të degjeneruar, që trafikonin gra dhe vajza të reja shqiptare apo i bënin ato “dhuratë” për haremet e Stambollit³⁴.

Nuk vërtetohet që trafikimi i grave dhe adoleshentëve të ketë ekzistuar si fenomen edhe në gjysmën e parë të shekullit XX, kohë në të cilën vërtetohet përhapja e prostitucionit në Shqipëri, madje edhe legalizimi i tij (vitet 1920-1944)³⁵, në atë kohë e vlerësuar si masë për ruajtjen e shëndetit dhe moralit publik³⁶.

Lidhur me këtë çështje ka patur disa hulumtime, kryesisht arkivore³⁷. Dhe, nga dokumentacioni i arkivuar, del se në Shqipërinë e kësaj periudhe tregu legal i prostitucionit plotësohej vetëm ose kryesisht nga prostituta ‘vullnetare’³⁸. Pra, nuk njihet trafikimi i grave dhe vajzave për shfrytëzim seksual apo qëllime të tjera fitimprurëse. Kjo konfirmohet edhe nga burime zyrtare. Në një letërkëmbim të ministrit të Punëve të Brendshme, për shëmbull, të datës 11 shtator 1935, thuhet:

“Kam nderin t’ju parashtoj se, në Shqipëri, nuk ekziston tregtia e të bardhëve, qoftë për gra ose për djem”.

Për më tepër, në tetor 1937, Shqipëria ka aderuar edhe në konventën ndërkombëtare për zhdukjen e tregtisë së grave dhe fëmijëve.

Krejt ndryshe nga ç’ndodh sot, edhe kahja e lëvizjes së prostitutave

³⁴ Një ‘dëshmi’ të tillë e gjejmë te “Vjeshta e Xheladin Beut”, të Mitrush Kutelit (2001). Por kjo duhet marrë me rezerva, vetëm për aq sa mund të merret si ‘dëshmi’ një vepër letrare e jo shkencore (shih, Kuteli, Mitrush. 2001. *Prozë dhe vargje të zgjedhura*, Vëll. 1, Tiranë: SHB Kuteli). Për këtë çështje është prononcuar, në mënyrë kontestuese, studiuesi Enis Sulstarova në librin e tij “Arratisje nga Lindja” (2006: 116).

³⁵ Legalizimi i prostitucionit u bazua në vendim e Qeverisë nr. 196, datë 10 shkurt 1922, me të cilin u miratua rregullorja e prostitucionit. Pas miratimit në Parlament, kjo rregullore u shndërrua në ligj. (Fletorja zyrtare, nr. 30, gusht 1922, fq. 4

³⁶ Në një korespondencë qortuese të Policisë së Shtetit ndaj Prefekturës së Shkodrës, për shëmbull, që daton më 18 shkurt 1922, ndër të tjera thuhet se gratë e përgjithshme (prostitutat) janë të nevojshme për një qytet të tillë dhe *se përmes tyre ruhet shëndeti publik dhe morali i popullsisë së qytetit* (nënvizimi ynë).

³⁷ Ndër to përmendim, për shëmbull, Sokoli, Lekë. 2006a (Babai dhe vajza e trafikuar); 2006b (Integrimi dhe morali tradicional) dhe 2006c (Shtëpitë publike në Shqipëri).

³⁸ Termi ‘vullnetare’ duhet vënë gjithnjë në thonjëza, duke nënkuptuar një vullnetarizëm relativ, domethënë në raport me trafikantët, por jo me kushtet që nxisin atë.

të asaj kohe ishte “nga jashtë-brenda” dhe jo e kundërta. Pra, tregu shqiptar i prostitucionit plotësohej edhe nga femra të huaja. Por edhe ato nuk rezulton të kenë qenë të trafikuar, por vullnetare. Për shembull, në një urdhër të minisërit të Punëve të Brendshme, më 20 korrik 1936, thuhet:

“Kemi konstatuar se kohët e fundit një numër grash të huaja kanë ardhur në vendin tonë me pasaporta të rregullta, me viza të përfaqësive tona diplomatike, të cilësime si turiste. Këto gra, më shumë greke e hungareze, në realitet nuk janë turiste, por prostituta dhe vinë në Shqipëri për të ushëruar profesionin e kurvërisë”.

Vendosja e regjimit komunist në Shqipëri (1944-45), i dha fund epokës së prostitucionit profesionist të krijuar deri në atë kohë. Por ai, gjithashtu, nuk lejoi kurrfarë trafikimi të grave, adoleshentëve e, përgjithësisht, të qenieve njerëzore. Madje edhe lufta kundër këtij lloji trafikimit (“plagë e kapitalizmit”) vlerësohej si pjesë e luftës së klasave, ndërsa të trafikuarit, të droguarit, prostitutat etj., konsideroheshin si ‘të hedhurit tej të shoqërisë’³⁹.

Por regjimi komunist e evitoi trafikimin “me mënyrën e vet”, madje pa patur ndonjë ligj antitrafik. Këtë e pohon edhe akademiku i intervistuar Luan Omari, profesori i së Drejtës, i cili thotë:

“Para viteve ‘90-të, në Shqipëri nuk njihej koncepti i trafikantëve dhe i trafikimit dhe Kodi Penal parashikonte të dënohej, madje ashpër, vetëm ushërimi i prostitucionit”.

Në Shqipëri trafikimi i grave dhe adoleshentëve filloi pas vitit 1990, në kushtet e mungesës së një ligji antitrafik. I pari ligj që konsideronte si vepër penale trafikimin e qenieve njerëzore u miratua vetëm në vitin 1995. Po ky ligj rezultoi të kishte mangësi ndaj, në janar 2001, ai u përmirësua. Në shkurt 2004, u miratuan disa amendamente në Kodin Penal. Sipas ligjit në fuqi, trafiku i femrave për prostitucion dënohet me burgim nga 7-15 vjeç. Ndërsa kur trafikimi ka çuar në

³⁹ Mund të shihet, për shëmbull, Alia, Ramiz. 1986, fq. 153.

vdekjen e viktimave, trafikanti dënohet deri me burgim të përjetshëm etj. Por, siç do të shohim më poshtë, niveli i zbatimit të ligjeve antitrafik ka qenë, në këto vite, i ulët, ose ato janë zbatuar njëanshmërisht: më shumë ndaj viktimave të trafikimit se ndaj trafikantëve.

Pra, deri në reagimin e shtetit shqiptar u desh shumë kohë. Kjo kohë ishte e mjaftueshme për trafikantët. Trafikimi mori përmasa aq të mëdha saqë për karakterizimin e tij analistë e studiues kanë përdorur termin “hulokausti shqiptar”.

Nga ky parashërim del se trafikimi i grave dhe adoleshentëve nuk lidhet aq me faktorë historikë e të traditës, me psikologjinë sociale dhe vetjake të shqiptarëve apo me karakterin e temperamentin e tyre. Tanzicionalistët i kanë shpjeguar dukuritë e reja sociale të tranzicionit paskomunisë shqiptar si dukuri të lidhura jo me komunitetet e vogla e jetën tradicionale por, përkundrazi, me shembjen e këtyre komuniteteve dhe komercializimin e marrëdhënieve shoqërore. Me disa përjashtime, thujse e njëjta tablllo historike vërtetohet edhe në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, pra në shumicën e vendeve të përfshira në pjesën ‘rajonale’ të këti punimi.

Rreth metodologjisë së zbatuar

Për realizimin e këtij studimi janë zbatuar metodikat bazë të studimeve empirike. Është shfrytëzuar, si pikënisje, një bibliografi relativisht e gjerë me libra, studime, artikuj shkencorë apo edhe të shtypit të përditshëm, të autorëve shqiptarë e huaj që kanë shkruar më parë për trafikimin dhe kontrabandën e qenieve njërëzore e probleme të lidhura me to. Në këtë punim janë shënuar referencat bibliografike respektive, jo vetëm si dëshmi e punës hulumtuese të autorëve, por për t’u orientuar lexuesin në burime autentike të informacionit, lidhur me trafikimin, kryesisht të grave dhe adoleshentëve. Shfrytëzimi i kësaj ‘përvoje të mëparshme’ ka ndihmuar në qartësimin e problemeve për të cilat është kërkuar informacioni sasior e cilësor.

Autorët e këtij studimi nuk janë kufizuar vetëm në statistika apo burime zyrtare. Kjo sepse, sidomos për veprimtaritë e zhvilluara në mënyrë të kundëraligjeshme, ato janë gjithnjë të paplota. Gjithashtu,

ata që kanë provuar të studiojnë, para nesh, trafikimin kanë pohuar se institucionet shtetërore nuk u përgjigjen kërkesave për informim, për shkak të burokracisë apo edhe të neglizhencës së tyre⁴⁰.

Nga ana tjetër, objekt i këtij studimi është, kryesisht, hulumtimi i perceptimit të qytetarëve mbi trafikimin e grave dhe të adoleshentëve, apo edhe niveli i njohurive të tyre, para dhe pas trainimeve që janë bërë. Kjo është realizuar përmes metodikave sasiore dhe cilësore të grumbullimit të të dhënave, dëshmime dhe fakteve mbi trafikimin.

Metoda bazë e përdorur për grumbullimin e të dhënave është *anketimi*. Studiuuesit hartuan dy anketa, të përshtatshme për procesin e përpunimit sasior të të dhënave dhe, njëherësh, të kuptueshme dhe të lehtë për t'u plotësuar nga përgjigjedhënesit. Anketat ishin të koduara, me pyetje të mbyllura (një shifër për çdo alternativë përgjigje). Hartimi i aketave ka qenë një proces kalimi të shkallëzuar nga një anketë me pyetje të hapura, në një anketë me pyetje të mbyllura. Varianti përfundimtar i anketave të mbyllura (me alternativa të paravendosura), është arritur përmes konsultimesh e debatesh mes ekspertëve sociologë, psikologë dhe ekonomistë të QSES, ISPS dhe institucioneve të tjera, duke përfshirë edhe ekspertë të stafit të World Learning dhe CAAHT-it (Washington), për anketimin 'kombëtar' apo të IOM-it, për anketimin 'rajonal'.

Pjesë e këtij procesi kanë qenë edhe një seri testimesh me grupe individësh të moshave të ndryshme të cilët, gjithashtu, u shndërruan në 'hartues' të pyetsorit të anketimit. Pyetsori i parë (ai 'kombëtar') përbante 53 pyetje (ose nënpyetje). Çdonjëra prej tyre kishte nga 2-10 alternativa përgjigjesh, gjithsej me rreth 330 alternativa të mundshme. Ndërsa pyetsori i dytë (ai 'rajonal') kishte 29 pyetje, me rreth 150 alternativa të mundshme përgjigjesh.

Intervista dhe bashkëbisedimi në grup ishte një tjetër metodë paralele, ndihmëse, e zbatuar në kërkim të fakteve dhe opinioneve mbi perceptimin e trafikimit të grave dhe adoleshentëve, në Shqipëri e më gjërë. Në rastin e Shqipërisë studiuuesit kanë komunikuar në grupe me 8-10 persona, të krijuara në çdonjërin nga të gjashtë qarqet që u përfshinë në studim. Bashkëbisedimi është realizuar

⁴⁰ Shih, për shëmbull, Children's Human Rights Center, 2003, fq. 12.

në katër ‘grupe fokusi’ për çdo qark, të përbëra respektivisht me gra (pavarësisht moshës), adoleshentë (të rinj e të reja të grupmoshës 16-19 vjeç), sikurse me djem dhe vajza të grupmoshës nën 16 vjeç, grupmoshë e cila nuk është përfshirë në anketimin ‘kombëtar’. Në çdo rast komunikimi i studiuesit me grupin është bërë nëpërmjet pyetjeve e përgjigjeve me gojë dhe gjysëm të strukturuar. Bashkëbisedimet janë inçizuar dhe, si rregull, bashkëbiseduesit e intervistuar nuk kanë qenë, njëherësh, edhe të anketuar. Kjo është bërë për të zgjeruar numrin e individëve të përfshirë në këtë hulumtim dhe, nga ana tjetër, për të marrë një informacion paralel, pra për të verifikuar, aq sa ka qenë e mundur, informacionin e marrë me metoda të tjera. Megjithatë, në disa raste, është thelluar informacioni i marrë nga të anketuarit (veç anketës), sidomos kur ata kanë patur një opinion, një histori personale të lidhur me trafikimin ose ndonjë sugjerim.

Me interes të veçantë kanë qenë *intervistaë individuale* që hartuesit e këtij punimi kanë realizuar me ekspertë dhe studiues, përfaqësues të OJQ-ve që merren drejtpërdrejt me trafikimin siç ishte, për shëmbull, ajo me drejtues të qendrës psiko-sociale “Vatra” - Vlorë, një qendër pritëse e grave dhe vajzave të trafikuar dhe që punon për riaftësimin dhe integrimin e tyre, sikurse me drejtues të organizatave të grave në rrethet respektive ose edhe në Tiranë (kur veprimtaria e tyre është shtrirë në rrethet e përfshira në studim). E rëndësishme është që, në kuadrin e këtij punimi, përmes intervistave të drejtpërdrejta të studiuesve, janë marrë mbi 450 prononcime, opinione apo sugjerime individësh.

Meriton të theksohet fakti se, si shumatore, numri i individëve të anketuar dhe të intervistuar në projektet hulumtuese, të dhënat e të cilave paraqiten në këtë punim, është mbi katër mijë. Këtu përfshihen të anketuarit dhe të intervistuarit e sondazhit ‘kombëtar’ (1030 të anketuar dhe 450 të intervistuar, ose opiniondhënës me shkrim), si dhe të anketuarit dhe të intervistuarit e sondazhit ‘rajonal’ (2399 të anketuar, veç të të intervistuarve).

Pra, metoda kryesore e aplikuar në këtë punim është ajo e të testuarit të problemit. Por, veç saj, është përdorur, sado pak, edhe *metoda historike*. Përmes botimeve të mëparshme, sidomos përmes materialeve e dokumentave të Arkivit të Shtetit, çështja e trafikimit të qenieve njerëzore

është parë historikisht, të paktën nga fillimi i shekullit XX e në vijim.

Së fundi, gjatë gjithë këtij punimi është zbatuar gjerësisht *metoda krahasuese*, gjithnjë si metodë e hulumtimit sociologjik. Kjo, së pari, për të ballafaquar përvojën shqiptare me atë të vendeve të tjera të rajonit. Kjo metodë është zbatuar, së dyti, me qëllim që problemi i trefikimit të shihet në *dinamikën* e tij dhe jo vetëm me përmasat dhe problematikën e tij, në një çasë të dhënë (qershor-korrik 2005, sondazhi ‘kombëtar’ dhe mars-maj 2006, sondazhi ‘rajonal’). Së treti, përmes metodës krahasuese, është bërë e mundur që perceptimi dhe përmasat e trafikimit e çështje të lidhura me të, të vlerësohen në vartësi të një numri relativisht të madh variablesh apo faktorësh që u korespondojnë karakteristikave të ndryshme socio-demografike të individëve që janë përfshirë në këtë studim, pra të vetë perceptuesve të problemit. Të tilla karakteristika, ose variable janë grupmosha, niveli arsimor, përkatësia gjinore, vendbanimi, përkatësia etnike, përkatësia fetare apo niveli i besimit fetar, migrimi i brandëshëm apo ndërkombëtar etj. etj.

Me këto metoda, të gërshetuara me njëra-tjetrën, është mundësuar vlerësimi i kompleksit të faktorëve politikë, ekonomikë, juridikë, socialë, moralo-psikologjikë, historikë e të traditës etj., që kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë në shkallën e trafikimit të grave dhe adoleshentëve shqiptarë.

Të dhëna për kampionin ‘kombëtar’ dhe ‘rajonal’ të studimit

Një pjesë e pyetjeve të anketave, ‘kombëtare’ apo ‘rajonale’, siç ndodh zakonisht në studimet empirike, u kërkonin të anketuarve disa të dhëna për karakteristikat personale e sociale të tyre, si vendbanimi, mosha, gjinia, gjendja civile, niveli arsimor, përkatësia etnike e fetare, përbërja familjare etj. Këto, nga njëra anë, për të kontrolluar shkallën e përfaqësueshmërisë së pjesës së zgjedhur si ‘kampion’ studimi, në raport me të dhënat e gjithë popullsisë dhe që ka të bëjë me shkallën e vërtetësisë së përfundimeve të përgjithësuara. Nga ana tjetër, kjo ka mundësuar përdorimin e *metodës krahasuese* në analizën e të dhënave sociologjike që përmbajnë përgjigjet e të anketuarve me karakteristika të ndryshme moshore, të gjinisë, edukimit, vendbanimit etj.

Kampioni 'kombëtar' i studimit⁴¹

Kampioni 'kombëtar' i studimit përbëhet nga 1030 përgjigjedhënës, të ndara në 6 prefektura (qarqe). Pra, me rreth 170 persona të anketuar, për çdonjerin nga të gjashtë qarqet në të cilat u shtri ky studim. Në tabelat e mëposhtme (tab. 3-9), janë pasqyruar të dhënat rreth të anketuarve që përbëjnë kampionin 'kombëtar' të këtij studimi.

Tabela 3: Të anketuarit e kampionit 'kombëtar', sipas vendbanimit.

Të anketuarit sipas:	Të dhënat për të anketuarit	Përgjigjet e marra	
		Në numër	Në përqindje
<i>Vendbanimit</i>	Qytete të mëdha	513	49.8
	Qyteza	234	22.7
	Në fshatra	283	27.5
	<i>Gjithsej</i>	<i>1030</i>	<i>100.0</i>

Tabela 4: Të anketuarit e kampionit 'kombëtar', sipas grupmoshës⁴².

Të anketuarit sipas:	Të dhënat për të anketuarit	Përgjigjet e marra	
		Në numër	Në përqindje
<i>Grupmoshare</i>	16-18 vjeç	282	27.4
	19-21 vjeç	378	36.7
	Mbi 21 vjeç	370	35.9
	<i>Gjithsej</i>	<i>1030</i>	<i>100.0</i>

Tabela 5: Të anketuarit e kampionit 'kombëtar', sipas gjinisë.

Të anketuarit sipas:	Të dhënat për të anketuarit	Përgjigjet e marra	
		Në numër	Në përqindje
<i>Gjinisë</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>1030</i>	<i>100.0</i>
	Femra	698	67.8
	Meshkuj	332	32.2
	<i>Gjithsej</i>	<i>1030</i>	<i>100.0</i>

⁴¹ Burimi, për tabelat 3-9, sikurse për gjithë sondazhin 'kombëtar' (siç e kemi quajtur në këtë punim), është anketa sociologjike me 1030 përgjigjedhënës të qarqeve Kukës, Shkodër, Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë, qershor 2005.

⁴² Moshë mesatare e të anketuarve të kampionit 'kombëtar' të sondazhit është 21.9 vjeç.

Tabela 6: Të anketuarit e kampionit 'kombëtar', sipas shkallës së arsimimit

Të anketuarit sipas:	Të dhënat për të anketuarit	Përgjigjet e marra	
		Në numër	Në përqindje
<i>Shkallës së arsimimit (arsimi që kanë kryer apo vazhdojnë)</i>	<i>Cjthsej</i>	1030	100.0
	I (e) pashkolluar	12	1.2
	Fillor	18	1.7
	Tetëvjeçar	144	14.0
	I mesëm	388	37.7
	I lartë	468	45.4
	<i>Cjthsej</i>	1030	100.0

Tabela 7: Të anketuarit sipas gjendjes civile e llojit të familjes (numrit të kurorave)

Të anketuarit sipas....	Të dhënat për të anketuarit	Përgjigjet e marra	
		Në numër	Në përqindje
<i>Gjendjes civile</i>	Beqar	776	75.3
	I(e) martuar	213	20.7
	I (e) divorcuar	31	3.0
	I (e) ve	10	1.0
	<i>Cjthsej</i>	1030	100.0
<i>Llojit të familjes (numrit të kurorave ose çifteve)</i>	Me shumë kurora	210	20.5
	Me një kurorë	743	72.5
	Me një prind	72	7.0
	<i>Cjthsej</i>	1025	100.0

Tabela 8: Të anketuarit sipas përkatësisë etnike dhe asaj fetare

Të anketuarit sipas....	Të dhënat për të anketuarit	Përgjigjet e marra	
		Në numër	Në përqindje
<i>Përkatësisë etnike</i>	Shqipëar etnik	920	89.3
	Rom ose egjiptian	39	3.8
	Grek	47	4.6
	Vllah	9	0.9
	Maqedonas	9	0.9
	Të tjerë	6	0.6
	<i>Cjthsej</i>	1030	100.0
<i>Përkatësisë fetare</i>	Musliman	678	65.8
	Ortodoks	218	21.2
	Katolik	86	8.3
	Bektashi	27	2.6
	Të tjerë	21	2.1
	<i>Cjthsej</i>	1030	100.0

Veç të dhënave të mësipërme, për të anketuarit janë shtruar edhe disa pyetje të tjera të cilat kanë të bëjnë me shndërrimet e gjithanshme të ndodhura në Shqipëri, pas vitit 1990, duke synuar që të hulumtohet ndikimi i tyre mbi trafikimin e grave dhe të adoleshentëve. Të tilla janë

ato që lidhen me migrimin e brendëshëm (në kushtet e lirisë së lëvizjes), me nivelin e besimit fetar (shoqëria shqiptare e para viteve '90-të ishte zyrtarisht ateiste), me integrimin në familje (të qëndruarit larg familjes është një ndër dukuritë e sotme), etj. Të dhënat janë pasqyruar në tabelën 9.

Tabela 9: Të anketuarit lidhur me migrimin e familjes së tyre, nivelit të besimit fetar dhe të kohëqëndrimit pranë ose larg familjes

Të anketuar	Të dhënat për të anketuarit	Përgjigjet e marra	
		Në numër	Në përqindje
<i>Që kanë ndryshuar ose jo vendbanimin pas vitit 1990</i>	Nuk kanë ndryshuar vendbanimin	761	73.9
	kanë ndryshuar vendbanimin	269	26.1
<i>Sipas shkallës së besimit fetar</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>1030</i>	<i>100.0</i>
	Besoj shumë	506	49.1
	Besoj pak	347	33.7
	Jam indiferentë	125	12.1
	Jam ateisë	52	5.0
<i>Që shumicën e kohës e kalojnë ose jo në familje</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>1030</i>	<i>100.0</i>
	Pranë familjes	824	80.2
	Larg familjes	204	19.8
	<i>Gjithsej</i>	<i>1028</i>	<i>100.0</i>

Veçori metodologjike të sondazhit 'rajonal'

Metodologjia e përdorur në rastin e studimit 'rajonal' lidhet me qëllimin e vetë projektit të IOM-it. Përmes sondazhit 'rajonal' është synuar që të hulumtohej ndikimi i informimit dhe edukimit në perceptimin dhe parandalimin e trafikimit, si dhe efektiviteti i metodologjive të përdorura gjatë aktiviteteve edukative shkollore (brenda programit shkollor, apo jashtë tij), nëpërmjet krahasimit të nivelit të njohurive të nxënësve dhe të rinjve për trafikimin dhe kontrabandën, mënyrat e realizimit të tyre dhe reagimet e mundshme.

Në mënyrë më specifike, sondazhi ka synuar që të matej niveli i njohurive nga nxënësit e të rinjtë për trafikimin dhe kontrabandën; kuptueshmëria e situatave të ndryshme dhe sjellja e mundshme e tyre (parandalimi); të japeshin disa rekomandime për përsosjen e mënyrave të informimit të nxënësve, disa modele të përfshirjes së tyre në programet mësimore apo të përdorimit të veprimtarive jashtëshkollore për këtë qëllim. Duke ndjekur këto objektiva është investiguar niveli i njohurive, perceptimi dhe sjellja e nxënësve dhe të rinjve kundrejt trafikimit dhe

kontrabandës në shkollat dhe OJQ-të e Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Maqedonisë, Kosovës, Serbisë dhe Malit të Zi⁴³.

Puna analitike e këtij studimi është bazuar kryesisht në të dhëna sasiore, të realizuara nëpërmjet një ankeëe me 2399 nxënës dhe të rinj, nga të cilët 18.3 për qind në Shqipëri, 13.1 për qind në Bosnje-Hercegovinë, 23.4 për qind në Maqedoni, 17.8 për qind në Kosovë dhe 27.3 për qind në Serbi-Mali i Zi. Këta nxënës dhe të rinj ishin të shpërndarë në 50 shkolla (86.8 për qind) dhe në 25 OJQ (13.2 për qind).

Por, krahas *teknikave sasiore* edhe në këtë studim, sikurse në atë 'kombëtar' janë përdorur edhe disa *teknika cilësore* të cilat kanë shërbyer për evidencimin e problemeve për secilin nga vendet e përfshirë në studim. Edhe në këtë rast ekipi i sondazhit ka *intervistuar* drejtues dhe mësues shkollash, drejtues të OJQ-ve dhe ekspertë të trafikimit, për precizimin e pyetjeve të anketës dhe përcaktimin e metodologjisë së sondazhit.

Por, burimi kryesor i informacionit është *anketimi sociologjik*. Anketa përmbante 28 pyetje të strukturuar. Plotësimi i saj kërkonte rreth 30 minuta. Varianti fillestar i anketës u testua me nxënës të niveleve të ndryshme në dy shkolla të qytetit të Tiranës, pas të cilit u bënë përshtatjet dhe korigjimet e nevojshme. Më pas, anketa u përkthye në gjuhët e secilit vend ballkanik dhe u konsultua me ekipet respektive. Bazuar në vërejtjet dhe sugjerimet e tyre u hartua varianti përfundimtar i anketës.

Ekipet e sondazhit përbëheshin nga studiues, punonjës socialë dhe studentë kryesisht me përvoja të mëparshme në realizimin e anketimeve. Një kriter në përzgjedhjen e tyre ishte aftësia për të komunikuar për çështje sensitive dhe për të krijuar besim me nxënësit dhe të rinjtë e moshës shkollore, si dhe me grupet me prejardhje të ndryshme sociale dhe etnike. Ekipet u trainuan, lidhur me qëllimin dhe objektivat e studimit, përmbajtjen e anketës, mënyrën e realizimit të saj dhe aspekte të tjera të këtij sondazhi. Kështu u përgatit një metodologji të përbashktë për të gjitha vendet e rajonit.

Përzgjedhja e shkollave dhe OJQ-ve që do të përfshiheshin në këtë

⁴³ Anketimi është realizuar pak para referendumit që shënoi mëvetësimin e Malit të Zi. Ndaj në këtë sondazh Serbia dhe Mali i Zi janë paraqitur së bashku.

studim është bërë nga misionet e IOM-it në vendet e rajonit, në bashkëpunim me ministrinë respektive të arsimit. Janë përzgjedhur shkolla të niveleve dhe profileve të ndryshme, si 9 vjeçare, të mesme të përgjithshme, të mesme profesionale dhe të mesme mikse. Ky diversitet është mbajtur parasysh edhe në përzgjedhjen e OJQ-ve.

Anketimi i nxënësve dhe të rinjve u bë për dy grupe. Nga të anketuarit 1387 prej tyre kishin marrë pjesë në kurset e trainimit, mbi trafikimin dhe kontrabandën, të organizuara nga IOM-i. Ata përfaqësojnë kategorinë “të trainuar” (ose *Activity Group*). Ndërsa 1012 nxënës dhe të rinj nuk kishin marrë pjesë në kurse të tilla. Në këtë studim ata përfaqësojnë kategorinë “të patrainuar” (ose *Control Group*)⁴⁴.

Në përzgjedhjen e nxënësve dhe të rinjve u përdor kombinimi i metodës së qëllimshme dhe të rastit. Metoda e qëllimshme synonte në përzgjedhjen e nxënësve dhe të rinjve nga “të trainuar” dhe “të patrainuar”. Ajo synonte, gjithashtu, në ruajtjen e një ekuilibri midis djemve dhe vajzave në kampionin e studimit. Ndërsa metoda e dytë synonte në përzgjedhjen e rastit të nxënësve dhe të rinjve brenda grupeve të mësipërme, sipas një procedure të njëjtë për të gjitha vendet pjesëmarrëse. Në secilën prej shkollave përzgjedhja e individëve është bërë në këtë mënyrë:

1. Ekipi ka kontaktuar, si fillim, me drejtuesin e shkollës dhe mësuesin që ka realizuar trainimin, ka prezantuar qëllimin e studimit dhe ka siguruar miratimin dhe bashkëpunimin e tyre për realizimin e anketimit.

2. Janë përcaktuar klasat që do t'i nënshëroheshin anketimit, duke patur parasysh që të kishte klasa me “të trainuar” dhe “të patrainuar”.

⁴⁴ Rreth 58 për qind e nxënësve dhe të rinjve të anketuar ishin trainuar, para anketimit, nga IOM-i lidhur me trafikimin dhe kontrabandën e qenieve njerëzore dhe çështje të lidhura me to. Fillimisht IOM- Tirana, në bashkëpunim me Institutin e Kurrikulave dhe Standardeve në Ministrinë e Arsimit, hartoi modulet e trainimit për mësuesit. Në një fazë të dytë u bë trainimi i 2-3 trainuesve nga secili vend pjesëmarrës. Këta trainues zyrtarë të IOM-it kanë realizuar, më pas, trainimin me mësuesit e shkollave apo të OJQ-ve, në secilin vend (një për çdo shkollë/OJQ). Në fazën e fundit është realizuar trainimi i masës së nxënësve dhe të rinjëve. Anketimi është realizuar paralelisht, për kategorinë “të trainuar” dhe “të patrainuar”, për të evidencuar rolin e informimit dhe edukimit në perceptimin e trafikimit e parandalimin e tij.

3. Bazuar në regjistrat e klasave janë hartuar dy lista për çdo klasë, një për vajzat dhe një për djemtë. Kjo është bërë për të patur një numër afërsisht të barabartë midis tyre.

4. Nga listat e veçanta janë përzgjedhur individët, sipas një rendi të paravendosur (me numrat rendorë 4, 8, 12, 16 etj). Në këtë mënyrë rreth $\frac{1}{4}$ e nxënësve të listave të hartuara kanë plotësuar pyetsorin.

5. Nxënësit e përzgjedhur janë futur në një klasë të veçantë, jo më shumë se një në çdo bankë dhe, në mënyrë të pavarur, pa komunikuar me njëri-tjetrin, kanë plotësuar anketën.

Thuajse e njëjta procedurë është ndjekur edhe për OJQ-të. Në rastet kur të rinjtë, për shkak të mungesës së arsimimit, nuk ishin në gjendje të plotësonin vetë anketën, atëhere realizimi i saj është bërë nga anketuesit, sipas metodës *face to face* (në formë interviste).

Sikurse në sondazhin ‘kombëtar’, edhe në atë ‘rajonar’, të gjitha anketat janë hedhur në kompjuter dhe janë përpunuar në programin SPSS⁴⁵.

Profili socio-demografik i kampionit ‘rajonar’ të studimit

Të dhënat sasiore të kampionit ‘rajonar’ të këtij punimi tregojnë përbërjen e tij sipas shtetësisë, gjinisë, grup-moshës, vend-banimit, nivelit arsimor, tipit të shkollës që vazhdojnë, përvojave migratore etj. Përbërja, sipas shteteve, është pasqyruar në tabelën 10.

Tabela 10. *Nxënësit dhe të rinjtë e anketuar sipas shteteve*

Shtetet pjesëmarrëse	Të anketuar	
	Në numër	Në përqindje
Shqipëria	440	18.3
Bosnje-Hercegovina	315	13.1
Maqedonia	562	23.4
Kosova	427	17.8
Serbi-Mal i Zi	655	27.3
Shuma	2399	100

Burimi: Anketa sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

⁴⁵ Banka e të dhënave, të kompjuterizuara në sistemin SPSS, për të dy sondazhet, ndodhet në arkivin e Qendrës së Studimeve Ekonomike e Sociale (QSES), Tiranë.

Rreth 52 për qind e të anketuarve janë femra dhe 48 për qind janë meshkuj. Këto shmangie nga orientimi për të patur një kampion studimi të ekuilibruar (afërsisht 50 me 50 për qind), të cilat janë më të mëdha në Kosovë dhe më të vogla në Maqedoni, lidhen vetëm me strukturën gjinore të klasave ose të OJQ-ve që janë përfshirë në këtë studim. (tab. 11).

Tabela 11. *Struktura gjinore e nxënësve dhe të rinjve të anketuar në 5 vendet e Ballkanit*


(në përqindje)

Gjinia	Shqipëria	Bosnje- Hercegovina	Maqedonia	Kosova	Serbi- Mali i Zi	Shuma
Femra	53.5	53.0	49.3	56.7	50.4	52.2
Meshkuj	46.5	47.0	50.7	43.3	49.6	47.8
Shuma	100	100	100	100	100	100

Burimi: Anкета sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

Rreth 70 për qind e nxënësve dhe të rinjve të anketuar në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, janë të grup-moshës 13 deri 16 vjeç (fig. 1). Ndërsa grup-mosha deri 12 vjeç përfaqëson 9.4 për qind. Kjo grup-moshë është më e lartë se mesatarja në Shqipëri (25.6 për qind) dhe më e ulët në Serbi-Mali i Zi (2 për qind). Grup-mosha 17 vjeç e sipër përfaqëson rreth 21 për qind.

Figura 1: *Struktura moshore e të anketuarve*




Burimi: Anкета sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

Kjo strukturë moshore është në varësi të klasave dhe të llojit të shkollave ku janë kryer kurset mbi trafikimin dhe kontrabandën (fig.

2). Në Serbi-Mali i Zi (91.8 për qind) dhe në Shqipëri (86.4 për qind) këto kurse janë kryer në shkollat 9 vjeçare. Kurse në Maqedoni (60.1 për qind) dhe në Bosnje-Hercegovinë (56.8 për qind) kurset janë kryer kryesisht në shkollat e mesme të përgjithshme. Në Kosovë ato janë kryer më shumë në shkollat e mesme të tipit të ulët (39.8 për qind), të përgjithshme (24.4 për qind) dhe bujqësore (7.9 për qind).


Figura 2: Tipet e shkollave dhe OJQ-ve



Burimi: Anketa sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

Pjesa më e madhe e nxënësve dhe të rinjve të anketuar (76.2 për qind) janë nga zonat urbane. Kjo përqindje është më e lartë në Serbi-Mali i Zi (93.7 për qind), në Shqipëri (83.6 për qind) dhe në Bosnje-Hercegovinë (81.9 për qind). Vetëm në Kosovë, shumica e nxënësve dhe të rinjve të anketuar janë nga fshati (58.5 për qind) (fig. 3).

Figura 3: Vendbanimi i të anketuarëve, sipas shteteve



Burimi: Anketa sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

Pak më shumë se gjysma e nxënësve dhe të rinjve të anketuar në vendet e Ballkanit Perëndimor kanë qënë të paktën një herë në jetën e tyre jashtë shtetit.

Kjo përqindje është më e lartë në Bosnje-Hercegovinë (65.1 për qind), në Maqedoni (58.9 për qind) dhe në Kosovë (54.6 për qind). Ndërsa në Serbi-Mali i Zi dhe në Shqipëri kjo përqindje është poshtë mesatares (tab.12).

Tabela 12. *Përvoja jashtë vendit e nxënësve dhe të rinjve të anketuar (në përqindje)*


Burimi: Anketa sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

Rreth 64 për qind e nxënësve dhe të rinjve që kanë qënë jashtë shtetit kanë shkuar atje për pushime. Kjo përqindje është më e lartë në Maqedoni (73.7 për qind), në Shqipëri (69.5 për qind), në Serbi-Mal i Zi (65.4 për qind) dhe në Kosovë (61.3 për qind). Por është më e ulët në Bosnje-Hercegovinë (44 për qind). Ndërkaq, 16.2 për qind e nxënësve dhe të rinjve shprehen se kanë jetuar jashtë vendit me prindërit e tyre. Kjo përqindje është shumë më e lartë se mesatarja në Bosnje-Hercegovinë (33.3 për qind) dhe në Kosovë (23.7 për qind).

Kjo mund të shpjegohet me konfliktet dhe luftrat, të shoqëruara me shpërngulje masive, gjatë periudhës 1994-1996 në Bosnje-Hercegovinë dhe 1999 në Kosovë.

Veç kësaj, një pjesë e vogël e të anketuarëve, me gjithë moshën e vogël, kanë qënë jashtë vendit të tyre për motive punësimi. Kjo përqindje është më e lartë në Shqipëri (5.3 për qind) dhe në Kosovë (2.9 për qind). Thuhet se 80 për qind e fëmijëve në Shqipëri që kanë qënë jashtë vendit për moëve punësimi janë nën moshën 16 vjeç.

Figura 4: Motivi i qëndrimit jashtë shtetit



Burimi: Anketë sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

Anët e forta dhe kufizimet e vëzhgimeve

Ky punim u referohet, ndër të tjera, dy sondazheve. I pari, ai 'kombëtar' u shtri në gjashtë qarqe (prefektura) të Shqipërisë: Shkodër, Kukës, Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë, pra në gjysmën e prefekturave. Por në juridiksionin e tyre përfshihen 20 rrethe, nga 36 gjithsej.

Megjithëse studimi nuk u shtri në të gjitha rrethet e Shqipërisë kampioni i studimit mund të konsiderohet një kampion 'kombëtar'. Kjo sepse prefekturat (qarqet) e përzgjedhura ndodhen në pjesët ekstreme të Shqipërisë, sikurse edhe në Shqipërinë e mesme. Pra, nga pikëpamja gjeografike, zonat e përfshira në studim janë përfaqësuese.

Megjithatë kjo përfaqësueshmëri nuk është absolute. Nga studimi i problemit në vartësi të shkallës së migrimit, për shëmbull, del se në këto zona rreth 1/4 (73.9 për qind) e familjeve kanë ardhur në vendbanimet e sotme, pas vitit 1990 (pyetja 5 e anketës 'kombëtare'). Por zhvendosja e popullsisë është bërë dhe vazhdon të bëhet kryesisht drejt pellgut Tiranë-Durrës, shumë më tepër se drejt rrethëve apo edhe qyteteve të përfshira në sondazhin

‘kombëtar’. Ky përfaqëson, gjithsesi, njëfarë kufizimi lidhur me përfaqësueshmërinë.

Pyetëtorët e hartuar, në të dy vëzhgimet apo sondazhet, nuk ishin shumë të gjërë, për nga vëllimi dhe problematika. Në rastin e vrojtimit ‘kombëtar’ kjo mundësoi, gjithsesi, plotësimin e pyetësorëve nga vetë drejtuesit e anketimit sipas metodës *face to face*, mbi bazën përgjigjeve të marra, me gojë, nga të anketuarit., të cilët mbanin, gjithsesi, një kopje të pyetësorit për të ndjekur nga ana vizuale ecurinë e plotësimit të tij. Kështu, i gjithë procesi i anketimit u shndërrua në një komunikim anketues-të anketuar.

Në rastin e vrojtimit ‘rajonal’, pyetësori është plotësuar në mënyrë të pavarur nga nxënësit dhe të rinjtë, si në një “hartim”. Por vendimi për të patur pyetësorë jo shumë të gjërë u kushtëzua sidomos nga grupmosha e përgjigjedhënësve, si në rastin e studimit ‘kombëtar’, ashtu edhe të atij ‘rajonal’. Pra kufizimet që lidhen me mungesën e një informacioni shumë të madh, nga pikëpamja sasiore, justifikohen nga cilësia e informacionit të grumbulluar i cili, edhe nga ana sasiore, është vlerësuar si i mjaftueshëm në raport me objektivat e projekteve respektive, pra i mjaftueshëm edhe për realizimin e këtij punimi.

Në të gjitha anketimet sociologjike, mënyra e përzgjedhur e anketimit mbart, në vetvete, mundësinë e abuzimeve potenciale nga drejtuesit e anketimit. Kjo ishte më e mundëshme në rastin e studimit ‘kombëtar’. Megjithatë nuk kanë rezultuar mangësi të mëdha dhe shmangiet janë vlerësuar brenda parametrave normalë të anketimeve.

Sikurse në të gjitha anketimet sociologjike, procedura e aplikuar mbart edhe rrezikun e hezitimeve për të dhënë përgjigje të sinqerta. Edhe në këtë këndvështrim studimi ynë ka një shkallë të cakëuar vërtetësie. Por njëfarë shkalle e caktuar vërtetësie lidhet edhe me faktin se trafikimi konsiderohet një problem specifik dhe delikat. Madje gjatë trainimeve të bëra me grupet e anketimeve në Shqipëri, apo edhe në vende të tjera të rajonit, u shpreh njëfarë mosbesimi për të marrë përgjigje të sakta. Kjo sepse trafikimi është një problem delikat, i ndikuar nga opinioni, i lidhur me moralin tradicional shqiptar dhe ballkanas, me dinjitetin njerëzor,

sikurse i lidhur me shkelje ligjesh etj.

Në rastin e studimit ‘kombëtar’⁴⁶ nuk përjashtohet edhe hezitimi për të “deponuar” sinqerisht nga frika e ballafaqimit me trafikantët, sado që anketimi ishte anonim. Megjithkëto, në vlerësimin tonë, koeficienti i pasaktësisë që lidhet me (mos)sinqeritetin e përgjigjedhënësve nuk është më i madh se një koeficient i pranuar i çdo studim empirik, të bazuar në anketime dhe intervistime. Këto efekte janë minimizuar nga fakti se disa pyetje “delikate” përmes së cilave kërkohej informacion për mënyrat konkrete të trafikimit si dhe për moshën, nivelin arsimor, gjendjen e punësimit, gjendjen familjare etj., të viktimave të trafikimit, kërkonin përgjigje të tërthorta, “për dikë tjetër”, për një të njohur, pjesëtar ose jo i familjes (shih anketa ‘kombëtare’, pyetjet 17-22).

Ne vlerësojmë se, në sondazhin ‘kombëtar’ shkalla e çiltërsisë së përgjigjedhënësve duhet të jetë brenda parametrave të pranueshëm, nisur edhe nga mënyra e komunikimit, nga “klima” e besimit që mendojmë se u krijua, përgjithësisht, midis drejtuesve të anketimit dhe të anketuarve. Në krijimin e klimës së besimit ndikoi edhe fakti mbi 80 për qind e drejtuesve të anketimit ishin femra, sikurse edhe shumica e të anketuarve. Për t’u vlerësuar është fakti se thuajse të gjithë individët që përbënin grupet e sondazhit (survey team) kishin punuar më parë me projekte të ngjashme.

Një grup kufizimesh lidhen, gjithashtu, me përbërjen e kampionit të studimit dhe përzgjedhjen e tij. Megjithëse ka dominuar përzgjedhja sipas metodës së rastit, përsëri kjo është kombinuar me *metodën e orientuar*. Në sondazhin ‘kombëtar’, për shëmbull, mbi 60 për qind e të anketuarve ishin femra. Kështu është orientuar, pak a shumë, edhe përbërja sipas grupmoshave, vendbanimit etj., etj. Një praktikë e tillë lidhet me vetë objektivat e studimit, me njohjen e perceptimit

⁴⁶ Në anketën e përdorur në sondazhin ‘kombëtar’ kishte pyetje më të drejtpërdejtë lidhur me trafikimin, për mënyrat konkrete të trafikimit, nëse njihnin konkretisht ndonjë të trafikuar, pyetje për moshën, nivelin arsimor, gjendjen e punësimit, gjendjen familjare etj., të viktimave konkrete të trafikimit etj. Sado që kërkohehin përgjigje të tërthorta, “për dikë tjetër”, përsëri mund të krijonin te ndokush gjendje mërzie, kujtime të pakëndëshme, frikë etj.

mbi trafikimin e grave dhe adoleshentëve, kryesisht nga vetë ata. Sidoqoftë nëse krahasojmë shkallën e përfaqësueshmërisë së pjesës së zgjedhur si kampion ‘kombëtar’ studimi, në raport me të dhënat e regjistruara të të gjithë popullsisë së vendit⁴⁷, rezultojnë mospërputhje. Kjo do të thotë që shkalla e vërtetësisë së përfundimeve të dhëna është relativisht e lartë, por ato nuk mund të merren apriori të vërteta për gjithë popullsinë.

Gjithashtu, disa tregues, apo të dhëna të kampionit ‘kombëtar’ të studimit, si ato për përkatësin etnike, fetare etj., janë rastësore. Prej tyre nuk mund të konkludohet për përqindjet reale të tyre, në popullsinë shqiptare.

Në rastin e sondazhit ‘rajonal’ problemi është më i qartë, sepse ai është realizuar me një grupim të caktuar, me nxënës të niveleve të ndryshme shkollore dhe të rinj të shkollave dhe OJQ-ve.

Ndonjë kufizim lidhet edhe me përzgjedhjen e individëve që formuan kampionin e studimit. Drejtuesit e studimit dhe anketuesit vendosën bashkërisht numrin e anketave që do të plotësonin në çdonjërin nga qytetet e mëdha, qytetet e vogla apo në çdo fshat të përcaktuar. Por përzgjedhja e individëve është bërë nga vetë drejtuesit e anketimit, ndaj kriteri i rastësisë mund të jetë cënuar në raste të veçanëa ose të jetë kombinuar me “kriteret” subjektive që lidhen me njohjen, mundësinë “për të mbaruar punë” etj. Sado që është orientuar që përzgjedhja të bazohet në një kriter të qartë (një i anketuar në një numër të dhënë personash apo banesash, bazuar në listën e gjithë banorëve të bllokut/fshatit etj., nuk përjashtohet ndonjë subjektivizëm në përzgjedhje.

Sidoqoftë informacioni cilësor paralel i siguruar përmes intervistave në grup, apo atyre individuale, ka plotësuar edhe kriterin e verifikimit dhe korrigjimit. Pra, në dy sondazhe kemi dy pamja: atje ku ka patur më shumë mundësi shmangie nga kriteret e vendosura apo për të realizuar anketimin (rasti i sondazhit ‘kombëtar’), ka më tepër informacion paralel cilësor, pra më shumë intervista individuale, në grupe apo edhe opinione të shkruara. Në rastin e studimit ‘rajonal’

⁴⁷ Referuar regjistrimit të fundit të popullsisë shqiptare, prill 2001 (INSTAT, Vjetari statistikor 1993-2001, botim i vitit 2003).

numri i të anketuarve ishte rreth 2.5 herë më i madh. Nga ana tjetër, edhe mundësia për të zbatuar kritere strikte në procesin e anketimit ishte më e madhe, për vetë specifikën e tij (shih, Veçori metodologjike të sondazhit ‘rajonal’). Ndaj edhe sondazhi është kufizuar më shumë në të dhëna sasiore (të anketimit), kundrejt atyre cilësore (intervista etj.).

Në rastin e sondazhit ‘kombëtar’ nga rregulli i informacionit paralel (të dubluar) janë përjashtuar vetëm fëmijët e moshës deri në 16 vjeç⁴⁸, të cilët nuk janë përfshirë në anketim. Informacioni për perceptimet e tyre lidhur me trafikimin është marrë kryesisht përmes intervistave në grupe. Ky informacion është, gjithësesi, më i përafërt.

⁴⁸ Në rastin e sondazhit ‘kombëtar’ shkallëzimi që hartuesit e këtij punimi u kanë bërë grupmoshave “deri në 16 vjeç”, “16-18 vjeç” apo edhe më shumë, është bazuar në një kriter juridik. Sipas legjislacionit shqiptar, fëmijët që nuk kanë mbushur moshën 16 vjeç cilësohen si ‘juridikisht të paaftë për të vepruar’; në moshën 16-18 vjeç ata kanë fituar ‘aftësi të kufizuara juridike’ dhe mbi 18 vjeç ata gëzojnë aftësi të plota juridike për të vepruar, sipas vullnetit të tyre.

Pjesa II: Trafikimi, perceptimi i përmasave dhe faktorët ndikues

Si pikënisje e sondazhit ‘kombëtar’, për të matur perceptimin e rrezikut të trafikimit, ka shërbyer supozimi se në këtë perceptim ndikojnë, para së gjithash, ngjarjet personale të lidhura drejtpërdrejt me trafikimin. Perceptimi i trafikimit ndikohet, së dyti, nga fakti nëse individët përgjigjedhënës kanë ndonjë të trafikuar ndër familjarët, të afërmit apo të njohurit e tyre. Të anketuarve u është kërkuar të informojnë, gjithashtu, nëse midis të trafikuarve të njohur të tyre ndonjëri është rikthyer. Veç matjes së nivelit të perceptimit të trafikimit kjo mënyrë testimi ka mundësuar analizën e raporteve *individ i trafikuar – familje - komunitet*, pas rikthimit, si dhe mundësinë e riciklimit në trafikim të të njëjtëve individë.

Perceptimi i përmasave të trafikimit në Shqipëri

Për të matur përmasat e trafikimit, ndër gratë dhe adoleshentët shqiptarë, të anketuarve u është drejtuar kjo pyetje: “Në ç’masë trafikimi i grave dhe adoleshentëve është shqetësim për komunitetin tuaj?” (anketa ‘kombëtare’, pyetja 16.). Përgjigjet e marra janë pasqyruar në tabelën 13:

Tabela 13: *Përmasat e trafikimit, sipas perceptimit të të anketuarve*

Por trafikimi i grave dhe adoleshentëve, referuar opinioneve të qytetarëve përgjigjedhënës, nuk rezulton të jetë i njëjtë në të gjithë vendin. Të dhënat e tabelës 14 e provojnë këtë:

Tabela 14: *Perceptimi i përmasave të trafikimit sipas prefekturave (Në përqindje)*

Sa shqetësim?	Prefekturat e përfshira në studim						Gjithsej
	<i>Shkodër</i>	<i>Kukës</i>	<i>Elbasan</i>	<i>Vlorë</i>	<i>Gjirokastrë</i>	<i>Korçë</i>	
Shumë	53.0	38.2	68.1	59.8	23.4	43.5	47.6
Pak	27.7	47.1	21.9	24.1	50.3	37.7	34.8
Aspak	4.8	14.1	3.0	5.7	9.4	12.9	8.3
Nuk vlerësohet	14.5	0.6	7.1	10.4	16.9	5.9	9.3
<i>Gjithsej</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>

Nëse rreshtojmë prefekturat (qarqet) e përfshira në këtë studim, sipas pohimeve se trafikimi i grave dhe adoleshentëve përbën ‘shumë shqetësim’, do të kishim këtë renditje (tab. 15):

Tabela 15: *Prefekturat sipas shkallës së trafikimit (Në përqindje)*

Prefekturat, sipas përmasave të trafikimit	Vlerësimi “shumë shqetësues” i trafikimit
Elbasani	68.1
Vlora	59.8
Shkodra	53.0
Mesatarja kombëtare	47.6
Korça	43.5
Kuksi	38.2
Gjirokastrë	23.4

Nga të dhënat e mësipërme del se trafikimi i grave dhe adoleshentëve është, gjithsesi një problem mbarëkombëtar. Por në Shqipëri, ai perceptohet si ‘më shqetësues’ në prefekturat e Elbasanit, Vlorës dhe Shkodrës. Ndërkohë që më pak probleme trafikimi duket se kanë Kuksi dhe, sidomos, Gjirokastra. Të dhënat e kësaj pasqyre dëshmojnë se edhe në këtë çështje nuk mund të bëhen vlerësime me ndarje mekanike veri-jug. Kuksi dhe Gjirokastrë, për shëmbull, kanë tregues të përafërt ndonëse shërihen në dy ekstreme të Shqipërisë.

Perceptimi i përmasave të trafikimit në vartësi të disa karakteristikave social-demografike

Për të analizuar më në detaje përmasat e trafikimit vendosëm në një vartësi funksionale shkallën e trafikimit, sipas perceptimit të individëve të anketuar, me disa ndryshore të cilat përfaqësojnë vendbanimin [$p.16=f(p.A2)$]⁴⁹, moshën [$p.16=f(p.01)$], gjininë, [$p.16=f(p.02)$], nivelin arsimor [$p.16=f(p.03)$], statusin civil [$p.16=f(p.04)$] etj. Të dhënat e anketimit janë pasqyruar në tabelat e mëposhteme (tab. 16-25).

Tabela 16: Perceptimi i përmasave të trafikimit në vartësi të vendbanimit
(Në përqindje)

Sipas Vendbanimeve	Shumë	Përmasa e shqetësimit të trafikimit			Gjithsej
		Pak	Aspak	Pa vlerësim	
Qytete të mëdha	40.2	36.6	13.9	9.3	100.0
Qyteza	45.5	36.4	10.8	7.3	100.0
Fshatra	57.1	31.4	0.2	11.3	100.0
Mesatarja kombëtare	47.6	34.8	11.3	9.3	100.0

Siç shihet (tab. 16), trafikimi perceptohet si “shumë shqetësim”, më tepër në fshatra (57.1 për qind), se në qytetet e vogla (45.5 për qind) dhe, ca më shumë, kundrejt qyteteve të mëdha (40.2 për qind). Kjo ende nuk do të thotë se trafikimi ka përmasa më të mëdha në fshat, relativisht qytetit. Për këtë duhet të kemi edhe referenca të tjera. Tani për tani mund të pohojmë vetëm kaq: kundrejt problemit të trafikimit, fshati shqiptar është më i ndjeshëm se qyteti.

Tabela 17: Perceptimi i përmasave të trafikimit në vartësi të grupmoshave.
(Në përqindje)

Sipas grupmoshave	Shumë	Përmasa e shqetësimit të trafikimit			Gjithsej
		Pak	Aspak	Pa vlerësim	
16-18 Vjeç	38.3	39.7	9.6	12.4	100.0
19-21 vjeç	53.0	31.0	8.0	8.0	100.0
Mbi 21 vjeç	49.5	35.5	7.6	7.6	100.0

⁴⁹ Referuar anketës ‘kombëtare’, pyetja 16 (përmasa e shqetësimit mbi trafikimin), në kombinim me pyetjen A2 (vendbanimi).

Grupmosha që e percepton trafikimin me më shqetësim, rezulton të jetë grupmosha 19-21 vjeç (53 për qind). Por, siç do të shohim në pjesë të tjera të këtij punimi, grupmosha më e rrezikuar është ajo deri në 18 vjeç⁵⁰. Por grupmoshat e vogla, ndonëse janë më të rrezikuara nga trafikimi, nuk kanë ende ndjeshmërinë, apo nivelin e perceptimit të të rinjëve të grupmoshave më të rritura. Më pas vërtetohet njëfarë uljeje e përqindjes së individëve që e konsiderojnë trafikimin “shumë shqetësim”, për shkak të sigurisë më të madhe që fitojnë ata me kalimin e moshës së adoleshencës.

Tabela 18: *Perceptimi i përmasave të trafikimit në vartësi të përkatësisë gjinore (Në përqindje)*

Sipas përkatësisë gjinore	Shumë	Përmasa e shqetësimit të trafikimit			
		Pak	Aspak	Pa vlerësim	Gjithsej
Femra	50.4	33.1	7.3	9.2	100.0
Meshkuj	41.7	38.3	10.4	9.5	100.0

Në vlerësimin e masës së perceptimit të përmasave të trafikimit, sipas përkatësisë gjinore, vërehet një rezultat i pritshëm: femrat e perceptojnë trafikimin si më shqetësues se meshkujt. Kjo lidhet, nga njëra anë, me faktin se femrat janë drejtpërdrejt, më tepër se meshkujt objekt trafikimi. Nga ana tjetër, kjo lidhet me shkallën më të lartë të humanizimit që normalisht i karakterizon ato, kundrejt meshkujve.

Tabela 19: *Perceptimi i përmasave të trafikimit në vartësi të nivelit të arsimimit (Në përqindje)*

Sipas nivelit të arsimimit	Përmasa e shqetësimit të trafikimit				
	Shumë	Pak	Aspak	Pa vlerësim	Gjithsej
Kurrëfarë arsimit, flori, tetëvjeçar	45.4	27.6	13.8	13.2	100.0
Mesëm ose i lartë	48.1	36.2	7.2	8.4	100.0

Nuk duket ndonjë diferencim i theksuar në perceptimin e trafikimit sipas nivelit arsimor, megjithë njëfarë prirjeje që konstatohet nga të anketuarit më të arsimuar, për ta vlerësuar atë si më shqetësues (tab. 19).

⁵⁰ Siç do të shohim në “Grupmoshat e individëve të trafikuar”, të kasaj grupmoshe (deri në 18 vjeç), janë 64 për qind e të trafikuarve.

Por të dhëna për t'u vlerësuar janë ato që morëm nga hulumtimi i perceptimit të përmasave të trafikimit në vartësi të statusit social. Konstatohet se kategoria që e percepton me më shqetësim trafikimin janë të divorcuarit, madje me një diferencë që shkon deri në 20 për qind (66.7 me 46.2 dhe 47.4), kundrejt individëve të martuar e beqarë. Kjo dëshmon se martesë, megjithë ndryshimet e ndodhura në dy dhjetëvjeçarët e fundit, vazhdon të konsiderohet, ndër të tjera, si një "mburojë" ndaj trafikimit. Ndërsa pasmartesa (pasdivorci) vlerësohet si një "tranzicion" i vështirë, në planin ekonomik, social e atë të sigurisë⁵¹, pra edhe të sigurisë përkundrejt trafikimit (tab. 20).

Tabela 20: Perceptimi i përmasave të trafikimit sipas statusit civil
(Në përqindje)

Sipas statusit civil	Shumë	Përmasa e shqetësimit të trafikimit			Gjithsej
		Pak	Aspak	Pa vlerësim	
Beqar	47.4	35.3	7.3	10.0	100.0
I (e) martuar	46.2	34.4	12.7	6.6	100.0
I (e) divorcuar	66.7	26.7	3.3	3.3	100.0

Objekt hulumtimi ishte edhe perceptimi i përmasave të trafikimit sipas migrimit të brendshëm (tab. 21), shkallës së integimit në familje (tab. 22), sipas tipit të familjes, bërthamë apo me shumë kurora (tab. 23), sipas nivelit të besimit fetar (tab. 24) dhe faktit nëse përgjigjedhënesit kanë apo jo ndër familjarët apo të njohurit ndonjë të trafikuar (tab. 25).

Tabela 21: Perceptimi i përmasave të trafikimit, në vartësi të migrimit të pas vitit 1990

(në përqindje)

Sa shqetësim është trafikimi?	Familja juaj ka banuar para vitit 1990 apo është e ardhur?		Kampioni kombëtar
	Ktën ka banuar	Është e ardhur pas vitit 1990	
Shumë	46.5	50.1	47.6
Pak	35.6	32.7	34.8
Aspak	8.8	7.1	8.3
Vlerësohet	9.1	9.1	9.2
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

⁵¹ Shih, për shëmbull, Beqja, Hamit & Lekë Sokoli. 2003. *Divorci-Vrojtime e refleksione*. Tiranë: Dudaj & Rinia

Tabela 22: *Perceptimi i përmasave të trafikimit, sipas mënyrës së të jetuarit, pranë apo larg familjes*

(në përqindje)

Sa shqetësim është trafikimi?	Banoni pranë apo larg familjes?		Kampioni kombëtar
	Pranë familjes	Larg familjes	
Shumë	45.3	56.4	47.6
Pak	35.8	31.2	34.8
Aspak	9.1	5.4	8.3
Nuk vlerësohet	9.8	6.9	9.2
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

Tabela 23: *Perceptimi i përmasave të trafikimit, sipas përbërjes familjare (numrit të kurorëve).*

(në përqindje)

Sa shqetësim është trafikimi?	Familja juaj sot është:			Kampioni kombëtar
	Me shumë kurora	Me një kurorë	Me një prind	
Shumë	39.1	48.8	57.0	47.6
Pak	40.1	34.5	25.0	34.8
Aspak	12.1	7.5	6.9	8.3
Nuk vlerësohet	8.7	9.2	11.1	9.2
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0

Tabela 24: *Perceptimi i përmasave të trafikimit, sipas nivelit të besimit fetar*

(në përqindje)

Sa shqetësim është trafikimi?	Niveli i besimit fetar				Kampioni kombëtar
	Besoj shumë	Besoj pak	Jam ateist	Jam indiferent	
Shumë	50.0	48.8	48.1	35.2	47.6
Pak	32.7	32.7	40.4	46.4	34.8
Aspak	8.2	9.4	1.9	8.8	8.3
Nuk vlerësohet	9.1	9.1	9.6	9.6	9.2
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Tabela 25: *Perceptimi i përmasave të trafikimit, në vartësi njohjes personale me të trafikuarit*

(në përqindje)

Sa shqetësim është trafikimi?	A njihni personalisht një të trafikuar?		Kampioni kombëtar
	Po	Jo	
Shumë	55.5	37.1	47.6
Pak	32.9	37.1	34.8
Aspak	4.8	13.1	8.3
Nuk vlerësohet	6.8	12.5	9.2
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

Nga të dhënat e tabelave të mësipërme, rezulton se:

1. Përqindja e atyre që e konsiderojnë trafikimin “shumë shqetësim” është më e madhe tek individët që kanë migruar pas vitit 1990, kundrejt atyre me vendbanim stabël (tab. 21). Kjo mund të konsiderohet si një tregues i vartësisë së perceptimit (apo rrezikut) të trafikimit me shkallën e integritimit në komunitet. *Sa më i plotë të jetë integrimi, aq më i mundur është evitimi i rrezikut të trafikimit dhe anasjelltas.*

2. Nga perceptimi i përmasave të trafikimit, sipas mënyrës së jetuarit (pranë apo larg familjes), del sërish lidhja trafikim-integrim, por këtë herë, integrim në familje (tab. 22). *Më të integruarit në familje e konsiderojnë trafikimin “shumë shqetësim”, në masë shumë më të vogël se individët që banojnë larg familjes dhe, për këtë arsye, normalisht mund të vlerësohen si më pak të integruar në të.*

3. Nga analiza e perceptimit të përmasave të trafikimit, sipas përbërjes familjare (numrit të kurorëve, tab. 23), del se *kur kalon nga familjet me një prind, në atë me një kurorë dhe në familjet me shumë kurorë perceptimi i rrezikut të trafikimit bie nga 57, në 48.8 dhe 39.1 për qind. Konfirmohet, kështu, pohimi se familjet më të rrezikuara nga trafikimi janë familjet bërthamë (nukleare) dhe, brenda tyre, familjet me një prind, ku në 8/10 e rasteve prindi (kryefamiljari) është nëna.*

4. Referuar të dhënave të tabelës 24, nuk duket ndonjë diferencim i madh në perceptimin e trafikimit sipas nivelit të besimit fetar, megjithëse *ata që ‘besojnë shumë’ njëherësh e përceptojnë trafikimin më shumë shqetësim (50 përqind), kundrejt atyre që në raport me besimin fetar vetëcilësohen si indiferentë, për shëmbull (35.5 për qind). Kjo, nga sa duket, lidhet me ndjeshmërinë morale më të madhe të besimtarëve ndaj trafikimit se me ndonjë ndikim në të qenit më i (pa)rrezikuar, në vertësi të shkallës së besimit fetar.*

5. Të dhënat tregojnë se perceptimi i përmasave të trafikimit ndikohet jo pak nga njohja personalisht e të paktën një të trafikuarit (shih, tabelën 25). *Ata që njohin një apo disa të trafikuar dhe, për këtë arsye, kanë njëfarë përjetimi emocional më të madh ndaj trafikimit, pohojnë në masë më të madhe (55.5 për qind) se trafikimi përbën “shumë shqetësim”, kundrejt atyre që nuk njohin ndonjë të trafikuar (37, 1 për qind)*

Rasti ‘Stela’: Gjithë përmbajtja e fjalës ‘trafikim’ në një shëmbull të vetëm

Gjatë kohës që ne punonim nëpër Shqipëri, në kërkim të fakteve mbi trafikimin e grave dhe adoleshentëve, në Vlorë (një nga qytetet e përfshira në vrojtimin ‘kombëtar’), të gjithë flisnin për jehonën e një ngjarjeje të vërtetë (një ndër ngjarjet e shumta), të lidhur pikërisht me trafikimin. Në qendër të saj ishte J. D⁵², e bija e B & R., e lindur në Vlorë në vitin 1987. Në kohën që ne po mbyllnim përmbledhjen e studimit ‘kombëtar’, edhe ajo e kishte mbyllur, madje në mënyrën më tragjike, ‘ciklin e trafikimit’, një cikël që zgjati katër vjet dhe që kaloi nëpër labirinthe të shumtë, deri sa u vra në agimin e ditës së fundit të korrikut 2005.

Ajo i përkiste një familje me probleme. Prindërit e saj ishin *divorcuar* që prej katër vjetësh dhe rrethanat e kishin detyruar *adoleshenten pa përkrahje*, atëherë 14 vjeçare, të jetonte vetëm me gjyshen e saj. Ishte e papunë dhe vetëm 3 muaj më parë ishte *bërë nënë*. Kishte lindur një djalë, *me një baba i cili nuk e kishte pranuar atësinë*. Pas daljes nga materniteti ajo e kishte dorëzuar fëmijën në jetimore (në Shtëpinë e Foshnjës, Vlorë). Një muaj më pas e kishte marrë sërish foshnjën, me të cilin jetonte në një kabinë, në plazhin e Vlorës. Arsyen e shpjegon vetë: “Më kanë marrë në telefon nga policia kriminale dhe më kanë thënë se nëse nuk e merr fëmijën nga jetimorja, do ta gjeshtë të vdekur”. Të paktën kështu u kishte thënë ajo drejtuesve të jetimores.

Më pas 18-vjeçarja detyrohet të *banonte e vetme* në kabinën e plazhit, ndërkohë që djalin ia kishte lënë gjyshes, pasi “kishte probleme dhe se e kërcënonin vazhdimisht”. Më pas erdhi fundi tragjik: “J. D. është goditur nga shtatë thika në gjysmën e trupit dhe me dy thika në zemër, plagë këto që i kanë shkakëuar vdekjen e menjëhershme” (sipas pohimeve të ekspertizës).

J. D. njihej prej disa muajsh nga opinionioni publik shqiptar me

⁵² Në mediat shqiptare ky rast, sikurse të gjithë të tjerët, është përcjellë me gjenialitete të plota të vajzës, sikurse të prindërve të saj apo edhe njerëzve të lidhur me këtë ngjarje (shih, për shëmbull, “E masakruara ‘Stela’ që denoncoi agjentët e antitrafikut”, gazeta *Shekulli*, 2 gusht 2005).

pseudonimin “Stela”, emër që e mbante gjatë misionit që kishte, si *e rekrutuar* nga disa ‘agjentë të antitrafikut’. Ajo *denoncoi agjentët e policisë së antitrafikut* të Vlorës, në emisionin “Fiks Fare” të kanalit më të madh televiziv të Shqipërisë: “Top Chanel”, duke pohuar se ata e kishin rekrutuar për të futur në kurth tutorët e femrave, ose individë të tjerë të pafajshëm të cilët, sipas saj, liroheshin vetëm pasi paguanin shumën të majme parash. “Unë nuk jam paguar asnjëherë nga agjentët e antitrafikut për punën që kam bërë, ndërkohë që *janë futur në burg persona të pafajshëm*, të cilët nuk kanë kryer asnjë krim”, ka pohuar publikisht “Stela”.

Ajo denoncoi me emra katër agjentë të antitrafikut, që e përdornin si ‘karrem’ për të zhvatur para nga trafikantët e femrave apo edhe persona të tjerë të palidhur me trafikimin. Thëniet e saj nuk janë marrë kurrë seriozisht, as nga trupi gjykues, madje gjykata e deklaroi atë të papërgjegjshme.

“Stela” e kishte *paralajmëruar fundin e saj*. Një javë para vrasjes ajo denoncoi kërcënimin që i ishte bërë: “Mos fol shumë, brenda kësaj jave do të vijë fundi yt”. Ajo e denoncoi në polici edhe këtë letër kërcënuese të shkruar me gërma kapitale. Por edhe në policinë e Vlorës ‘nuk e morën seriozisht’. E zhgënjyer nga Komisariati i Policisë ajo denoncoi kërcënimin edhe në media.

Së fundi, ajo pësoi atë që kishin vendosur trafikantët, të veshur me petkun e policit apo jo, duke lënë pas kujtimin e një bote të pashpirë, bashkë me një krijesë të vogël, fatin e të cilit është vështirë ta parashikosh.

Rasti i saj flet shumë: Një adoleshente 14 vjeçare, e mbetur pa familje dhe përkrahje; që bie në rrjetin e trafikut dhe detyrohet të bëjë lojën e trafikantëve, që shfrytëzohet seksualisht dhe përdoret për të “shuar” etjen e shfrenuar për para të trafikantëve e, mes tyre, edhe të njerëzve të emëruar nga shteti e shoqëria pikërisht për të luftuar trafikun, por që shndërrohen në trafikantë (shfrytëzues) të trafikantëve; një vajzë që gjen kurajon të denoncojë publikisht trafikun, por që nuk gjen mbrojtjen e shtetit e të shoqërisë; së fundi një vajzë që paguan me jetën e saj denoncimin e trafikantëve të paskrupuj, në një shoqëri pa forcë reaguese...

Perceptimi dhe ngjarjet e përjetuara, të lidhura me trafikimin

“Janë munduar të më grabisin me veturë në mes të rrugës. Për një çast mendova se donin të më perdhunonin por, më vonë, mësova se grupi ishte i specializuar dhe merrej me trafik femrash. Mësova që femrat ua dërgonin tutorëve në Itali... Shpëtova se më dolën për zot disa persona që u gjendën në vendin e ngjarjes, në mes të rrugës”⁵³.

Në studimin e çështjeve të lidhura me trafikimin, jemi nisur nga parimi se perceptimi i tij ndikohet, së pari, nga ngjarje personale të lidhura me të. Por ç’pjesë e popullsisë së zonave të përfshira në studimin tonë ‘kombëtar’ ka njohur përvoja të tilla? Hulumtimin për përjetimin e ngjarjeve personale të lidhura me trafikimin e bazuam në pyetjen: “A jeni ndjerë, qoftë edhe njëherë të vetme në jetën tuaj, i/e rrezikuar për t’u trafikuar nga dikush?” (anketa ‘kombëtare’, pyetja 12). Kjo pyetje shoqërohej me disa nënpyetje, lidhur me format e mundshme të realizimit të trafikimit, si në tabelat e mëposhëme (26-29). Vendimi ynë për të kërkuar informacion në disa drejtime, lidhet me pohimin se trafikimi i grave dhe adoleshentëve nuk është më në fazën ‘primitive’. Mjaft të intervistuar janë të mendimit se trafikimi i grave dhe adoleshentëve nuk ka pësuar rënie, por vetëm kanë ndryshuar format dhe rrugët e realizimit të tij. Të dhënat e anketimit tonë janë vendosur në tabelën 26:

Tabela 26: Të dhëna për individë që kanë përjetuar ngjarje personale të lidhura me trafikimin.

(Në përqindje)

Nëse je ndjerë qoftë edhe një herë i rrezikuar për t’u përfshirë në trafik:	Përgjigjet e marra	
	Po	Jo
I/e rrezikuar për t’u rrëmbyer me forcë për prostitucion (a)	3.7	96.3
Me mashërime, përmes premtimeve për martesë (b)	4.6	95.4
Me anë të premtimeve për punësim jashtë shtetit (c)	5.7	94.3
Me premtime për vazhdimin e shkollës jashtë shtetit (d)	4.4	95.4
Me premtime për të fituar shpejt para, në rrugë të ndryshme (e)	3.7	96.3
Për t’u bërë lypës (f)	1.1	98.9
Duke u joshur në rrugë të tjera (g)	4.4	95.6

⁵³ Nga intervista e një vajze nga qyteti i Shkodrës, qershor 2005.

Nga kjo pasqyrë vërehet se, në shoqërinë e sotme shqiptare, të gjitha format e trafikimit janë të aplikueshme. Vërehet, gjithashtu, se rrëmbimi me forcë për ushërim prostitucioni nuk është më forma e vetme e trafikimit të grave e vajzave, megjithëse ajo vazhdon të aplikohet. Sidoqoftë ajo nuk është forma kryesore, derisa numri i rasteve të aplikimit të saj është 6-7 herë më i vogël se tentativat për përfshirje në trafikim në forma të tjera, të marra së bashku.

Të dhënat në vijim (tab. 27) shprehin më qartësisht ndikimin e kërcënimeve apo ngjarjeve personale në perceptimin e trafikimit. Përgjigjedhësit që kanë të paktën një histori personale të lidhur me trafikimin e përceptojnë atë si “shumë shqetësim” në një masë mjaft më të madhe se të anketuarit që nuk kanë përjetuar ngjarje të tilla.

Table 27: Perceptimi i trafikimit dhe ngjarjet personale të lidhura me të [p.12=f(p. 16)]

	Kanë ose jo ngjarje personale lidhura me trafikimin	Shumë shqetësim	Perceptimi i përmasave të trafikimit			Gjithsej
			Pakë shqetësim	Aspakë	Nuk di ta Vlerësoj	
12a	Po	67.6	18.9	8.1	5.4	100.0
	Jo	47.1	35.2	8.3	9.4	100.0
12b	Po	79.0	8.5	2.1	10.6	100.0
	Jo	46.2	36.0	8.6	9.2	100.0
12c	Po	72.4	8.9	1.7	6.9	100.0
	Jo	46.3	35.6	8.7	9.4	100.0
12d	Po	68.0	20.0	0.0	11.0	100.0
	Jo	46.8	35.3	8.7	9.2	100.0
12e	Po	62.2	24.3	8.1	5.4	100.0
	Jo	47.2	35.1	8.3	9.4	100.0
12f	Po	81.8	9.1	0.0	9.1	100.0
	Jo	47.4	35.0	8.4	9.3	100.0
12g	Po	71.1	15.6	2.2	11.1	100.0
	Jo	46.7	35.5	8.6	9.2	100.0

Të rrezikuar për t'u trafikuar me: 12a: Për t'u rrëmbyer me forcë, për prostitucion; 12b: Me mashtrime, përmes premtimeve për martesë; 12c: Mashtrime me premtime për punësim jashtë shtetit; 12d: Mashtrime me premtime për vazhdimin e shkollës jashtë shtetit; 12e: Mashtrime me premtime për t'u pasuruar shpejt; 12f: Për t'u bërë lypës; 12g: Joshje në rrugë të tjera.

Në tabelën 28 jepen përqindjet e personave me përvoja personale, lidhur me trafikimin, sipas shtrirjes territoriale (prefekturave), nga rezultojnë diferencime të konsiderueshme. Në mënyrë të skajshme këto diferencime duken midis Elbasanit, me përqindjen më të madhe të individëve me ngjarje personale, lidhura me trafikimin (30.6 për qind) dhe Kuksit, me përqindjen më të vogël të tyre (vetëm 1.2 për qind).

Table 28: *Të anketuar me përvoja personale, sipas prefekturave*

Prefekturat	Individë me ngjarje personale kundrejt trafikimit	
	Në numër	Në përqindje
Shkodër	22	12.9
Kukës	2	1.2
Elbasan	52	30.6
Vlorë	26	14.9
Gjirokastrë	16	9.4
Korçë	36	21.4
<i>Kampioni 'kombëtar'</i>	<i>154</i>	<i>15.1</i>

Nëse u referohemi të dhënave të tablës 26, duket sikur të anketuarit pohojnë në përmasa relativisht modeste për ngjarje personale të lidhura me trafikimin (nga 1.1 deri në 5.7 për qind). Por duke patur parasysh se janë të njëjtit të anketuar që japin përgjigje për të gjitha format e trafikimit, del se plot 15.1 për qind e të anketuarve kanë përjetuar ngjarje të tilla. Kjo shifër del nga përlogaritja e asaj pjese të individëve që kanë pohuar se janë ndjerë të kërcënuar në më shumë se një nga mënyrat e trafikimit. Të dhëna më të plota, lidhur me këtë çështje, jepen në tabelën 29.

Table 29: *Indivldë që pohojnë se kanë 'ngjarje personale', në një ose më shumë mënyra rekrutimi*

Një ose më shumë mënyra rekrutimi	Janë ndjerë të kërcënuar nga trafikimi	
	Në numër	Në për qindje
Me një mënyrë	93	60.4
Dy mënyra	27	17.5
Tre mënyra	13	8.4
Katër mënyra	17	11.0
Pesë mënyra	2	1.4
Gjashtë mënyra	0	0.0
Shtatë mënyra	2	1.3
Gjithsej	154	100.0

Rezultatet e tabelave të këtij paragrafi mund të konsiderohen si çelës për të matur nivelin e të qënit i rrezikuar nga trafikimi. Analiza për çdonjërën nga format e rekrutimit jep një rezultat, në dukje, modest.

Por, shifra 15.1 për qind, që rezulton ‘së bashku’ mund të konsiderohet, gjithësesi, mjaft shqetësuese.

Perceptimi i trafikimit dhe njohja personale e të trafikuarve

Në kërkimin e të dhënave mbi njohjen personale të të trafikuarve jemi nisur nga ideja se perceptimi i tij ndikohet, veç ngjarjeve personale të lidhura me të, edhe nga fakti nëse në rrethin e familjarëve, të të afërmve apo edhe të të njohurve, ka apo nuk ka ndonjë të trafikuar.

Për këtë qëllim të anketuarve u është kërkuar përgjigje për një pyetje të formuluar kështu: “A njihni të paktën një person të trafikuar?” (anketa ‘kombëtare’, pyetja 17). Me përgjigjet e marra hartuam tabelën e mëposhëme (tab. 30):

Tabela 30: Inividë që njohin personalisht ose jo persona të trafikuar

Kanë njohur ose jo individë të trafikuar	Përgjigjet e marra	
	Në numër	Në përqindje
Po	587	57.4
Jo	435	42.6
Gjithsej	1022	100.0

Siç shihet, pjesa më e madhe e kampionit tonë ‘kombëtar’ (57.4 për qind), pohon se njih personalisht të paktën një individ të trafikuar. Kjo do të thotë se një individ i tillë është midis pjestarëve të familjes, të afërmve, apo në rrethin e të njohurve të tyre jashtë familjes e farefisit.

Megjithatë të dhënat paralele (të dubluara) dëshmojnë se një pjesë e përgjigjedhënësve kanë marrë si shëmbull reference individë që janë bërë të njohur përmes mediave, ose në forma të tjera. Kjo mund të ketë ndikuar në rezultatin e anketimit, sidomos në qendrat e vogla të banimit.

Tabela 31: *Inividë që njohin ose jo persona të trafikuar, sipas prefekturave*

(në përqindje)

Prefekturat e përfshira në studim	Përgjigjet e marra	
	<i>P_o</i>	<i>J_o</i>
Shkodër	50.3	49.7
Kukës	81.2	18.8
Elbasan	73.9	26.1
Vlorë	46.8	52.3
Gjirokastrë	36.8	63.2
Korçë	55.9	44.1
<i>Për kampionin 'kombëtar'</i>	<i>57.4</i>	<i>42.6</i>

Përgjigjet e marra nuk kanë ndonjë domethënie për t'u vlerësuar, lidhur me përmasat e trafikimit të grave dhe adoleshentëve. Por kjo mund të cilësohet një pyetje çelës lidhur me mënyrën e realizimit të trafikimit, moshën, nivelin arsimor dhe ndikimin e përbërjes e të jetës familjare dhe të punësimit mbi fenomenin e trafikimit. Pra, në mënyrë të tërthortë, ne kemi arritur të sigurojmë një informacion të konsiderueshëm, në kërkim të përgjigjes së pyetjes “kush trafikohet?” dhe “në ç'mënyrë?”, sikurse në njëfarë mase edhe “pse ndodh trafikimi?”.

Babai dhe vajza e trafikuar

‘Babai’ është titulli i një premiere të vënë në skenë nga Teatrin Kombëtar (viti 2006). Ajo ka për autor dramaturgun e mirënjohur Ruzhdi Pulaha dhe interpretohet nga një trupë aktorësh profesionistë, ku shquhet ‘babai’ Mehdi Malkaj, “hetuesja” Raimonda Bulku, “prostituta” Suela Konjari e gjithë të tjerët, pa përjashtim. Subjekti i kësaj drame është ky: Një baba tradicionalist, i shquar njëherësh për ndershmëri dhe varfëri, ka një vajzë për të martuar. Një djalë me një njohje të largët “kërkon dorën” e saj. Me gjithë mëdyshjet martesë bëhet, madje sipas zakonisht. Të martuarit shkojnë në Greqi. Por martesë zgjati, si e tillë, vetëm një javë. Më pas “nusja” detyrohet të prostitutojë dhe të lindë fëmijë “të porositur” për tregun grek. Çifti, gjithsesi, nuk e harron babain. I dërgon para për të bërë shtëpi të re etj. Por

vjen një ditë dhe babai e merr vesh ç’kish ndodhur. I çakërditur kërkon rrugë për t’u hakmarrë. Së pari, ndaj shtëpisë së tij, të ndërtuar me paratë e krimit, së cilës i vë flakën. Më pas ndaj vajzës së tij viktimë e trafikimit. Madje asaj ia kishte bërë varrin në oborrin e pasmë të shtëpisë dhe në të kish “varrosur”, në pamundësi për të varrosur atë vetë, një palë çorape leshi të kohës kur ajo ishte në djep.

“Babait” i dalin përpara dy prostituta të cilat i rreh keqas, duke pasur në mendje vajzën e vet. Ato e akuzojnë për përdhunim dhe babai arrestohet. Mediat buçasin, si gjithnjë në të tilla raste. Turpi i mbeti përsëri në derë. Djali ushtar e mohon “babain kodosh”. Të tjerët e sikterosin. Por, gjatë procesit të hetimit sqarohet gjithçka. Pas një zinxhiri ngjarjesh dramatike vjen “happy end-i”. Vajza, duke rrezikuar jetën, arrin të çlirohet nga kthetrat e trafikantëve (thyen vetëm dorën tek hidhet nga dritarja), vetë burri mashërues vdes në një aksident automobilistik, ‘babai’ merr pafajësinë etj., etj. Familja kthehet në pikënisje, sikur rigjen njëfarë ekuilibri. Por sërish në një gjendje të mjeruar, në një gjendje që “prodhon” trafikim.

Kjo është një histori, si shumë të tjera, nga ato që mund të tregojë çdonjëri nga ne. Një histori e shndërruar në vepër skenike. Që meriton të shihet e të diskutohet.

Pjesa III: Njohuritë mbi trafikimin dhe roli i edukimit

Informimi rreth trafikimit dhe burimet e tij

Të dhënat tregojnë se suksesi lidhur me parandalimin e fenomenit të trafikimit të grave dhe adoleshentëve varet shumë nga shkalla e njohjes dhe e informimit të grave dhe të rinjëve për mundësitë e trafikimit dhe format konkrete të realizimit të tij. Në përgjigje të pyetjes lidhur me shkallën e informimit (anketa ‘kombëtare’, pyetja 14), morëm këtë përgjigje (tab. 30).

Tabela 32: Të (pa)informuar për trafikimin

Pohimet e përgjigjedhënësve lidhur me informimin mbi trafikimin:		
<i>Të informuar</i>	<i>Të painformuar</i>	<i>Gjithsej</i>
90.4	9.6	100.0

Siç shihet raporti i të painformuarve me të informuarit⁵⁴ është 1:9. Ndërsa në tabelën në vijim (tab. 33) jepen përgjigjet e marra nga të

⁵⁴ Po i referohemi, në çështjen e informimit mbi trafikimin, më shumë sondazhit ‘kombëtar’. Por, pak a shumë, të njëjtat rezultate kemi marrë edhe nga sondazhi ‘rajonat’. Rreth 93 për qind e nxënësve dhe të rinjve të vendeve të rajonit pohojnë se kanë dëgjuar për trafikimin e qënieve njerëzore, 3 për qind shprehen se “nuk janë të sigurtë” dhe vetëm 4 për qind e tyre nuk kanë dëgjuar për to. Burimi kryesor i informacionit, për të gjashtë vendet e përfshira në studim, ka qënë media (69.7 për qind). Por ndikimi i mediave rezulton të jetë më i ulët në Kosovë, sepse ato janë zhvilluar më vonë se në vendet e tjera të Ballkanit. Kjo lidhet, gjithashtu, me faktin se rreth 60 për qind e të anketuarve nga Kosova jetojnë në fshat. Burimi i dytë dhe i tretë i informacionit mbi trafikimin, për të gjitha vendet, janë mësuesit apo shkolla (17.7 për qind) dhe familja (7.5 për qind). Por, në këtë rast, roli i shkollës në informimin mbi trafikimin del më i lartë, kundrejt sondazhit ‘kombëtar’, sepse është ndikuar nga trainimet e IOM-it, të realizuara në ato shkolla ku është bërë anketimi.

anketuarit në qytetet e mëdha, qytezat dhe fshatrat⁵⁵.

Tabela 33: Mënyrat e informimit për trafikimin, sipas vendbanimeve

Informimuesit	Përgjigjet e marra, sipas vendbanimeve			Kampioni 'kombëtar'
	<i>Qytete të mëdha</i>	<i>Qytete të vogla</i>	<i>Fshatra</i>	
Nëna	10.6	14.4	7.5	11.1
Babai	2.2	3.5	0.0	1.4
Të afërm	5.0	3.9	1.1	3.3
Shkolla, mësuesit	3.6	5.6	1.5	3.5
Media (gazeta, TV, radio)	45.4	38.5	73.9	51.7
Shokët/shoqet	10.8	8.7	8.9	9.8
Nga një i trafikuar	3.6	5.2	1.5	3.4
Shoqatat, shoqëria civile	4.0	5.6	0.7	3.5
Të tjera burime	3.2	4.7	0.0	2.7
Nga askush	11.6	10.8	4.9	9.6
<i>Gjithsej</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>

Rezulton se, në mënyrë të grupuar, informimi mbi rreziqet e trafikimit merret, së pari nga familjarët dhe të afërmit: nëna, babai apo të tjerë pjesëtarë të fisit (1+2+3). Informacioni merret, së dyti, nga institucione të shoqërisë: media, shkolla, shoqatat (5+6+8) dhe nga shoqëria: shokët/shoqet ose të njohurit duke përfshirë edhe idividë të trafikuar (5+6+9).

Të dhënat tregojnë se institucionet e shoqërisë zënë vendin kryesor në informimin e opinionit publik mbi trafikimin. Të rinjtë pohojnë se media është instrumenti kryesor i informit mbi trafikimin, me mbi 50 për qind e të anketuarve, gjithsej. I papritur, ndoshta, ishte rezultati sipas të cilit media është një instrument më informues në fshat (73.9 përqind) se në qytetet e mëdha (45.4) dhe më shumë akoma se në qytetet e vogla (38.5 për qind).

Krejt i pamjaftueshëm rezulton të jetë roli i shkollës në informimin e

⁵⁵ Në mënyrë më specifike, rezulton se pak a shumë në këto nivele është edhe informimi (njohja) e tërheqjes për qëllim prostitucioni. Për shëmbull, sipas një anketimi të realizuar nga Qendra e Gruas Shkodër (shih, 2002), rezulton se 86.7 për qind e grave të anketuara pohojnë se ishin të informuara lidhur me tërheqjen e grave për prostitucion. Por niveli i ndërgjegjësimit ishte në përpjestim të drejtë me moshën. Ai ishte më i lartë ndër gratë e grupmoshës 35-44 vjeç (93.5 për qind) dhe më i ulët ndër ato të grupmoshës deri 20 vjeç (81 për qind) .

të rinjëve mbi trafikimin, me vetëm 3.5 për qind (në fshat vetëm 1.5 për qind). Jo i papërfillshëm është vlerësimi i masës së informimit nga shoqatat, përmes përfshirjes në projekte, nëse kjo gjykohet në raport me mundësitë. Por në fshat ky “zë” informimi është vetëm 0.7 për qind.

Ndër familjarët dhe të afërmit, nëna është informuesja kryesore, sidomos për vajzat. Babai, përkundrazi, del se komunikon pak apo aspak me fëmijët e vet për çështjet e trafikimit. Duket paradoksale, por sisomos në fshat, pakkush ka pohuar që të ketë folur ndonjëherë me babain e vet për trafikimin.

Në analizën sipas grupmoshave (tab. 34), duket rënia e nivelit të informimit nga familjarët apo të afërmit, me kalimin në rritje nga një grupmoshë në tjetrën (nga 19.4 në 12.2 për qind) dhe rritje, thuhet në të njëjtën masë e rolit të institucioneve të shoqërisë. Në analizën sipas përkatësisë gjinore (tab. 35), duket ndikimi më i madh i familjes mbi vajzat dhe i institucioneve të shoqërisë mbi djemtë.

Për nga shkalla e arsimimit (tab. 36), duket qartë diferencimi i shkallës së informimit midis individëve me nivel të ulët dhe të lartë arsimimi. Të painformuarit nga grupi i parë janë mbi katër herë më shumë se të painformuarit nga grupi i dytë (26.6 me 6 për qind). Të painformuarit e paarsimuar apo me nivel të ultë arsimimi rezultojnë të jenë edhe kontigjentet potencialë të trafikimit.

Nga shkalla e informimit është ndikuar edhe perceptimi i përmasave të trafikimit (tab. 37). Ata që pohojnë se trafikimi “nuk është shqetësim” janë të painformuar 2.6 herë më tepër se ata që pohojnë se ai “është shqetësim”

Tabela 34: *Niveli dhe mënyrat e informimit për trafikimin, sipas grupmoshave*

	Të informuar nga:		Grupmoshat	
	16-18 vjeç	19-21 vjeç	Mbi 21 vjeç	
Familjarë (nëna, babai) ose të afërm	19.4	16.6	12.2	
Institucionet e shoqërisë (shkolla, media, OJQ-të)	52.7	61.1	60.8	
Shokët/shoqet (duke përfshirë persona të trafikuar) etj.	18.6	12.8	17.1	
Të painformuar nga ndokush	9.3	9.5	9.9	
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	

Tabela 35: *Niveli dhe mënyrat e informimit, sipas përkatësisë gjinore*

Të informuar nga:	Përkatësia gjinore	
	<i>Nga femrat</i>	<i>Nga meshkujt</i>
Familjarë (nëna, babai) ose të afërm	18.1	10.7
Institucionet e shoqërisë (shkolla, media, OJQ-të)	58.0	60.2
Nga shokët/shoqet (përfshirë edhe persona të trafikuar) etj.	14.8	18.2
Të painformuar nga ndokush	9.1	10.7
Gjithsej	100.0	100.0

Tabela 36: *Niveli dhe mënyrat e informimit, në vartësi të nivelit të arsimimit*

Të informuar nga:	Shkalla e arsimimit	
	<i>E ulët</i>	<i>E lartë</i>
Familjarë (nëna, babai) ose të afërm	18.3	15.3
Institucionet e shoqërisë (shkolla, media, OJQ-të)	36.6	63.2
Shokët/shoqet (përfshirë edhe persona të trafikuar) etj.	18.8	15.5
Të painformuar	26.3	6.0
Gjithsej	100.0	100.0

Tabela 37: *Niveli dhe mënyrat e informimit për trafikimin, në vartësi të perceptimit të përmasave të trafikimit*

Të informuar nga:	Perceptimi i përmasave të trafikimit		
	<i>Është shqetësim</i>	<i>Nuk është shqetësim</i>	<i>Nuk di ta vlerësoj</i>
Familjarë (nëna, babai) ose të afërm	16.6	9.8	20.0
Të informuar nga institucionet e shoqërisë (shkolla, media, OJQ-të)	61.1	63.4	51.1
Shokët/shoqet (duke përfshirë edhe persona të trafikuar) etj.	18.2	13.4	12.2
Të painformuar	5.1	13.4	16.7
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

Njohuritë mbi trafikimin, aktivitetet edukative dhe roli i tyre

Sondazhi ‘rajonal’ ka përcaktuar, në mënyrën më të qartë, rëndësinë e njohurive mbi trafikimin dhe kontrabandën, rolin e tyre në perceptimin e profilit të rrezikshmërisë, sikurse në parandalimin e tyre. Madje përvoja e projektit rajonal të IOM-it (pjesë e të cilit është edhe sondazhi ‘rajonal’), dëshmoi se edhe një training i vetëm mund të ndikojë dukshëm në

rritjen e nivelit të njohurive të rinjëve, mbi trafikimin. Dhe, për të vlerësuar efektivitetin e trainimeve të bëra nga IOM-i mbi trafikimin dhe kontrabandën, është bërë krahasimi i nivelit të njohurive të nxënësve dhe të rinjëve për të dy kategoritë “të trainuar” dhe “të patrainuar”. Me këtë metodë krahasimi të njohurive janë nxjerrë përfundime për efektivitetin e metodave të përdorura gjatë aktiviteteve edukative shkollore në vendet e rajonit, për kuptueshmërinë e situatave të ndryshme dhe sjelljen e ardhshme të tyre. Në vijim do të prezantojmë rezultatet e sondazhit për dhjetë çështje të lidhura me aspekte të veçanta të trafikimit dhe kontrabandës së qenieve njerëzore.

Përkufizimi më i saktë i trafikimit

Nga anketimet e realizuara në Shqipëri (sondazhi ‘kombëtar’) dhe në vendet e tjara të Ballkanit Perëndimor (sondazhi ‘rajonal’), sikurse edhe nga intervistat dhe konsultat e organizuara në kuadrin e disa projekteve mbi trafikimin, del se përgjithësisht kuptimi mbi trafikimin është i cekët, i njëanshëm dhe, shpesh, i pasaktë. I mangët është edhe kuptimi mbi mënyrat e rekrutimit, kategoritë e njerëzve që mund të jenë objekt trafikimi, dallimin midis trafikimit dhe shfrytëzimit seksual (prostitucionit), apo kontrabandës, sikurse profilin e rrezikshmërisë së trafikimit etj.

Në kohën tonë trafikimi, sikurse prostitucioni profesionist, është një fenomen global⁵⁶. Ndaj edhe përkufizimi për trafikimin është pranuar në nivel ndërkombëtar. Ai është bërë nga protokollin për “Parandalimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore”, si plotësues i konventës së Kombeve të Bashkuara mbi “Krimin e Organizuar Ndërkombëtar” (Palermo, 2000). Kjo konventë është ratifikuar edhe nga qeveria shqiptare. Sipas këtij protokollin (neni 3a), trafikim i qenieve njerëzore do të ëhotë:

“rekrutim, transportim, transferim, strehim ose mbajtje e personit me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtërngimit,

⁵⁶ Shih, gjithashtu, Lekë Sokoli, 2006d. *Prostitucioni si profesion (Vështrim sociologjik)*. Tiranë: Rinia & Instituti i Sociologjisë.

rëmbimit, mashtrimit, gënjjimit, abuzimit me pushtetin ose me pozitën e më të dobët, me dhënie-marrjet e pagesave ose përfitimeve, për të arritur pëlqimin e një personi për të kontrolluar një tjetër, me qëllim shfrytëzimi”

Ky përkufizim i gjatë duket relativisht i vështirë. Këtë kanë patur parasysh hartuesit e moduleve të trainimeve të IOM-it, të cilët kanë dhënë një tabelë me elementët thelbësorë të përkufizimit të trafikimit (tab. 38).

Tabela 38: Elementët thelbësorë të trafikimit

Procesi	Plus	Rrugët, mënyrat	Plus	Qëllimi, synimi
Rekrutimi Ose transportimi		Kërcënimi Përdorimi i forcës (detyrimi)		Psostitucioni Pornografia
ose transferimi ose strehimi		Shtyrëngimi Rëmbimi		Dhunë seksuale Punë e detyruar, e papaguar, e keqpaguar
ose pranimi (mbajtja, fshihja e personit)	dhe	Mashrimi, gënjjimi, lajkëtimi	dhe	Sklavëri ose robërit
		Abuzimi me pushtetin Abuzimi me nevojën, dobësinë e dikujt Përfitime, dhënie/marrje parash		Lypje Shitje e organeve Për t'u përdorur për veprimtari të paligjëshme

Burimi: Gjedia, Rosenberg, Bergtsson & Haxhia. *Trafficking Prevention Training Module for Teachers*. IOM, 2005.

Pra, kemi trafikim në të gjitha kombinimet e mundëshme të skemës së paraqitur në tabelë. Domethënë për çdonjërin nga proceset, plus çdonjërin nga rrugët ose mënyrat e realizimit, plus çdonjërin nga qëllimet për të cilat realizohet ai.

Pra, mund të themi se për të patur trafikim duhet prania e të paktën dy personave, në një marrëdhënie specifike me njëri-tjetrin: i trafikuari (objekti i trafikimit) dhe trafikuesi ose trafikanti. Në këtë marrëdhënie nuk ekziston mirëkuptimi dhe barazia, ose ato janë të gënjeshtërtta. Ndërsa trafikanti kryen një veprim të ndërgjegjshëm, drejtpërdrejt apo me ndërmjetës, i trafikuari, përkundrazi, nuk është i vetëdijshëm për atë që ndodh. Trafikanti,

ose njerëzit e përdorur prej tij, ndjek një qëllim të paracaktuar: shfrytëzimin e tjetrit. I trafikuari, përkundrazi, nuk ndjek një qëllim të tijin, por një qëllim krejt tjetër. Trafikanti është viktimizues i të trafikuarit. I trafikuari është viktimë e trafikimit. Pavarësisht se në marrëdhënien ‘viktimizues-i viktimizuar’ përdoren edhe elementë mashërimi etj., përsëri forca ose kërcënimi i përdorimit të saj është, si rregull, i pranishëm në trafikim. Ndryshe viktima do të çlirohej nga vargonjtë e trafikantit⁵⁷.

Lidhur me larminë e formave të trafikimit, mund t’u referohemi të dhënave që pasqyrojnë rastet e viktimitëve të trafikimit, të asistuar në vendet e Evropës Juglindore (tab. 39).

Tabela 39: Format e trafikimit në Evropën Juglindore

Format e trafikimit	Frekuanca në vite			
	2003		2004	
	Në numër	Në përqindje	Në përqindje	Në numër
Shfrytëzim seksual	824	65.2	74.2	864
Punë	91	7.2	4.1	48
Lypje, veprimtari kundërligjore	51	4.0	6.4	75
Adoptim	0	0.0	0.8	9
Shfrytëzim seksual + punë	245	19.4	8.3	97
Shfrytëzim seksual + lypje+ vepr. joligjore	10	0.8	2.3	27
Punë + lypje+ vepr. joligjore	11	0.9	0.2	2
Të katra bashkë	1	0.1	0.0	0
Të tjera forma	31	2.5	3.7	43

Burimi: Second Annual Report on Victims of Trafficking in South-Eastern Europe, 2005, fq. 33

Të kuptuarit e përmbajës së fjalës ‘trafikim’ ishte një ndër elementë të sondazhit ‘rajonat’. Rreth 2400 të anketuarve nga Shqipëria, Maqedonia, Kosova, Bosnje Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia u është kërkuar, që të bëjnë përcaktimin më të saktë

⁵⁷ Megjithatë, siç shihet edhe në tabelën 36, përdorimi i forcës nuk është një komponent detyrimisht i pranishëm në çdo rast trafikimi. Mjafton edhe kërcënimi apo mashërimi etj., që krimi i trafikimit të konfigurohet edhe përballë një “konsensusi” eventual, apo pranueshmërie ‘në rrethana të caktuara’, nga ana e viktimës.

të trafikimit, për disa raste të mundshme, të parashëruara në pyetësor⁵⁸ (fig. 5). Të dhënat tregojnë se 55 për qind e tyre kanë zgjedhur si më të saktën alternativën që përfshin si shfrytëzimin seksual ashtu edhe shfrytëzimin për punë me forcë ose nën kërcënimin e forcës (e treta).

Nga 1314 persona që kanë përzgjedhur këtë alternativë, shumica e tyre (64.6 për qind) janë nga “të trainuar”. Por 12.5 për qind e nxënësve dhe të rinjve nuk janë në gjendje që, midis alternativave të dhëna, të diferencojnë më të saktën.

Në këtë grup konstatohet një diferencim midis përgjigjeve të dhëna nga të anketuarit “të trajnuar” (6.3 për qind) dhe “të patrainuar” (21 për qind). Të anketuarit “të patrainuar”, që nuk arrijnë të japin përgjigjen e saktë, janë rreth 3 herë më shumë se të anketuarit nga grupi “të trainuar”.

Por, nga 372 nxënës dhe të rinj që e perceptojnë trafikimin të lidhur vetëm me prostitucionin (e katërta), 56 për qind e tyre janë “të patrainuar”.

Kjo tregon se trainimet e bëra kanë ndihmuar në një perceptim më të plotë të trafikimit, nga nxënësit dhe të rinjtë.

Figura 5: Përkufizimi më i saktë i trafikimit



Burimi: Anketa sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

⁵⁸ Në rastet kur: a) një fëmijë transportohet jashtë vendit dhe detyrohet me forcë të lypë; b) një emigranti nuk i paguhet rroga ose rroga e plotë që i është premtuar; c) një person transportohet jashtë vendit për shfrytëzim seksual me forcë/kërcënim ose për punë të deçyruar; dhe kur d) një femër detyrohet të punojë si prostitutë, me forcë ose nën kërcënimin e forcës

Kush mund të jetë viktimë e trafikimit?

Nisur nga përcaktimi i paragrafit të mësipërm, del se viktimë e trafikimit mund të jetë çdo person, pavarësisht nga gjinia, moshë, përkatësia etnike, arsimimi, niveli i pasurisë etj. Por të dhënat e sondazheve tona tregojnë se trafikimi konsiderohet si një veprimtari që prek vetëm femrat. Ky perceptim është i gabuar.

Në raportin vjetor të viktimave të trafikimit për vitin 2005, për vendet e Evropës Juglindore, thuhet, për shëmbull, se:


“Në vitet 2003 dhe 2004 viktimat e asistuar të trafikimit ishin si femra, ashtu edhe meshkuj. Ndonëse pjesa më e madhe e tyre ishin femra, sërish një numer i konsiderueshëm viktimash të asistuar ishin meshkuj. Në Shqipëri, për shëmbull, 70 për qind e viktimave të trafikimit të shfrytëzuara për punë, për të lypur apo për t’u përdorur për veprimtari të paligjësme, ishin meshkuj. Në mënyrë të ngjashme, 47.8 për qind e të trafikuarve nga vende të tjera, për punë të detyruar, në Republikën e Serbisë, për vitin 2004, ishin meshkuj. Viktima meshkuj të trafikimit janë asistuar në Shqipëri, Bullgari, Kroaci, Moldavi, Mali të Zi, Rumani, Serbi dhe Kosovë. Viktima meshkuj të trafikuar për punë të detyruar, për të lypur, për t’u përdorur në veprimtari kriminale, për shitje organesh...”⁵⁹

Për të testuar perceptimin e të anketuarve, lidhur me mundësinë që edhe meshkujt të bëhen viktimat e trafikimit, nxënësve dhe të rinjve që morën pjesë në sondazhin ‘rajonat’ u është kërkuar që të vlerësojnë, nëpërmjet alternativave “e vërtetë”, “e pa vërtetë” dhe “nuk di t’a vlerësoj”, nëse një djalë/burrë mund të jetë ose jo viktimë e trafikimit. Rreth 72 për qind e tyre vlerësojnë se edhe një mashkull (djalë/burrë), mund të jetë viktimë e trafikimit. Vetëm 8.6 për qind japin përgjigjen e gabuar. Duke i ndarë të anketuarit në “të trainuar” dhe “të patrainuar”, del se 81.5 për qind e grupit “të trainuar” japin përgjigje të saktë, kundrejt 58.3 për qind të të anketuarve “të patrainuar” (fig. 6). Sërish

⁵⁹ Cit, Surtees, Rebecca. 2005. Second Annual Report on Victims of Trafficking in South Eastern Europe. Geneva: IOM, p. 13.

konfirmohet ndikimi jo i vogël i trainemeve në zgjerimin e perceptimit mbi trafikimin e qenjeve njerëzore⁶⁰.

Figura 6: *A mund të jetë një mashkull viktimë e trafikimit?*



Burimi: Anketat sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

Trafikimi dhe shfrytëzimi seksual

Trafikimi, siç rezulton nga vetë përkufizimi i tij, përfshin forma të ndryshme shfrytëzimi. Megjithëse të trafikuarit shfrytëzohen edhe për punë, për të lypur, për t'u përdorur në veprimtari kriminale, për adoptim etj., përsëri shumica e të trafikuarve destinohen për shfrytëzim seksual. Referuar informacionit të marrë nga të trafikuarit e asistuar në vendet e Evropës Juglindore, për vitet 2003-2004, del se në një përqindje të konsiderueshme të trafikuarit u janë nënshtruar, në mënyrë të kombinuar, dy ose më shumë formave të shfrytëzimit, për shëmbull, për punë e për të lypur; për punë e shfrytëzim seksual; për të lypur e për shfrytëzim seksual; për shfrytëzim seksual e për t'u përdorur në veprimtari të paligjësme etj.⁶¹. Diferencimi i formave të ndryshme të shfrytëzimit është bërë për të kuptuar qëllimin e tij,


⁶⁰ Në analizën sipas shteteve, lidhur me përgjigjen më të saktë, rezulton kjo renditje: Serbi & Mali i Zi (78.7 për qind), Kosovë (76 për qind), Bosnje-Hercegovinë (72.6 për qind), Maqedonia (65.1 për qind) dhe Shqipëria (64.9 për qind). Thuajse ¼ e të anketuarëve nga Maqedonia dhe Shqipëria nuk janë të aftë të vlerësojnë këtë situatë.

⁶¹ Për më tepër mund të shihet: Surtees, Rebecca, 2006, fq. 12

kategoritë e individëve të rrezikuar për t'u trafikuar, formave të rekrutimit etj., sikurse për hartimin e strategjive parandaluese.

Por të dhënat e sondazheve tona dëshmojnë se ekziston një farë konfuzioni, lidhur me çështjen nëse trafikimi gjithmonë përfshin prostitucionin dhe shfrytëzimin seksual. Në anketën e përdorur në sondazhin 'rajonat' kërkua përgjigje nga rreth 2400 nxënës e të rinj, në gjashtë shtete të Ballkanit rreth pyetjes: "Sipas jush, trafikimi përfshin gjithmonë prostitucionin apo shfrytëzimin seksual?". Përgjigjedhënësve u është kërkuar të përzgjedhin midis alternativave "e vërtetë", e pavërtetë", "nuk di ta vlerësoj". Rreth gjysma e të anketuarëve (50.4 për qind), japin përgjigje të pasaktë. Pra, përgjithësisht, trafikimi perceptohet si i lidhur vetëm me prostitucionin. Madje konstatohet se përgjigje të pasakta jepen edhe nga grupi i të trainuarve nga IOM-i. Megjithatë, edhe në këtë rast, vërejmë diferenca midis të anketuarve "të trainuar", kundrejt atyre "të patrainuar" (fig. 7). Thuajse 70 për qind e atyre që japin përgjigje të saktë janë nga grupi "të trainuar"⁶².

Figura 7: Trafikimi dhe prostitucioni.



Burimi: Anketat sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

Trafikimi dhe kontrabanda e qenieve njerëzore

Kontrabanda e qenieve njerëzore është një tjetër dukuri që haset në të gjitha vendet e rajonit. Ajo, si rregull, është e lidhur me

⁶² Diferencime të mëdha vërehen edhe në përgjigjet që japin të anketuarit nga shtete të ndryshme. Japin përgjigjen më të saktë 51.3 për qind e të anketuarve nga Shqipëria, 43.9 për qind e atyre nga Maqedonia dhe, më pas, vinë Kosova (30.8 për qind), Bosnje-Hercegovina (28.9 për qind) dhe Serbi-Mali i Zi (25.6 për qind).

trafikimin, por nuk është e njëjta gjë. Përkufizimin e trafikimit e dhamë (shih, “Përkufizimi më i saktë i trafikimit”), por ç’është kontrabanda e qenieve njerëzore? Në modulet e hartuara nga IOM, për trainimin e realizuar në vendet e Ballkanit (2006), jepet ky përkufizim:


“Kontrabanda është: a) lehtësimi i hyrjes ilegale të një individi në shtete në të cilat ai nuk është as nënshtetas, as rezident i përhershëm, me qëllim përfitimi, në mënyrë direkte ose indirekte, të të mirave materiale apo financiare; b) hyrja e jashtëligjshme do të kuptojë kalimin e kufijve pa plotësuar kërkesat e nevojshme për hyrje të ligjshme në shtetin pritës”.⁶³

Pra, ndryshe nga trafikimi, kontrabanda ka të bëjë jo me shfrytëzimin e dikujt, me qëllim fitimi, por me kalimin e paligjshëm të kufirit kombëtar, gjithnjë për të përfituar të mira materiale apo financiare. Por, sa të qartë janë njerëzit, sidomos nxënësit dhe të rinjtë, për kontrabandën dhe dallimin e saj nga trafikimi. Për të testuar këtë, të anketuarve nga vendet e Ballkanit, u janë parashtruar disa situata përmes të cilave u kërkohej të jepnin vlerësimin më të saktë për kontrabandën e qenieve njerëzore. Atyre u është kërkuar, së pari, që nga përshkrimi i disa rasteve të kontrabandës të përzgjidhnin përgjigjen që i korrespondon përcaktimit më të saktë të saj⁶⁴. Përgjigjet e marra nga kategoria “të trainuar” dhe “të patrainuar” janë paraqitur në fig. 8.

⁶³ Sipas “Gjedia, Robert, Ruth Rosenberg, Ana Bergtsson & Silvana Haxhia. 2005. *Trafficking Prevention Training Module for Teachers*. Tirana: International Organisation for Migration. Ky përkufizim përdoret në shkallë ndërkombëtare pasi është marrë, në fakt, nga protokollu “Kundër kontrabandës së migrantëve nga toka, ajri dhe deti”, si shtojcë e konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.

⁶⁴ Këto raste janë: 1) kur një person hyn ilegalisht në një vend tjetër, në të cilin ai nuk është shtetas; 2) kur një person paguan dikë për të hyrë ilegalisht në një vend në të cilin ai nuk është shtetas; 3) kur një person hyn legalisht në një vend tjetër, por punon pa leje pune; dhe 4) kur një person hyn legalisht në një vend tjetër dhe detyrohet të punojë nën kërcënimin e forcës pa u paguar.

Figura 8: Përcaktimi i saktë i kontrabandës



Burimi: Anketa sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

Nga të dhënat rezulton se 56.4 për qind e të anketuarëve e perceptojnë kontrabandën si të lidhur me kalimin ilegal të kufirit (përgjigjet 1 dhe 2). Ndërsa 27.2 për qind e tyre kanë një perceptim jo të drejtë për kontrabandën. Ata konsiderojnë si kontrabandë edhe rastet që nuk kanë të bëjnë me kalimin ilegal të kufirit (përgjigja 3 dhe 4). Derisa vlerësimi më i saktë i kontrabandës përfaqëson rastin kur një person paguan dikë për të shkuar ilegalisht në një shtet tjetër (alternativa 2), duket diferencimi në vlerësime midis të anketuarve të dy kategorive: “të trainuar” dhe “të patrainuar”. Rreth 35 për qind e të anketuarve “të trainuar” zgjedh këtë alternativë si vlerësimin më të saktë të kontrabandës, kundrejt 18 për qind e të anketuarve “të pa trainuar” (fig. 8). Ndikimi i trainimeve duket, gjithashtu, edhe në faktin se vetëm 9.5 për qind e të anketuarëve “të trainuar” japin përgjigjen “nuk e di”, kundrejt 25.8 për qind e atyre “të patrainuar”⁶⁵.


Gjithashtu, për të testuar nivelin e njohurive për kontrabandën është kërkuar informacioni i nxënësve dhe të rinjve të anketuar për rastet kur marrën para nga dikush që të kalojë ilegalisht kufirin kombëtar⁶⁶. Nga të dhënat (shih, fig. 9), rezulton se 68.6 për qind e të anketuarëve japin përgjigjen e duhur, duke pohuar se të

⁶⁵ Në analizën sipas shteteve, referuar përgjigjes që është më afër së vërtetës, rezulton kjo renditje: Kosova (35.8 për qind), Shqipëria (32.8 për qind), Maqedonia (30.9 për qind), Bosnje-Hercegovina (21.6 për qind) dhe Serbi-Mal i Zi (18.3 për qind).

⁶⁶ Pyetja ishte formuluar kështu (anketa, pyetja 17a): “Është e kundraligjshme të marrësh para për të ndihmuar dikë që të kalojë ilegalisht kufirin kombëtar” Alternativat e mundëshme të përgjigjeve ishin: 1. E vërtetë; 2. E pavërtetë; 3. Nuk di t’a vlerësoj.

marrësh para nga dikush, për të kaluar ilegalisht kufirin kombëtar, është kontrabandë. Nga të anketuarit e grupit “të trainuar” përgjigja e saktë jepet nga 75.5 për qind, kundrejt 59.2 për qind e të anketuarëve “të patrainuar”. Për qindja e atyre që nuk arrijnë të perceptojnë dallimin e këtyre rasteve është rreth dy herë më e madhe tek të anketuarit që përbëjnë grupin “të patrainuar” (25 për qind), kundrejt atyre “të trainuar” (12.8 për qind).


Figura 9: Vlerësimi mbi kalimin ilegalisht të kufirit kundrejt pagesës



Burimi: Anketa sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

Një pyetje tjetër e anketës sociologjike ‘rajonale’ kërkonte informacionin e përgjigjedhënësve lidhur me çështjen nëse kontrabanda ndodh vetëm me forcë ose nën kërcënimin e forcës? Rezulton se vetëm 34.8 për qind e të anketuarëve japin përgjigjen e duhur se kontrabanda ‘nuk ndodh vetëm me forcë ose nën kërcënimin e forcës’. I dukshëm është diferencimi midis të anketuarëve nga kategoria “të trainuar”, kundrejt atyre “të patrainuar” (fig. 10). Rreth 42 për qind e të anketuarëve “të trainuar” japin përgjigjen e saktë, kundrejt 25.3 e atyre “të patrainuar”.


Figura 10: Kontrabanda ndodh vetëm me forcë?



Burimi: Anketa sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

Për të marrë një informacion mbi nivelin e perceptimit të dallimit midis trafikimit dhe kontrabandës, është supozuar edhe një situatë konkrete⁶⁷. Nga analiza e saj del se më pak se gjysma e të anketuarëve (46.6 për qind) kanë dhënë përgjigjen korrekte, duke pohuar se kjo situatë përbën njëherësh edhe trafikim edhe kontrabandë. Nga nxënësit e të rinjtë e anktuar, që japin përgjigjen e saktë, rreth 60 për qind i përkasin kategorisë “të trainuar” dhe rreth 40 për qind “të patrainuar” (fig. 11). Përqindja e të anketuarëve “të trainuar” që japin vlerësimin “nuk e di” është mbi katër herë më e vogël se e atyre “të patrainuar” (6.4 për qind kundrejt 25.8 për qind).

Figura 11: *Dallimi midis trafikimit dhe kontrabandës*



Burimi: Anкета sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

Në analizën sipas përkatësisë gjinore të të anketuarëve, rezulton se femrat kanë dhënë përgjigje korrekte në masën 10 për qind më shumë se meshkujt (51.5 për qind, kundrejt 41.5 për qind).

Informimi dhe edukimi. Domethënia e një projekti

Nga sondazhet tona del se parandalimi i trafikimit dhe kontrabandës varet, në një masë të konsiderueshme, nga sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i të rinjëve, të lidhura këto me nivelin e njohurive të tyre. Si nga sondazhi ‘kombëtar’, ashtu edhe nga ai ‘rajonar’, del se në

⁶⁷ Situata e supozuar është kjo: “Një burrë ka paguar dikë për të kaluar kufirin ilegalisht. Më vonë është detyruar të punojë me forcë për llogari të një tjetri. Pyetja që shtrohet është: kjo situatë përbën: “trafikim”, “kontrabandë”, apo “të dyja bashkë”?.

Shqipëri, sikurse në vende të tjera të rajonit, media vlerësohet si burimi kryesor i informimit. Kjo do të thotë se shumica e individëve, sidomos e nxënësve dhe e të rinjëve, nuk marrin një *informacion të adresuar*. Shkolla mund dhe duhet të shndërrohet në burimin kryesor të informimit të saktë mbi trafikimin dhe kontrabandën. Duhet të bëhet e mundur që të gjithë ata që përfundojnë shkollën 9 vjeçare (aq më shumë atë të mesme), të kenë njohuri të mjaftueshme për trafikimin, sikurse për probleme të tjera sociale të kohës, pra të jenë ndërgjegjësuar për profilin e rrezikshmërisë dhe mënyrat e evitimit të tyre.

Ndaj *marrja e informacionit për trafikimin e qenieve njerëzore, përmes përfshirjes në programet shkollore apo formave të tjera që aplikon shkolla, duket se është forma më e mirë për institucionalizimin e një informimi të kualifikuar për rininë shkollore, e cila është në skalonin e parë të përfshirjes në trafikim.*

Sidomos sondazhi ‘rajonal’ dëshmoi ndikimin e trainimeve dhe, përgjithësisht të edukimit, në rritjen e nivelit të njohurive mbi trafikimin dhe kontrabandën e qenieve njerëzore. Në tabelën 40 janë dhënë, në mënyrë të përmbledhur, rezultatet e testimit për dhjetë pyetje të konsideruara si instrument matës të nivelit të njohurive, për individë “të trajnuar” dhe “të patrainuar”.

Tabela 40. Përgjigjet korrekte për përgjigjedhënës “të trajnuar” e “të patrainuar”

	Përkufizimi më i saktë i trafikimit : 64.4	“Të trajnuar” : 42.5	“Të patrainuar” : 24.9
2. A mund të jetë një mashkull viktimë e trafikimit?	81.5	58.3	23.2
3. Trafikimi nënkupton gjithmonë prostitucionin dhe shfrytëzimin seksual?	43.0	26.3	16.7
4. Përkufizimi më i saktë i kontrabandës	63.7	46.5	17.2
5. Të marrësh para nga dikush për të kaluar ilegalisht kufirin, çfarë është?	75.5	59.2	16.3
6. Kontrabandan ndodh gjithnjë me forcë?	41.8	25.3	16.5
7. Dallimi midis trafikimit dhe kontrabandës	53.2	37.6	15.6
8. Trafikimi me premtime për martesë	71.0	62.8	8.2
9. Trafikimi me premtime për punësim jashtë vendit	81.8	69.9	11.9
10. Trafikimi me premtime për studime jashtë shtetit	62.4	52.7	9.7
	Diferenca mesatare		15.7

Siç shihet, diferenca në nivelin e njohurive mbi trafikimin, midis dy grupeve të marra në shqyrtim, për dhjetë pyetjet e anketës sociologjike, është rreth 16 për qind. Ndikimi duhet të jetë shumë më i madh nëse trainimet bëhen pjesë e programeve shkollore (kurrikulave). Kjo sepse njohuritë mbi trafikimin do të lidheshin me punën sistematike të shkollës, me interesat e nxënësve për t'u vlerësuar, me konkurrencën (garën) midis nxënësve e mësuesve etj. Për të matur cilësinë dhe rendimentin e trainimeve të bëra në vende dhe shkolla të ndryshme të rajonit të Ballkanit, sikurse efektin e mënyrave origjinale të transmetimit të njohurive (në lëndë e forma të ndryshme), është bërë njëfarë klasifikimi dhe vlerësimi për të gjitha shkollat dhe OJQ-të e përfshira në studim, sikurse për të gjitha shtetet e veçanta.

Tabela 41: Vlerësimi i shteteve sipas përgjigjeve korrekte, të anketuar “të trainuar”

Pyetjet që kërkonin përgj. korrekte	Shqipëria	Shtetet pjesëmarrëse			
		Bosnie- Herzegovina	Maqedonia	Kosova	Serbi Mali i Zi
1	55.0	53.5	66.8	69.0	68.8
2	76.1	84.0	76.4	79.8	90.5
3	59.1	35.0	59.5	31.6	34.0
4	74.6	51.6	78.7	67.6	44.0
5	75.3	76.4	79.8	78.2	68.2
6	43.5	35.0	60.2	30.1	41.2
7	53.0	64.3	47.5	49.5	57.2
8	81.4	68.8	66.5	64.5	75.8
9	80.2	82.8	73.9	85.4	85.2
10	68.8	66.2	67.8	56.2	58.6
Shuma	667	617.6	677.1	611.9	623.5
Renditja	II	IV	I	V	III

Burimi: Anketa sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

Në tabelën 41 shihen diferencat në nivelin e njohurive për individtë e grupit “të trainuar”, pavarësisht se trainimet e IOM-it kanë qenë unike. Ky rezultat është ndikuar nga një sërë faktorësh, siç janë mosha e përgjigjedhënësve⁶⁸, vendbanimi i tyre, trainimet e mëparshme (veç atyre

⁶⁸ Mosha mesatare e rreth 2400 të anketuarve ishte 14.8 vjeç. Por midis shteteve kishte diferenca moshore jo aq të papërfillshme. Mosha mesatare e të anketuarve nga Bosnje-Hercegovina ishte 16.1 vjeç, atyre nga Maqedonia 15.7 vjeç, nga Kosova 15.1 vjeç, Serbi-Mali i Zi 14.1 vjeç, ndërsa e të anketuarve nga Shqipëria vetëm 13.4 vjeç.

të IOM-it), tipi i shkollës (nëntë vjeçare apo e mesme, e përgjithëshme apo profesionale etj.), ndikimi i ndryshëm i mediave etj.

Për të pasqyruar më qartësisht ndikimin e trainimeve në përgjigjet korrekte, është bërë njëfarë klasifikimi midis shteteve, sipas diferencës së rezultatit të marrë midis individëve të të dy grupeve (tab. 42).

Tabela 42: Vlerësimi i shteteve të sonduara për të dy grupet

Pyetjet që kërkohin përgj. korrekte	Shqipëria		Shtetet pjesëmarrëse							
			Bosnie-Herzegovina		Maqedonia		Kosova		Serbi Mali i Zi	
	Tr. ¹	Pa tr.	Tr.	Pa tr.	Tr.	Pa tr.	Tr.	Pa tr.	Tr.	Pa tr.
1	55.0	26.9	53.5	34.2	66.8	50.7	69.0	30.4	68.8	50.8
2	76.1	52.0	84.0	61.4	76.4	53.6	79.8	43.5	90.5	66.9
3	59.1	42.1	35.0	22.8	59.5	28.1	31.6	23.9	34.0	17.1
4	74.6	49.0	51.6	41.8	78.7	52.7	67.6	26.1	44.0	44.8
5	75.3	59.9	76.4	60.5	79.8	62.9	78.2	78.2	68.2	52.2
6	43.5	12.4	35.0	38.6	60.2	29.1	30.1	6.5	41.2	26.3
7	53.0	31.8	64.3	51.6	47.5	42.1	49.5	28.3	57.2	31.9
8	81.4	78.3	68.8	48.1	66.5	57.0	64.5	56.5	75.8	66.1
9	80.2	66.8	82.8	67.7	73.9	68.7	85.4	63.0	85.2	74.8
10	68.8	60.4	66.2	54.4	67.8	55.9	56.2	52.2	58.6	44.5
Shuma e pikëve	667	479.6	617.6	481.1	677.1	500.8	611.9	408.6	623.5	475.4
Diferenca	187.4		136.5		176.3		203.3		148.1	
Renditja	II		V		III		I		IV	

Siç shihet, diferencat në përgjigjet korrekte, midis të anketuarve “të trainuar” dhe “të patrainuar” shkon nga 203.3 pikë (Kosova, vendi I), në 136.5 (Bosnje-Hercegovina, vendi V). Megjithëse qëllimi i projektit nuk ishte vënia në garë dhe klasifikimi i shteteve pjesëmarrëse, përsëri ky rezultat ka domathënie e vet.

⁶⁹ ‘Tr.’ = ‘të trainuar’ nga IOM-i; ‘Pa tr’ = ‘të patrainuar’ nga IOM-i, gjatë projektit të realizuar në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Pjesa IV: Të dhëna socio-demografike mbi të trafikuarit

Informacioni mbi të trafikuarit e derisotëm mund të merret në disa mënyra. Pothuajse në të gjitha studimet mbi trafikimin, autorët e tyre kanë shfrytëzuar të dhëna mbi viktimat e asistuar të trafikimit, të marra nga qendrat e ndryshme që janë ngritur në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor e, më gjerësisht, të Evropës Juglindore. Këto të dhëna u referohen, gjithsesi, intervistave me të rikthyerit nga trafikimi⁷⁰. Por, në referencat ndaj tyre duhet mbajtur parasysh, të paktën dy gjëra.

Së pari, që përgjigjet e tyre kanë, gjithsesi, një shkallë të caktuar vërtetësie. Kjo lidhet me sinqeritetin e pohimeve të përgjigjedhënësve. Të dhënat tregojnë se, në shumë raste, ish të trafikuarit kanë dhënë dëshmi të rezervuara, qoftë në intervistat që ata kanë dhënë në qendrat pritëse, apo edhe edhe në dëshmitë e bëra gjatë proceseve të ndryshme gjyqësore. Kjo është ndikuar edhe nga shkalla e të ndjerit ende të rrezikuar nga (ri)trafikimi dhe trafikantët.

Së dyti, ‘viktimat e asistuar të trafikimit’⁷¹, të cilave u referohen më shumë studimet, janë shumë më pak se ‘viktimat e rikthyer’. Jo

⁷⁰ Nder burimet që u referohen ‘viktimave të asistuar të trafikimit’ përmendim: Surtees, Rebecca. 2005. *Second Annual report on Victims of Trafficking in South Eastern Europe*. Geneva: International Organisation for Migration (IOM); Vatra, Qendra Psiko-Sociale. 2002. *Vajzaë dhe trafikimi*. Vlorë; Leskaj, Valentina, Edmond Dragoti, Theodhori Karaj & Fiona Todhri. 2004. *Shoqëria shqiptare përballë sfidave të trafikut të grave dhe vajzave*. Tiranë, qershor; Hëna e Re. 2006. *Pabarazia, dhuna ndaj grave e trafikimi*. Elbasan: Qendra e Gruas etj.

⁷¹ Numri i ‘viktimave të asistuar të trafikimit’, në të gjitha vendet e Evropës Juglindore, të marra së bashku, për vitin 2003 ka qenë 1329 persona, ndërsa për vitin 2004, 1227 persona. Për të gjithë periudhën 2000-2005, nmri i viktimave të asistuar për këto vende ka qenë 6255 (shih: Number of Identified and Assisted Trafficking Victims in South-Eastern Europe”, Surtees, Rebecca, 2006, tab. 1, fq. 31)

të gjithë ata që shpëtojnë nga trafikimi marrin asistencë në qendrat psiko-sociale. Numri i ‘viktimave të asistuar të trafikimit’ është, gjithashtu, shumë më i vogël kundrejt numrit të ‘viktimave të trafikimit’. Por edhe numri i ‘viktimave të trafikimit’ (atyre që janë në momentin e dhënë në rrjetin e trafikimit), është më i vogël në raport me ‘viktimat potenciale të trafikimit’ apo ‘të rrezikuarve drejtpërdrejt nga trafikimi’. Ky kategorizim sugjeron një larmi formash të kërkimit të faktit sociologjik mbi trafikimin.

Në punimin tonë janë kombinuar referencat me burim pohimet e ‘viktimave të asistuar të trafikimit’, me të dhëna sasiore të dy anketimeve, ‘kombëtar’ dhe ‘rajonal’, që kemi realizuar, respektivisht në vitet 2005 dhe 2006. Në sondazhin ‘kombëtar’, për shëmbull, 1030 të anketuarve nga Kuksi, Shkodra, Elbasani, Vlora, Gjirokastra dhe Korça u është kërkuar informacion lidhur me një të trafikuar që ata njohin. Kjo për të marrë një informacion të tërthortë, ‘për dikë tjetër’, normalisht, pa patur kopmlekse. Ne kemi siguruar, gjithsesi, një informacion të dobishëm për 587 individë të trafikuar.

Grupmoshat e të trafikuarve

Për t’u informuar lidhur me moshën e të trafikuarve, përgjigjedhënësve të pyetsorit ‘kombëtar’ u kemi drejtuar pyetjen: “Referuar këtij rasti konkret, ç’moshë kishte i(e) trafikuari(a)?”. Në tabelën e mëposhtëme (tab. 43), jepen të dhënat mbi grupmoshën e të trafikuarve, sipas vendbanimeve (qytete të mëdha, qyëeza dhe fshatra).

Tabela 43: *Grupmoshat e personave të trafikuar, sipas vendbanimeve (Në përqindje)*

Grupmoshat e të trafikuarve	Të trafikuarit, sipas vendbanimit			Për kampionin ‘kombëtar’
	<i>Qytete të mëdha</i>	<i>Qytete të vogla</i>	<i>Fshatra</i>	
12-15 vjeç	14.7	11.2	14.5	13.8
16-18 vjeç	46.6	48.5	57.2	50.2
19-21 vjeç	30.5	32.1	14.5	26.1
Mbi 21 vjeç	8.2	8.2	13.8	9.9
<i>Gjithsej</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>

Siç shihet, të trafikuarit janë, në përqindjen më të madhe, të grupmoshës 16-18 vjeç. Për kampionin 'kombëtar' të kësaj grupmoshe janë, pak më shumë, ½ e të trafikuarve (50.2 për qind). Sipas këtyre pohimeve trafikimi nga kjo grupmoshë është më e theksuar në fshatra (57.2 për qind) se në qytetet e vogla (48.5 për qind) e të mëdha (46.6 për qind). Në rendin e dytë vijnë të trafikuarit nga grupmosha 19-21 vjeç. Të kësaj grupmoshe janë, sipas përgjigjeve, 26.1 për qind e të trafikuarve. Del, gjithashtu, se grupmosha mbi 21 vjeç është relativisht 'më e imunizuar' nga trafikimi. Afërsisht vetëm një në çdo dhjetë të trafikuar i takon kësaj grupmoshe.

Në një masë disi më të madhe është përqindja e të trafikuarve të grupmoshës 12-15 vjeç. Nëse i referohemi legjislacionit shqiptar, lidhur me moshën në të cilën individët fitojnë aftësinë e plotë juridike për të vepruar, del se në përgjithësi, 12-18 vjeçarët janë individë që përbëjnë shumicën e të trafikuarve. Sipas pohimeve të marra del se ata përbëjnë 64 për qind të kontigjentit prej 587 individësh të trafikuar. Sidomos për këtë kategori sociale përgjegjësia e institucioneve të shoqërisë është më e madhe.

Rezultatet e anketimit tonë konfirmohen, përgjithësisht, edhe nga të dhënat e nxjerra për grupmoshat e viktimave të asistuara të trafikimit. Sipas raportit të fundit të Organizatës Ndërkombëtare të Migrimit, me qendër në Gjeneve, për vendet e Evropës Juglindore, del se vitet e fundit përfshirja e minoreneve në trafikim është në rritje në të gjitha vendet e këtij rajoni. Sipas këtij burimi,

Në disa nga këto vende, si Serbia, Shqipëria dhe Bosnje-Herzegovina minorenet vendas ishin në një përqindje mjaft të lartë, midis viktimave të asistuara të trafikimit. Në mjaft qendra ata përbëjnë shumicën. Në Serbi, për shëmbull, në vitin 2004, kundrejt vitit 2003, përqindja e minoreneve midis viktimave serbe të trafikimit, u rrit nga 20 në 65 për qind. Edhe në Bosnje-Herzegovinë përqindja e minoreneve viktimave të asistuara të trafikimit pësoi një rritje me 58.6 për qind. Në Shqipëri, në vitet 2003-2004, 100 për qind e viktimave të asistuara të trafikimit, të shfrytëzuara për punë, për të lypur apo për t'u përfshirë në veprimtari kriminale ishin

minorenë. Përqindja e minorenëve të trafikuar rezulton në rritje edhe në rastet e trafikimit për shfrytëzim seksual, adoptim etj.⁷²

Të trafikuarit për nga niveli i arsimit

Me të njejtën procedurë, sikurse për grupmoshat, kërkuam dhe siguroam informacion edhe për niveli arsimor të të trafikuarve (anketa 'kombëtare', pyetja 20). Ky informacion është sistemuar në tabelën 44.

Tabela 44: *Niveli arsimor i të trafikuarve në vartësi të vendbanimit (Në përqindje)*

Arsimimi i të trafikuarve	Të trafikuar sipas vendbanimit			Për kampionin 'kombëtar'
	<i>Qytete të mëdha</i>	<i>Qytete të vogla</i>	<i>Fshatra</i>	
I(c) pashkolluar	5.1	6.8	1.1	4.3
Fillor (deri katër vjet)	2.9	2.3	9.7	4.8
Tetëvjeçar	55.4	44.7	38.3	47.9
I mesëm	34.8	43.9	46.3	40.3
I lartë	1.8	2.3	4.6	2.7
<i>Gjithsej</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>

Pyetja e anketës ishte formuluar në mënyrë të tillë që të vlerësohej arsimi që kishin kryer ose që vazhdonin të trafikuarit, në çastin e trafikimit. Siç shihet, shumica e të trafikuarve kishin kryer ose vazhdonin arsimin 8 vjeçar (47.9 për qind). Një pjesë e konsideruar e tyre (40.3 për qind), kishin kryer ose vazhdonin arsimin e mesëm. Sipas përgjigjeve të marra del se, në ndonjë rast, janë trafikuar edhe individë me arsim të lartë ose studentë (2.7 për qind), kjo më e theksuar në zonaë rurale (4.7 për qind).

Dominimi i nivelit të ultë arsimor lidhet jo vetëm me problemet e arsimit të popullsisë shqiptare në këto 10-15 vjet të tranzicionit, por edhe me faktin se të rinjtë që trafikohen nuk mund të kenë nivel më të lartë arsimor, derisa shumica e tyre është e grupmoshës 12-18 vjeç (tab. 40). Pra, midis nivelit arsimor dhe procesit të

⁷² Buimi: Surtees, Rebecca. 2005. *Second Annual Report on Victims of Trafficking in South Eastern Europe*. Geneva: International Organisation for Migration (IOM).

trafikimit rezulton një lidhje e dyfishtë. *Nga njëra anë, individët me nivelin më të ultë arsimor janë më të rezikuarit nga trafikimi. Nga ana tjetër, akti i trafikimit shënon edhe ndërprerjen e procesit të arsimimit të individëve të trafikuar.*

Në disa studime të mëparshme janë nxjerrë edhe përfundime disi të kontestueshme, lidhur me theksimin e tepruar të ndikimit të nivelit arsimor të të trafikuarve. Në “Shoqëria shqiptare përballë sfidave të trafikimit”⁷³, për shëmbull, thuhet:

Karakteristikë e vajzave të trafikuar është niveli i tyre i ulët arsimor. Nga intervistat e realizuara me këtë kategori vajzash del se 90 për qind vajzave të trafikuar janë pa shkollë ose kanë arsim fillor dhe tetëvjeçar... Shumica e tyre nuk kanë bërë shkollë fare ose e kanë lënë përgjysëm, deri katër, gjashtë apo shtatë klasë.

Lidhur me nivelin arsimor të të trafikuarve, në nivel rajonal, mund të citojmë raportin e fundit të IOM-it, mbi viktimat e asistuar të trafikimit, për vendet e Evropës Juglindore, në të cilin thuhet:

“Përgjithësisht, viktimat e trafikimit kanë nivel të ulët arsimor. Megjithatë, një numër viktimash të trafikimit nga Ukraina, Moldavia, Rumania dhe Bullgaria kanë nivel të lartë edukimi, duke përfshirë edhe diploma universitetesh dhe kolegësh. Një pjesë e konsiderueshme e viktimave të asistuar të trafikimit kanë nivel arsimor të njëjtë apo edhe më të lartë se popullsia e përgjithëshme e vendit nga vinë ato. Kjo tragon se në trafikimin nuk ndikon vetëm niveli i ulët arsimor i personave të trafikuar”⁷⁴

Niveli i punësimit të të trafikuarve

Trafikimi është një rezultante faktorësh socio-ekonomikë, të cilët ndikojnë në mënyën dhe nivelin e jetës në vendet e origjinës. Ndër ta puna, si institucion, me kompleksin e marrëdhënieve të lidhura

⁷³ Shih, për shëmbull, Leskaj ed al. 2004, fq. 29.

⁷⁴ Buimi: Surtees, Rebecca. 2005. *Second Annual Report on Victims of Trafficking in South Eastern Europe*. Geneva: International Organisation for Migration (IOM).

me të, rezulton të ketë një ndikim të vaçantë. Përgjithësisht, trafikimi ‘motivohet’ me punën jashtë shtetit kombëtar.

Për të analizuar raportin ‘punë-trafikim’ janë kërkuar të dhëna si në sondazhin ‘kombëtar’, ashtu edhe në atë ‘rajonal’. Një pyetje e anketës ‘kombëtare’, për shëmbull, kërkonte informacionin e të anketuarve lidhur me faktin nëse të trafikuarit kanë qenë ose nuk kanë qenë në marrëdhënie pune, para apo në çastin e trafikimit (anketa ‘kombëtare’, pyetja 21). Përgjigjet rreth saj janë pasqyruar në tabelën 45. Analiza, për 587 të trafikuar, është bërë në vartësi të vendbanimit.

Tabela 45: Nivelin e punësimit të të trafikuarve, sipas vendbanimit

Niveli i punësimit të të trafikuarve	Të trafikuar sipas vendbanimit			Për kampionin ‘kombëtar’
	<i>Qytete të mëdha</i>	<i>Qytete të vogla</i>	<i>Fshatra</i>	
I (e) punësuar	6.5	6.7	2.9	5.5
I papunësuar ndonjëherë	63.3	62.7	37.8	55.7
Nxënës ose student	24.5	24.6	51.7	32.5
Minoren (nën 16 vjeç) që ka lënë shkollën	5.7	6.0	7.6	6.3
<i>Gjithsej</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>

Nga të dhënat del se shumica e të trafikuarve (55.7 për qind), nuk kanë qenë të punësuar ndonjëherë. Nëse llogarisim edhe 32.5 për qind të të trafikuarve, që në çastin e trafikimit kanë qenë nxënës ose studentë, si dhe minorenët e trafikuar (6.3 për qind), atëherë del se, në shumicë absolute, të trafikuarit nuk kanë njohur më parë marrëdhëniet e punës. Ky është një rezultat i pritshëm, derisa shumica e të trafikuarve (respektivisht 64 për qind), janë të moshës deri në 18 vjeç⁷⁵.

Trafikimi midis të papunësuarve ndonjëherë është gati dyfish më i theksuar në qytete (të mëdha apo të vogla) se në fshatra. Ky diferencim lidhet, në një masë të konsiderueshme, me faktin se fshati e ka gjithnjë gati një front për (vetë)punësimin e të rinjëve të vet: ekonominë fshatare.

Fakti që vetëm 5.5 për qind e të trafikuarve kanë qenë të punësuar në çastin e trafikimit, e bën gati të pamundur hulumtimin e ndikimit të grupeve (kolektivave) të punës e të vetë punës, si institucion, mbi

⁷⁵ Shih, në këtë kapitull, “Grupmosha e të trafikuarve”.

trafikimin e grave dhe të adoleshentëve. Nga të dhënat sasiore dhe cilësore të këtij studimi, sikurse nga vetë logjika e trajtimit të problemit, mund të konkludohet, gjithsesi, se *trafikimi shkon në përpjesëim të zhdrejtë me shkallën e integritimit në punë e në kolektivat e punës*. Një puna normalisht e paguar, është edhe një barrierë e trafikimit.

Një pjesë e të trafikuarve në momentin e trafikimit kanë qenë minorenë që kishin braktisur shkollën, ose nuk kanë filluar atë ndonjëherë. Disa diferencime lidhur me këtë kategori, vërtetohen midis kontigjenteve të mundëshme për t'u trafikuar, sipas përatisisë etnike. Ndër to, romët janë komuniteti më i palidhur me shkollën dhe, njëherësh, më i disponueshmi për të nxjerrë kontigjente trafikimi.⁷⁶

Por, të dhënat e këtij studimi dëshmojnë, gjithashtu, se trafikimi do të vazhdojë të ndikohet nga miti i punësimit dhe, më tepër se kaq, i pasurimit përmes emigracionit në një vend perëndimor, kundrejt vendit të origjinës. Një pyetje e sondazhit 'rajonal', drejtuar rreth 2400 nxënësve dhe studentëve, nga gjashtë vendet e përfshira në këtë studim, jep të dhënat e tabelës 46. Analiza është bërë për të anketuarit "e trainuar" dhe të "patrainuar", gjatë projektit të IOM-it mbi trafikimin, nga duken edhe diferencimet në perceptimin e mundësisë së pasurimit.

Tabela 46: Opinione mbi pasurimin në emigracion, për "të trainuarit" dhe "të patrainuarit", sipas shteteve

Pyetja 24d:	Shqipëria		Bosnje-Harzegovina		Maqedonia		Kosova		Serbia & Mali i Zi		Gjithsej
	Tr ¹	Pa tr	Tr	Pa tr	Tr	Pa tr	Tr	Pa tr	Tr	Pa tr	
Ndodh shpesh	14.6	18.4	10.2	13.9	8.5	16.9	18.4	26.1	20.8	15.9	16.8
Ndodh	68.2	62.7	59.9	49.4	66.5	56.1	57.3	45.6	43.9	56.7	56.1
Nuk ndodh kurrë	7.7	10.9	12.7	15.8	16.2	7.2	9.5	6.5	23.9	9.5	10.0
Nuk e di	9.5	8.0	17.2	20.9	8.8	19.8	14.8	21.8	11.4	17.9	17.1
Gjithsej	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100

⁷⁶ Për më tepër shih, shih: De Soto, Beddies, Gëdeshi. 2004: 87-97.

⁷⁷ "Tr" (ose "Activity Group"), janë cilësuar në këtë studim individët e trainuar mbi trafikimin nga IOM-i, para anketimit. Ndërsa "Pa tr" (ose Control Group) është grupi i të anketuarve të pa trainuar.

Siç shihet, një përqindje relativisht e vogël të anketuarish, me pak diferencim midis shteteve dhe grupeve “të trainuar” e “të patrainuar”, pohojnë se pasurimi i një emigranti ballkanas nuk ndodh në një vend përëndimor. Shumica pohojnë se pasurimi i një emigranti është normalisht i mundur.

Gjendja familjare e të trafikuarve

Një informacionin mbi përbërjen familjare të të trafikuarve e kërkuam përmes një pyetje (anketa ‘kombëtare’, pyetja 21), përgjigjet e së cilës janë pasqyruar në tabelën 47.

Tabela 47: Gjendja familjare e të trafikuarve, sipas vendbanimit

Para trafikimit jetonte:	Të trafikuar sipas vendbanimit			Për kampionin ‘kombëtar’
	Qytete të mëdha	Qytete të vogla	Fshatra	
Me të dy prindërit	61.9	56.7	73.9	64.2
Vetëm me nënën	22.7	29.9	7.0	19.7
Vetëm me babain	5.8	1.5	8.7	5.7
Bashkëjetonte me një parëner	2.5	1.5	1.7	2.1
Me bashkëbortin	1.4	1.5	0.0	1.0
Më vete, me të afërm, në	5.7	8.9	8.7	7.4

Informacioni mbi 587 raste trafikimi, dëshmon se shumica e të trafikuarve (64.2 për qind), në çastin e trafikimit, jetonin në familje me të dy prindërit. Por më të rezikuarit konsiderohen individët nga familje me një prind. Përqindja e të trafikuarve nga kjo kategori familjesh bërthamë (25.4 për qind) është më e madhe se pasha specifike e këtyre familjeve, në totalin e familjeve shqiptare. Për t’u theksuar është fakti se, në shumcën e rasteve të familjeve me një prind, ‘prindi i vetëm’ është nëna. Këto rezultojnë të jenë familjet më të kërcënuara nga trafikimi.

Pjesa V: Mënyrat e trafikimit

Mënyrat e trafikimit janë diskutuar edhe në pjesë të tjera të këtij punimi, siç janë përkufizimi, perceptimi i përmasave të trafikimit etj. Gjithë informacioni i siguruar, nga sondazhi ‘kombëtar’ apo ai ‘rajonal’, sikurse gjithë informacioni cilësor, i siguruar kryesisht me intervista (me individë apo grupe fokusi), është kërkuar për të gjitha mënyrat e mundëshme të trafikimit. Më të zakonshmet, ndër to, rezulton të jenë: trafikimi me mashtrim, përmes premtimeve për martesë; me rrëmbim me force nga dikush; me mashtrim me premtime për punësim jashtë shtetit; me premtime për vazhdimin e shkollës jashtë shtetit; me premtime për të fituar shpejt para, në rrugë të ndryshme; për t’u bërë lypës; nga premtimet për të parë botën apo edhe me joshje, mashtrime apo në rrugë të tjera. Më të zakonshmeja ndër to, rezulton të jetë trafikimi përmes premtimeve për martesë.

Duhet theksuar se të dhënat mbi mënyrat e trafikimit, sikurse për çështje të tjera të lidhura me të, janë të ndryshme, shpesh edhe kontradiktore. Kjo lidhet me ‘kampionin’ e studimit, me faktin nëse pohimi bëhet ‘për vetë’ apo ‘për dikë tjetër’ (sikurse në sondazhin ‘kombëtar’ të shfrytëzuar për këtë punim), nëse ai bazohet në anketime apo në përvojën e treguar nga viktimat e asistuar në qendra të veçanta psiko-sociale, etj.

Premtimet për martesë, mënyra më e zakonshme e trafikimit

Në tabelën e mëposhtme (tab. 48), janë sistemuar disa të dhëna për format konkrete të trafikimit të realizuar në fakt, për 587 raste, sipas dëshmisë (pohimeve) të njerëzve që i njohin ata personalisht dhe që, në rastin e dhënë, janë të anketuarit e sondazhit ‘kombëtar’.

Tabela 48: Mënyrat e realizimit të trafikimit për rastet e shqyrtuara, sipas prefekturave

(Në përqindje)

Mënyrat e trafikimit ¹	Përgjigjet e marra, sipas prefekturave						Kampioni kombëtar
	Shkodër	Kukës	Elbasan	Vlorë	Gjirokastrë	Korçë	
1	61.2	43.5	56.3	45.0	46.8	49.5	50.3
2	13.8	37.0	11.1	8.8	8.1	2.2	15.6
3	3.8	7.2	4.0	7.5	24.2	16.5	9.3
4	6.2	0.7	1.7	2.5	3.2	7.7	3.3
5	3.8	10.1	5.5	12.5	3.2	7.7	7.4
6	0.0	0.0	4.0	3.7	1.6	2.2	1.9
7	1.2	0.7	5.5	8.7	6.5	4.4	4.2
8	10.0	0.8	11.9	11.3	6.4	9.9	8.0
<i>Gjithsej</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>

Siç shihet, në trafikimin e qenieve njëzore në Shqipëri, dominon mashtrimi. Rastet e rrëmbimit me me force nga dikush (tab. 48, mënyra 2), përbëjnë, për kampionin 'kombëtar', vetëm 15.6 për qind. Këto të dhëna përmbysin, gjithsesi, një perceptim të gabuar të trafikimit, të përhapur gjerësisht në Shqipëri. Në mungesë të studimeve empirike, në mungesë të informacionit të saktë apo të rëndimit të këtij problemi, kryesisht për sensacion nga mediat etj., trafikimi është parë njëanshmërisht. Ai është identifikuar me dhunën dhe, nga ky këndvështrim, duket sikur shkaku i parë dhe i fundit i tij kanë qenë rrëmbyesit, trafikantët, dhunuesit, deri vrasësit e femrave, të cilat gjithnjë janë vënë në rolin e viktimës. Dhuna, ana më e prekshme dhe, eventualisht, më e dënueshme e problemit, ka eklipsuar format e tjera të trafikimit dhe ndikimin (veç problemeve të lidhura me rendin publik) e faktorëve ekonomikë, socialë, politikë, juridikë, etiko-moralë etj., mbi trafikimin e grave dhe adoleshentëve. Përqindja më e madhe e 587 rasteve të trafikimit të shqyrtuara është realizuar me mashtrime, përmes premtimeve për martesë. Për kampionin 'kombëtar' të studimit tonë, kjo kategori të trafikuarish përbën më shumë se 1/2 e

⁷⁸ Mënyrat e hulumtuara të trafikimit ishin: 1. Me mashtrime, përmes premtimeve për martesë; 2. Rrëmbyer me force nga dikush; 3. U mashtrua me premtime për punësim jashtë shtetit; 4. U mashtrua me premtime për vazhdimin e shkollës jashtë shtetit; 5. U mashtrua me premtime për të fituar shpejë para, në rrugë të ndryshme; 6. U trafikuar për t'u bërë lypës; 7. U josh nga premtimet për të parë botën; 8. U trafikua me joshje, mashtrime apo në rrugë të tjera.

rasteve, ndërsa në prefektura të ndryshme varion nga 43.5 (Kuksi), në 61.2 për qind (Shkodra).


Fakti që trafikimi dominohet nga mashtrimi (në rreth 85 për qind të rasteve), sugjeron forma më të gjithanëshme të informimit, trainimit, edukimit apo të të mësuarit, sidomos me të rinjtë, nga institucionet e shoqërisë, duke filluar nga familja.

Edhe të anketuarëve të kampionit ‘rajonal’ u është kërkuar që të japin vlerësimin e tyre edhe për mënyrat e trafikimit Nisur nga konstatimi se njohja e mënyrave të trafikimit, sidomos e atyre të kamufluara, vlerësohet e rëndësishme si masë parandaluese, ato ishin përfshirë edhe në programet e trainimit të organizuara nga IOM-it.

Në rastin e kampionit ‘rajonal’ testimi i perceptimit të të anketuarëve, lidhur me mënyrat e trafikimit, është bërë përmes vlerësimeve për situata konkrete të supozuara. Sipas njërës nga këto situata, për shëmbull, një vajzë 19 vjeçare është mashëruar nga një djalë dhe, pas martesës zyrtare, ai e ka detyruar të bëhet prostitutë. Të anketuarëve u është kërkuar që të vlerësojnë nëse kjo vajzë është: a) e martuar; b) e mashtruar dhe e abuzuar; apo c) viktimë e trafikimit.

Më shumë se 1/3 e të anketuarëve (67.5 për qind), pohojnë se ky rast përfaqëson një viktimë të trafikimit. Ndërsa ¼ e tyre (25.1 për qind), pohojnë se kemi të bëjmë vetëm me mashtrim dhe abuzim. Në analizën sipas kategorive “të trainuar” e “të patrainuar” rezulton një diferencim lidhur me përgjigjen korrekte. Rreth 71 për qind e të anketuarëve “të trainuar” e vlerësojnë këtë rast si një viktimë të trafikimit, kundrejt 62.8 për qind e atyre “të patrainuar” (fig. 12).

Figura 12: *Trafikimit përmes premtimeve për martesë*



Sipas përkatësisë gjinore, del se vajzat përgjigjedhënëse janë më të prirura se djemtë për t'a vlerësuar këtë rast si një viktimë të mirëfilltë të trafikimit. Rreth 74 për qind e vajzave japin përgjigjen “një viktimë e trafikimit”, kundrejt 61 për qind e të anketuarve meshkuj.


Mashtrimi për punësim në emigracion

Edhe testimi për trafikimin përmes mashtrimeve me punësim jashtë shtetit, në rastin e kampionit ‘rajonal’, është bërë përmes vlerësimeve për situata konkrete. Një situatë e supozuar lidhet me një student, i cili mashtrohet nga dikush dhe, pasi shkon jashtë shtetit, detyrohet të punojë për llogari të trafikantëve, edhe pasi kishte shlyer shpenzimet e udhtëimit. Nxënësve dhe të rinjve, nga gjashtë vendet e rajonit, u është kërkuar opinioni nëse në këtë rast kemi të bëjmë me një viktimë të trafikimit ose jo.

Rreth 77 për qind e të anketuarëve përgjigjen se ky rast përfaqëson një ‘viktimë të trafikimit’. Vlerësimin e kundërt e japin vetëm 11.8 për qind. Ndërsa 11.4 për qind e të anketuarëve nuk arrijnë të dallojnë nëse ky rast përfaqëson ose jo viktimë të trafikimit.

Të dhënat sipas kategorive “të trainuar” e “të patrainuar” tregojnë se përgjigja korrekte jepet nga rreth 82 për qind e të anketuarëve “të trainuar”, kundrejt 72 për qind e të anketuarëve “të patrainuar” (fig. 13).

Figura 13: Trafikimi si punë e detyruar



Burimi: Anкета sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

Diferenca në vlerësimin e këtij rasti konstatohen edhe në analizën sipas gjinisë. Rreth 81 për qind e femrave pohojnë se ky rast përfaqëson

viktimë të trafikimit. Këtë pohim japin vetëm 72.5 për qind e meshkujve. Në vlerësimin e këtij rasti konstatohen diferencime edhe sipas shteteve. Në Kosovë dhe në Serbi-Mali i Zi ky rast vlerësohet si viktimë e trafikimit respektivisht në masën 83 për qind dhe 80 për qind. Ndërsa në Bosnje-Hercegovinë, Shqipëri dhe Maqedonia ky vlerësim jepet nga 75.2 për qind, 74 dhe 71.4 për qind. Por, a ndodh, sipas të anketuarve, që një emigrant ekonomik të bëhet viktimë e trafikimit? I tillë do të vlerësohej çdonjëri që është ‘punësuar’ diku, por që ‘punëdhënësi’ refuzon t’u paguajë (shih, “Përkufizimi i trafikimit”). Informacioni i marrë nga një pyetje e anketës ‘rajonale’ (pyetja 24c), lidhur me këtë çështje, është sistemuar në tabelën 49, gjithnjë sipas shteteve dhe nivelit të njohurive të 2400 nxënësve e të rinjve mbi trafikimin.

Tabela 49: *Opinione për mundësinë e shndërrimit në trafikim të punës në emigracion*

Pyetja 24c:	Shqipëria		Bosnje-Harzegovina		Maqedonia		Kosova		Serbia & Mali i Zi		Gjithsej
	Tr	Pa tr	Tr	Pa tr	Tr	Pa tr	Tr	Pa tr	Tr	Pa tr	
Ndodh shpesh	26.6	22.0	24.8	26.6	24.3	27.7	24.6	48.5	39.6	30.3	27.9
Ndodh	60.9	54.5	64.3	49.4	58.4	42.1	55.4	39.1	22.5	49.8	48.1
Nuk ndodh kurrë	0.9	5.0	2.5	3.2	6.7	8.3	4.6	8.7	2.4	3.7	5.4
Nuk e di	11.6	18.5	8.4	20.8	10.6	21.9	15.4	8.7	5.5	16.2	18.6
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Siç shihet, nxënësit dhe të rinjtë pohojnë, madje në një masë mjaft të madhe, se një emigranë mund të shfrytëzohet, në formën e mospagimit për punën që bën etj. Të rinjtë më të informuar (“të trainuarit”, ose “Activity Group”), janë më realistë në perceptimin e këtyre situatave. Por, siç është pohuar edhe në pjesë të tjera të këtij punimi, ky lloj shfrytëzimi perceptohet si trafikim në një masë relativisht të vogël, kundrejt shfrytëzimit seksual e formave të tjera të trafikimit.

Trafikimi me mashtrim për shkollim jashtë shtetit


Në një tjetër situatë hipotetike, një vajzë e talentuar dhe me dëshirën për t’u shkolluar jashtë shtetit, mashtrohet nga i dashuri i saj, i cili e detyron të prostitutojë. Nxënësve dhe të rinjve u kërkohet opinioni

nëse në këtë rast kemi të bëjmë me një viktimë të trafikimit, apo thjesht me një mashtrim.

Opinionet e të anketuarëve në vlerësimin e këtij rasti janë të shpërndara. Kjo dëshmon se kjo mënyrë trafikimi është më e kamufluar. Megjithatë 58.3 për qind e të anketuarëve pohojnë se edhe ky rast përfaqëson trafikim, ndërsa 31.8 për qind pohojnë se ky rast është “mashtrim, por jo trafikim”.

Në analizën sipas kategorive “të trainuar” dhe “të patrainuar”, del se të anketuarit e grupit “të trainuar” japin përgjigjen korrekte në masën 10 për qind më shumë se ata “të patrainuar” (shih, fig. 14).

Figura 14: *Trafikimi si mashtrim për shkollim jashtë shtetit*



Burimi: Anкета sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

Diferencime vërehen edhe në përgjigjen sipas gjinisë. Vajzat janë më të prirura për ta vlerësuar këtë situatë si rast trafikimi, në masën 10 për qind më shumë se sa djemtë (63.3 për qind me 53 për qind). Nga analiza sipas shteteve rezultojnë, gjithashtu, diferencime në vlerësimin e saktë të kësaj situatë që shkojnë deri në 13 për qind. Renditja e përqindjeve për përgjigjen e saktë është: Shqipëria 64.9 për qind, Maqedonia 62 për qind, Bosnje-Hercegovina 60.3 për qind, Kosova 55.8 për qind dhe Serbi-Mali i Zi 51.5 për qind.

Por ky lloj mashtrimi është i lidhur me perceptimin që kanë të rinjtë e Shqipërisë e të vendeve të rajonit për mundësitë e mëdha që ofrojnë vendet perëndimore për shkollim. Testimi i këtij perceptimi është bërë përmes pyetjes (anketa ‘rajonale’, 24a): “Sipas jush, sa e zakonshme është për emigrantët që të marrin

Pjesa VI: Rreth shkaqeve dhe disa pasojave të trafikimit

‘Kurthi’ i varfërisë


Ky trajtim lidhet me vetë burimin e së keqes, me shkaqet e trafikimit dhe nxitet nga ballafaqimi i të dhënave të studimit tonë, me përfundime studimesh apo me pohime të mëparshme të studiuesve socialë, analistëve etj. Në perceptimin e shumicës së individëve të përfshirë, si përgjigjedhënës në studimin tonë, varfëria (e marrë në kuptimin material të fjalës), konsiderohet pothuajse si shkak i vetëm i trafikimit. Ne, përkundrazi, na rezultojnë dy-tre momente që meritojnë vëmendje, lidhur me këtë perceptim.

Së pari, roli i varfërisë mbi trafikimin, sikurse mbi dukuri të tjera, ‘të reja’ sociale, nuk duhet mbivlerësuar. Ajo është një shkak, por jo i vetmi. Pandaj, kur flasim për varfërinë dhe rolin e saj mbi trafikimin, sidomos të femrave dhe adoleshentëve, na duket i drejtë të përdorim jo vetëm termin “shkak”, por edhe termin “kurth”. Varfëria, në rastin e trafikimit, është më shumë një kurth se një arsye logjike që e nxit atë. Pse? Për t’i dhënë përgjigje kësaj pyetje le t’i referohemi një studimi të realizuar për një komunitet të dhënë etnik, siç është komuniteti rom⁷⁹. Por përgjithësimi është i vlefshëm edhe për komunitetet e tjera etnike. Sepse trafikimi i qenieve njerëzore, sikurse trafikimi i drogës etj., konsiderohen si një ‘mekanizëm’ për zbutjen e varfërisë, madje në një masë të konsiderueshme familjesh në Shqipëri. Por trafikimi për prostitucion, për shëmbull, si forma më e zakonshme e trafikimit, ofron pak ose aspak mundësi për të nxjerrë një familje

⁷⁹ Shih, për shëmbull, Gëdeshi et al. 2004. *Romët dhe evgjitet në Shqipëri*. Tiranë: Banka Botërore, fq. 76-85 dhe “Aneks, fq. 63.

nga varfëria. Në shumicën e rasteve ato e përkeqësojnë gjendjen financiare të familjes.

Ja cikli më i zakonshëm (skema): Një femër trafikohet për prostitucion. Por të ardhurat kontrollohen nga tutorët. Pak ose aspak para dërgohen në shtëpi. Nga ana tjetër, ato lenë në mjaft raste edhe fëmijë me prindërit e tyre. Varfëria e familjes rritet, zakonisht, edhe në rastet kur ato kthehen në shtëpi. Kjo sepse, veç të tjerave, ndikon në rritjen e tensioneve në familje dhe në komunitet. Këto tensione kanë, gjithsesi, një kosto (edhe financiare) përballimi. Pra kemi të bëjmë me një spirale, në rënie, të nivelit të varfërisë, të ndikuar nga trafikimi, siç është paraqitur skemë.



Pra, trafikimi e të ardhurat e marra prej tij, nuk e zgjidhin problemin e varfërisë⁸⁰. Meqënëse jemi te komuniteti rom, le të sjellim disa fakte të tjera të lidhura me trafikimin, fakte që gjithsesi kanë njëfarë domethënie për të gjithë shqiptarët. Studimet tragojnë se *në familjet rome prostitucioni më shumë tolerohet se refuzohet*. Siç shprehet një grua rome nga Pojani (Korçë), banorët flasin, por nuk duan t'ia dinë nëse vajza e trafikuar për prostitucion 'sjell diçka për të ngrënë'. Madje ndër format e trafikimit të fëmijëve, në një kategori romësh, është edhe 'dhënia me qera', një nga mënyrat e trafikimit, çuditërisht, me një nivel mjaft të lartë pranueshmërie. Me këtë lidhet edhe fakti se, ndryshe nga ç'ndodh me shumicën shqiptare, në komunitetin rom, në mbi 82 për qind të rasteve prostitutat vajza apo gra të rikthyera nga trafikimi pranohen në familjet e tyre dhe vetëm 16 për qind e tyre refuzohen. Në Fushë Krujë, për shëmbull, 94 për qind e të anketuarve pohojnë se të paktën një person i trafikuar është kthyer në familjet e tyre (Gëdeshi et al, 2004: 79).

Sidoqoftë, në vlerësimin e varfërisë dhe rolit të saj mbi fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore, është mirë që t'i referohemi 'varfërisë sociale', pra si 'kapital social'⁸¹. Studimet tregojnë se ai ka pësuar rënie ndër shqiptarët, në këtë periudhë të tranzicionit postkomunist.

Debat rreth çështjes "Pse trafikohen shqiptarët"

Por, pse trafikohen shqiptarët? Derisa nuk na rezulton një përgjigje e vetme dhe e pakontestuar, atëherë jami të detyruar të debatojmë rreth kësaj çështje. I referohemi, si pikënisje, një studimi mbi trafikimin të realizuar nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (CRCA, 2003: 10-11), në të cilin trafikimi lidhet para së gjithash, me varfërinë, mungesën e vendeve të punës, rrënimin e

⁸⁰ Shih, për më tepër, edhe Gëdeshi, Ilir, "Roli i remitancave të emigracionit shqiptar dhe ndikimi i tyre në ekonominë e vendit", *Politika & Shoqëria* (2000), 3, 2(7): 55-68, ose De Soto, Hermine, Peter Gordon, Ilir Gëdeshi & Zamira Sinoimeri, "Vlerësimi cilësor i varfërisë në Shqipëri", *Politika & Shoqëria* (2002), 5, 1(10): 21-38.

⁸¹ Shih, për shëmbull, Gëdeshi, Ilir. "Roli i kapitalit social si faktor i zhvillimit lokal në Shqipëri" (Bilanci i OJQ-ve të Shkodrës), *Arcadia* (2005), 6-12.

ekonomisë publike etj., gjatë viteve të tranzicionit, sektorin ende të pazhvilluar privat etj. Për të argumentuar gjendjen e vështirë ekonomike citohen burime zyrtare (INSTAT) ose të OJQ-ve ndërkombëtare, siç është UNICEF, për shëmbull, sipas të cilave:

“Në Shqipëri 29.6 për qind e popullsisë jeton në varfëri dhe gjysma e kësaj përqindjeje në kushtet e varfërisë ekstreme. Mbi 46 për qind e shqiptarëve jetojnë nën nivelin e minimumit jetik...”

Sikurse në studimet e mëparshme, edhe nga të dhënat e studimit tonë konfirmohet fakti se varfëria është një ndër shkaqet kryesore të lulëzimit të trafikimit në Shqipëri. Por, në ndryshim nga ato, nuk na rezulton se varfëria, qoftë edhe ajo ekstreme, të jetë një shkak i vetëm, madje në njëfarë mënyre mund të themi se ajo nuk është as edhe shkak dominues i trafikimit.

Ky përfundim na duket i rëndësishëm edhe në një rrafsh praktik. Nëse faktori ekonomik (varfëria) vlerësohet si ‘i vetmi shkak që ushqen trafikimin’, kjo do të çonte në përfundimin se shqiptarët duhet të ‘lidhin duart’ dhe të presin (ndoshta për shumë kohë) rritjen ekonomike e të nivelit të jetesës. Këto përfundime nuk marrin në konsideratë problematikën komplekse të shoqërisë së sotme shqiptare, e jo vetëm shqiptare, me të cilën shpjegohet edhe trafikimi i grave dhe adoleshentëve. Nga administrimi dhe interpretimi i të dhënave, rezulton se trafikimi lidhet jo vetëm me shndërrimet ekonomike e politike, por edhe me shndërrimet sociale, demografike, psikologjike, të mentalitetit, sikurse me shndërrimet morale, me jetën tradicionale dhe format e shfaqies së saj, me ligjet (cilësinë dhe shkallën e zbatimit të tyre), me mbeturinat e së drejtës zakonore (dora e zgjatur e kanunit në demokraci), me rendin publik, drejtësinë, me grupet sociale, familjen etj., etj., deri me të mësuarit (dijet, njohja, informimi), siç kemi trajtuar në këtë punim.

Në vijim të kësaj analize, le të shohim, referuar burimeve paralele (zyrtare apo atyre të siguruara nëpërmjet anketimit dhe intervistave), zonat më problematike të trafikimit të grave dhe adoleshentëve shqiptarë. Pra, le të hulumtojmë se nga vinë individët e trafikuar.

Tabela 51: Nga vinin viktimat e asistuar të trafikimit?

Nr. renditës	Qytetet	Vajza të trafikuar	
		Në numër	Në përqindje
1	Tirana	55	22.5
2	Vlora	53	21.5
3	Durrësi	23	9.4
4	Lushnja	23	9.4
5	Berati	14	5.7
6	Saranda	14	5.7
7	Fieri	12	4.9
8	Elbasani	12	4.9
9	Shkodra	10	4.1
10	Korça	9	3.6
11	Laçi	7	2.9
12	Gramshi	7	2.9
13	Peshkopia	6	2.3
1-13	Gjithsej	245	100.0

Të dhënat e mësipërme u referohen vajzave të trafikuar të riatdhesuara dhe që janë trajtuar në qendrat e riaftësisimit. Nga këto të dhëna, del se 87 nga 245 vajza të trafikuar por të rikthyera në Shqipëri (pra 35.5 për qind), janë adoleshente të grupmoshës 13-18 vjeç. Por përgjithësisht edhe pjesa tjetër është trafikuar për herë të parë kur ka qenë brenda kësaj grupmoshe dhe kanë përsëritur ciklin e trafikimit disa herë (CRCA, 2003; Vatra, 2002).

Siç shihet në tabelë, të parat në rënditje për nga trafikimi i vajzave janë Tirana, Vlora dhe Durrësi, praktikisht qytetet me nivelin më të lartë të jetesës, megjithë përbërjen shumë heterogjene të tyre. Edhe të dhënat mbi trafikimin e fëmijëve dëshmojnë se gjatë një periudhe mbi dhjetëvjeçare disa zona janë kthyer në qendra të trafikimit të tyre (CRCA, 2003: 13). Përmenden sidomos Berati, Fieri, Shijaku, Vlora etj., gjithsesi, jo zonat më të varfëra të Shqipërisë. Sipas të dhënave zyrtare mbi femrat e zhdukura, gjatë këtyre viteve (bazuar në denoncimet e familjarëve të tyre), 360 nga 600 (pra 3/5 e tyre) janë nga Tirana, Durrësi, Elbasani dhe Shkodra⁸².

Këto përfundime 'konfirmohen', përgjithësisht, edhe nga të dhënat

⁸² Hoxha, Edmond. 2005. Mbi femrat e zhdukura në Shqipëri. Gazeta *Metropol*, 21 korrik.

sasiore e cilësore të sondazhit tone ‘kombëtar’. Le t’u referohemi, për shëmbull, përgjigjeve të pyetjes 12 të anketës ‘kombëtare’, e cila na jep një informacion për individët që kanë përjetuar ngjarje personale të lidhura me trafikimin. Nga ky informacion del se në disa qyte, si Kuksi, apo në disa qyteza, si Krumë (Has), Koplík (Malësi e Madhe), Himarë (Vlorë), Tepelenë etj., sikurse në mjaft fshatra të largët që janë përfshirë në studimin tonë, si Bushëricë, Shëmri e Zapod (Kukës), Voskop e Drenovë (Korçë), Picar (Gjirokastrë) etj., thuhet nuk ka përgjigjedhënës që të kenë pohuar se janë ndjerë, qoftë edhe një herë të vetme, të rrezikuar për të qenë të trafikuar, në ndonjërin nga mënyrat e përdorura për trafikim.

Ne nuk pretendojnë kurrësesi që këto pohime të përfaqësojnë ‘të vërteta absolute’. Por mendojmë se ato, gjithsesi, janë për t’u vlerësuar. Prej tyre rezulton pesha e faktorëve të tjerë, të cilët meritojnë vëmendje. Ne mund të veçojmë dy prej tyre: njëfarë rënie morale të shqiptarëve dhe njëfarë rënie të krenarisë (*lack of the pride*) tradicionale të tyre.

Rënia morale dhe e krenarisë, si faktorë ndikues mbi trafikimin

Burimet bibliografike, sikurse të dhënat sasiore dhe dëshmitë e individëve të intervistuar gjatë këtij sondazhi, tregojnë se në 15 vjetët e fundit *ka ndryshuar sidomos qëndrimi i shqiptarëve ndaj parasë*. “Jemi bërë një shoqëri materialiste, jetojmë vetëm për para”, thotë një e intervistuar nga Elbasani. Kjo gjendje nuk përkon, gjithsesi, me traditën shqiptare. Ja si shkruan një akademik francez, kohë më parë⁸³:

“Për historianin, etnografin ose sociologun Shqipëria është një vend i banuar nga njëri prej popujve më të vjetër të Evropës, i cili për mrekulli ka ruajtur gjuhën dhe doket e tij, të cilat janë të njëkohshme me lashtësinë greke... Unë mund të them vetëm fjalët më të mira dhe ta lavdoj këtë popull të shquar. Tek ai gjeta cilësitë më të rralla në Ballkan, *mospërfilljen për paranë, respektin për nderin* (nënvizimi ynë), e për mbajtjen e fjalës së dhënë. Dhe këto të shqiptarët bashkohen me guximin, trimërinë, veprimtarinë

⁸³ Burkari, Zhak. 2004. *Shqipëria dhe shqiptarët*, Tiranë: Dituria.

dhe shpirtin e gjallë e të hedhur... Shqiptarët i përkasin një race ndër më të bukurat në Evropë dhe virtytet e tyre morale, ndër më të rrallat në Lindje, janë të denja për bukurinë e tyre fizike...”

Jo rastësish në citimin e mësipërm kemi nënvizuar “mospërfillja ndaj parase”, dhe “respekti për nderin”, si vlera morale të shqiptarëve. Nën regjimin komunistë u vendos një “shpërndarje e barabartë e varfërisë”, por varfëria përfaqësonte një realitet ‘të pranuar’, ndaj së cilës thujse nuk reagohej. Gjithsesi mospërfillja ndaj parase “mbeti në fuqi” deri në vitet ‘90-të. Më pas shumçtka (thujse gjithçka), u përmbys. Shqiptarët, në mënyrë spontane dhe kaotike, u vunë në kërkim të asaj që u ishte mohuar. Kjo ishte, në perceptimin e tyre, pasuria. Trafikimi i grave dhe adoleshentëve u vlerësua, kështu, si një ndër rrugët e pasurimit të shpejtë.

Të dhënat e tablës 52 pasqyrojnë një anketim kombëtar, të mesit të periudhës 15 vjeçare. Ato shprehin ‘ëndërrën’ shqiptare për t’u pasuruar shpejt e thujse ‘me çdo çmim..

Tabela 52: *Cila është dëshira apo ëndrra juaj më e madhe?*⁸⁴

Nr.	Përgjigjet e dhëna	Në numër	Në përqindje
1	E ardhmja e fëmijëve të mi	277	18.4
2	Luksi, mirëqenia	162	10.7
3	Emigrimi	124	8.2
4	Të udhëtoj jashtë Shqipërisë	111	7.4
13	Të kem një jetë normale	53	3.5
24	Miqësia	11	0.7
1-24	<i>Gjithsej</i>	<i>1509</i>	<i>100.0</i>

Luksi (mirëqenia), emigrimi dhe ëndrra për të parë botën (të gjitha të lidhura me trafikimin), janë në vendet 2-4, në renditjen me 24 shkallë. Ato vijnë vetëm pas synimit për të siguruar të ardhmen e fëmijëve (familja vazhdon të konsiderohet vlerë kryesore). Ato janë shumë shkallë më lart, krahasuar me pohimin “të kemi një jetë normale” (e 13-ta në renditje). Pra, nëse e ‘lexojmë’ me njëfarë realizmi mesazhin e këtij sondazhi, del se shqiptarët e sotëm parapëlqejnë më

⁸⁴ Burimi: ORE. 1999. *Udha e Shqipërisë drejtë demokracisë. Një Vend magjepsës në tranzicion*. Tiranë, fq. 61

shumë aventurën se normalitetin Ndërsa miqësia, një vlerë tradicionale e shqiptarëve⁸⁵, zë vendin e fundit e vlerësuar si e rëndësishme vetëm nga 0.7 për qind e të anketuarve.

Edhe Kadareja, në veprën e vet *Kohë barbare* (2000b: 134-137), pohon se kjo rënie morale ka karakterizuar, pak a shumë, të gjitha vendet e Lindjes, në të cilat u shfaq njëlloj ‘materializmi vulgar’. Ndaj morali u zvetënua, disa njerëz filluan të pohojnë se duhej të bëhej apologjia e parasë, sikur të bëhej fjalë për një çështje “nderi”. Ai thekson se, sidomos në dy-tre vitet e para, pas rënies së komunizmit,

Në shtyp u shfaqën deklarata të tipit: “E adhuroj paranë”, “Paratë janë gjithçka”... Iu kushtuam sërish kultit të njeriut të pasur. Morali u sulmua nga gjëra të llahtarshme. Dëshira për para mbyti çdo dëshirë tjetër...

E lidhur me këtë dukuri, na duket edhe rënia e krenarisë tradicionale. Akademiku francez, i cituar më sipër, shprehej se shqiptari (fshatar, malësor apo ushtar), “me të cilin unë jetova e hëngra bukë e në shtëpinë e të cilit banova, dukej si një zotëri i madh, po ta krahasojmë me fqinjët e tij ballkanikë...”

Pse shqipëarët/et janë sot kaq “të gatshëm” për t’u përfshirë në trafikë, kur Shqipëria nuk është bërë më e varfër se ç’ka qenë? Duket se ka shkaqe që, ndoshta, më shumë se me varfërinë, lidhen me njëfarë *lack of pride* (humbje të krenarisë), pra me rënie e nivelit të vlerësimit për vetveten, me mungesën e një qëllimi kolektiv, të një ënëdrre të përbashkët (kombëtare), tek e cila të gjithë mund të besonin.

Çfarë kanë humbur shqipëarët, çfarë e bën trafikimin kaq problematik? Duket se të rinjtë nuk besojnë, ndoshta, në asgjë. Mungon një frymëzim pozitiv, një ‘hero pozitiv’, një model pozitiv, një nxitje për të çliruar energji rinore pozitive, ndërkohë që më të moshuarit, shpesh të çoroditur, kërcëlljnë dhëmbët ndaj një gjendjeje thujse të pashpresë. Nuk ka si të shpjegohet ndryshe

⁸⁵ Shqipëartë kanë pasur një shprehje popullore tradicionale lidhur me raportin miqësi-para, sipas së cilës është “më mirë një mik se një çiflik”

fakti që prindër, bij e bija shqiptarë, e shohin shpesh paranë si të vetmin qëllim të jetës dhe, pasi kanë arritur në këtë shkallë, nuk e kanë për gjë të pranojnë përfshirjen (shpesh ‘së bashku’), në ingranazhet e drogës, deri përcjelljen e bijëve e bijave për në botën e prostitucionit etj.

Ndoshta asnjë program zhvillimi, trainimi apo formimi nuk mund ta zhdukë trafikun e drogës, sikurse atë të grave e vajzave shqiptare, më shumë se një program i rilindjes morale, i rivlerësimit të vetvetes, i humanizimit të botës shqiptare. Nëse shqipartë do të vazhdojnë të jenë “të droguar pas parasë”, nëse nuk do të kenë ku të besojnë tjetër veç saj, nuk do të kenë vlera më të mëdha për të mbrojtur apo afirmuar, nuk do të kenë më krenari për të konservuar etj., ata nuk do të reshtin së shfrytëzuar drogën apo së ushtruar e së shfrytëzuar prostitucionin, trafikimin e grave e vajzave të tyre.

Pra, kush jemi, çfarë mund të bëmjë e çfarë mund të bëhemi, ç’na ka karakterizuar, nga pikëpamja e vlerave, çfarë vlerash kolektive mund bartim e të përçojmë në këtë botë të karakterizuar edhe nga trafikimi? Rreth këtyre çështjeve themi se duhet debatuar.

“Nota” e vlerësimit të faktorëve që ndikojnë në trafikim

Por trafikimi ndikohet nga shumë faktorë. Në tabelën 53 janë renditur përgjigjet e pyetjes 26 të anketës ‘kombëtare’, përmes së cilës ne kërkuam të informohemi lidhur me faktorët që, në perceptimin e të anketuarve, kanë ndikimin negativ më të madh, në procesin e trafikimit të grave dhe të adoleshentëve. Për çdonjërin nga faktorët përgjigjedhënesit kanë vendosur në “notë”, nga 1 në 10. Duke filluar me ndikimin negativ më të madh të mundshëm, (“nota” 1), deri në ndikimin më të vogël të mundshëm (ndikim të papërfillshëm, “nota” 10). Renditja në tabelë (I-XIII), e faktorëve që ndikojnë në trafikimin e grave dhe të adoleshentëve është bërë sipas ‘peshës specifike’ që ata kanë në trafikim, gjithnjë sipas perceptimit të përgjigjedhënesve. Për efekt analize, në tabelë janë pasqyruar vetëm vlerësimet me “notat” 1-3, pra ata me ndikimin më të madh negativ.

Tabela 53: Faktortë që ndikojnë më negativisht mbi trafikimin
(Në përqindje)

Renditja	Faktori ndikues	Vlerësimet
I	Papunësia	71.4
II	Varfëria	71.1
III	Mungesa e stabilitetit politik	62.5
IV	Degradimi moral i meshkujve trafikantë	57.7
V	Dëshira e papërmbytur për para, te djemtë	55.3
VI	Mungesa e shpresës	49.0
VII	Dobësimi i familjes	46.4
VIII	Degradimi moral i femrave që trafikohen	42.5
IX	Statusi i ultë i femrës në shoqërinë shqiptare	40.2
X	Dhuna mashkullore ndaj grave	38.2
XI	Dëshira e papërmbytur për para, te vajzat	34.8
XII	Synimi për t'u marëuar me çdo kusht	25.5
XIII	Ndikimi i shtetasve të huaj	22.7

Burimi: Anкета sociologjike me individë të gjashtë qarqeve të Shqipërisë, 2005

Nga analiza, në bllok, e rezultateve të mësipërme del se *papunësia* dhe *varfëria* përceptohen si faktorët me ndikimin negativ më të madh në trafikimin e grave dhe të adoleshentëve. Mbi 70 për qind e opiniondhënësve japin pikërisht për këta faktorë një ndër tre vlerësimet që cilësojnë ndikimin negativ më të madh. Por ato, siç thamë më sipër, më shumë krijojnë terrenin apo klimën e përgjithëshme (të nivelit makro), të përshtatëshme për trafikimin e grave dhe adoleshentëve, por nuk mund të thuhet se kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në të, derisa trafikimi nuk është një veprimtari punësimi. Nga ana tjetër, siç analizuam më sipër, përmes trafikimit nuk rritet mirëqenia e të varfërve. Në rastin më të mirë ai vetëm shton pasurinë e 'klasës së trafikantëve', gjithsesi të një numri mjaft të kufizuar individësh.

Mungesa e stabilitetit politik vlerësohet e treta midis faktorëve me ndikimet negative më të mëdha në trafikim. Kjo është një rrethanë specifike, për një vend si Shqipëria, në një tranzicion të zgjatur e mjaft problematik, në të cilin krizat politike (sidomos ajo e vitit 1997), kanë ndikuar në të gjithë jetën ekonomike e sociale, duke përfshirë edhe trafikimin.

Degradimi moral i meshkujve trafikantë (57.7 për qind), dhe

degradimi moral i femrave që përshihen në trafik (42.5 për qind); *etja (dëshira e papërmbajtur) për para, sidomos te djemtë* (55.3 për qind) *por edhe te vajzat* (34.8 për qind), mund të përmbidhen në grupin e faktorëve më shumë të karakterit moralë, gjithësesi, me ndikim të konsiderueshëm në trafikimin e grave dhe të adoleshentëve. Të lidhura me to është edhe faktori *pasiguri për të ardhmen ose mungesa e shpresës* (49 për qind).

Një bllok problemesh me ndikim mbi trafikimin e grave dhe adoleshentëve janë ato që lidhen me fushën e familjes (*dobësimi i familjes*, 46.4 për qind), e të *martesës* (siç është “synimi për t’u martuar me çdo kusht” me 25.5 për qind) dhe problematikat gjinore (*statusi i ultë i femrës* në shoqërinë shqiptare, me 40. 2 për qind; *dhuna mashkullore* ndaj grave, me 38, 2 për qind) etj.

Sa më sipër, rezulton se shqiptarët e perceptojnë trafikimin e femrave dhe të adoleshentëve si një problem kryesisht të brendshëm të shoqërisë shqiptare, të ndikuar nga veprimtaria e shtetasve të tyre. Por ata vlerësojnë, gjithashtu (me 22.7 për qind), edhe *ndikimin negativ të shtetasve të huaj*.

Trafikimi dhe shndërrimet në fushën e familjes dhe martesës

Megjithë shndërrimet që ka pësuar në epokën postkomuniste, familja mbetet institucioni më stabil i shoqërisë shqiptare (UNDP, 1999). Sidoqoftë, zhvillimet e këtyre viteve, sidomos lëvizja e pakontrolluar migratore, e ka tronditur familjen tradicionale, ndoshta më shumë se evolucioni shekullor, më shumë se shndërrimet e imponuara nga shteti e ligji, nga fetë, politikat shtetërore (nga pushtuesit, te komunizmi), më shumë se kushdo.

Pra, duket se familja e sotme shqiptare e ka humbur ‘qetësinë olimpikë’⁸⁶. Ajo rrezikohet edhe nga faktorë jotradicionalë, siç është, ndër të tjera, edhe trafikimi i grave dhe i adoleshentëve.

Në veçanti, konstatohet zvoglimi i përmasave të familjes, proces i filluar që para vitit 1990. Në fillim të viteve ’80-të në fshat, për

⁸⁶ Mund të shihet, gjithashtu, edhe: Beqja, Hamit & Sokoli, Lekë. 2003. *Divorci, vrojtime e refleksione*. Tiranë: Dudaj & Rinia.

shëmbull, familjet kishin mesatarisht nga 6.2 pjesëtarë. Në vitin 1989 ky numër kishte rënë në 5.3 (UNDP, 1999: 12-13). Por pas vitit 1990 ky proces u thellua. Sot familjet e mëdha mund të gjenden vetëm në zonat e thella rurale, ndërsa familjet e qytetit janë më shumë familje nukleare (bërthamë), mesatarisht me një apo dy fëmijë.

Referuar përgjigjeve të pyetjeve 7 dhe 8 të anketës 'kombëtare' (shih), lidhur me raportet familje tradicionale (me shumë kurora), bërthamë (nukleare, me një kurorë) dhe atyre me një prind, krijuam tabelën 54:

Tabela 54: *Familjet sipas numrit të kurorëve, 1990-2005*
(Në përqindje)

Lloji i familjes	Para vitit 1990	Qershor 2005
Me shumë kurora	28.0	20.5
Me një kurorë	69.2	72.5
Me një prind	2.7	7.0
Gjithsej	100.0	100.0

Edhe për rrethet që po marrim në shqyrtim (Kuksi, Shkodra, Elbasani, Vlora, Korça dhe Gjirokastra), prirja është e qartë: *kalimi drejt familjeve nukleare, me një kurorë dhe shtimin e familjeve me një prind*. Por, siç e kemi theksuar, ne i shqyrtuam këto probleme në rrethet e zona jotipike për nga efekti i migrimit të brendshëm, pra nga zona më shumë "përcjellëse", se "pritëse". Në këto të fundit, siç është pellgu Tiranë-Durrës, prirja normalisht duhet të jetë edhe më e theksuar.

Familjet më të "kërcënuara" nga trafikimi i femrave dhe adoleshentëve janë pikërisht familjet nukleare. Në një studim mbi trafikimin, të vitit 2004 (Leskaj ad al., 2004: 31-32), thuhet:

"konfirmohet tronditja e lidhjeve familjare, dobësimi i tyre, si karakteristikë e familjes së sotme shqiptare. Procesi i kalimit nga një familje e gjerë në familje nukleare ndikon që lidhjet midis anëtarëve të saj të jenë të brishta dhe të humbasin pikat e takimit. Familja nukleare nuk është e përgatitur të përballojë problemet e mëdha, i mungojnë nuancat e familjes patriarkale me rregulla të forta dhe norma të caktuara, ku të gjithë janë të bashkuar për një qëllim: të mbrojnë dhe mbështesin familjen. Ajo (familja nukleare), është e thyeshme dhe e ndjeshme ndaj fenomeneve e problemeve të mëdha sociale... Në pjesën

më të madhe të intervistave që janë bërë me gratë e trafikuar, del se pjesë e trafikimit të tyre kanë qenë vetë prindërit ose të afërm të tjerë të familjes...”

Të dhënat e studimit tonë konfirmojnë, përgjithësisht, këtë konstatim. Referuar përgjigjeve të pyetjes 22 (anketa ‘kombëtare’ shih), sikurse pyetjeve të tjera dhe intervistave të marra, del se thuajse të gjithë të trafikuarit vijnë nga familje nukleare. Më të rezikuara janë ato me një prind ose pa prindër, që zenë rreth 1/3 e të trafikuarve, pra shumë më tepër nga pesha specifike që kanë këto familje, në raport me numrin e përgjithëshëm të familjeve. Meriton vëmendje fakti që në rreth 80 për qind të rasteve të familjeve me një prind, prindi kryefamiljar është gruaja. Këto janë familjet më të pambrojtura, objekt kryesor i “gjuetisë” së trafikantëve. Nga intervistat e realizuara, sidomos në fshara të thellë malorë të rretheve Kukës (sidomos), Shkodër, Korçë apo edhe Vlorë, del se në zonat me familje ende të mëdha e me shumë kurorë, ku ende kanë ndikim normat e moralit tradicional, femrat dhe adoleshentët ndjehen “pak” ose “aspak” të rrezikuar për t’u trafikuar. Ja ç’pohon një vajzë, Kukës 2005:

“Sidomos në Veri apo në qytetet e vogla nuk mund të thuhet shumë për trafikimin. Njerëzit njihen, ndikimi i Kanunit⁸⁷ dhe fisit është ende i fortë. Prandaj rrallë i shkon mendja ndokujt për të trafikuar ndonjë”.

Ndërsa një drejtuese e një OJQ-je, thekson:

“mendoj se këtej nga ne s’ka probleme të trafikimit pasi traditat, Kanuni dhe morali janë ende shumë të forta dhe nuk mund të vihen në diskutim nga ndonjë mashkull ose femër e kësaj krahine”

Një drejtues policie, Krumë:

⁸⁷ Për këtë dukuri Ismail Kadare, shkruan: “Të revoltuar kundër trafikantëve të drogës e kundër atyre që shpesh rrëmbejnë motrat e tyre për t’i çuar si prostitutat në Evropë, djemtë shqiptarë, duke mos gjetur mjet tjetër për shfarosjen e kësaj murtaje, kthehen vetë, për fat të keq, në ekzekutorë të kriminelëve (Kadare, 2000: 5).

“Unë vetë punoj në komisariatin e Policisë. Këtu nuk ka asnjë denoncim apo padi për trafikim të grave. Për këtë qetësi duhet falënderuar çdo banor i Krumës dhe fshatrave të Hasit për respektin për jetën, punën, familjen dhe shoqërinë”.

Problemet e trafikimit lidhen edhe me problemet e martesës e të krijimit të familjes. Shqiptarët vazhdojnë të shquhen për nga dëshira për t’u martuar. Në përpjekjen për të hulumtuar nëse ndikon mbi trafikimin e vajzave synimi ‘për t’u martuar me çdo kusht’ renditëm faktorët që ndikojnë më negativisht në procesin e trafikimit (pyetja 26, anketa ‘kombëtare’). Më shumë se ¼ e të anketuarve, pohojnë ndikimin e këtij synimi mbi trafikimin.

Por shqetësimin, pak a shumë masiv, që vërtetohet për martesë, sidomos të vajzat e zonave rurale, e shpreh edhe pohimi i një të intervistuar nga fshati Zapod:

“Në fshat është vështirë të jetohet, pasi nuk ke mundësi të shkollohesh e të punësohesh. Vetëm në shtëpi.... Të rinjtë kanë ikur jashtë, ndaj nuk mund as të martohesh”

Trafikimi dhe problematikat gjinore

Nga tabelën ku janë renditur faktorët që ndikojnë më negativisht mbi trafikimin (tab. 50), shihet se dy ndër këta faktorë kanë të bëjnë me problematikat gjinore, siç janë statusi i ulët i femrës në shoqërinë shqiptare (IX, 40.2 për qind) dhe, në mënyrë më specifike, dhuna mashkullore ndaj grave (vendi X, 38.2 për qind).

Në perceptimin e grave mbi dhunën evidencohet një fakt: *Nga të gjitha format e dhunës të ushëruara ndaj grave dhe adolshentëve, prostitucioni i detyruar cilësohet si forma më e rëndë e dhunës ndaj tyre*⁸⁸. Por dhuna mashkullore është një fenomen i përhapur thuajse kudo në Shqipëri. Në qytetin e Shkodrës, për shëmbull, gratë që pohojnë se kanë pësuar dhunë përbëjnë mbi ½ e grave të anketuara (50.9 për

⁸⁸ Burimi: Qendra e Gruas Shkodër (QGSH). 2002. *Mbi kushtet e jetesës së grave në qytetin e Shkodrës*. Shkodër: Volaj, fq. 38-39.

qind). Për t'u vlerësuar është fakti se më shumë se gjysma e grave që pohojnë se janë të dhunuara (55.6 për qind), kanë dëshirë të emigrojnë jashtë Shqipërisë. Nga krahasimi i përgjigjeve të 'grave të dhunuara', kundrejt grave që nuk konfirmojnë se ndaj tyre është ushtruar dhunë, del ky përfundim, apo prirje sociologjike e lidhur me trafikimin: *sa më të dhunuara të jenë gratë, aq më të prirura janë ato për të emigruar, rrjedhimisht aq më të predispozuar janë për t'u mashtruar nga trafikantët*, pra për t'u bërë viktime të trafikimit, për prostitucion apo forma të tjera.

Por kush janë dhunuesit e grave dhe të adoleshentëve? Për këtë do t'u referohemi dy burimeve të ndryshme (tab. 55).

Tabela 55: *Dhunuesit e grave dhe të adoleshentëve*⁸⁹

(në përqindje)

Dhunë nga persona jo të familjes	Dhunë nga persona të familjes			
	<i>Kush ushëron dhunë e ndaj kujt</i>	Gjithsej	<i>Vajzat dhe gratë e anketuara</i> Nga qyteti	Nga fshati
58.0 për qind	Babai ndaj nënës	19.3	15.0	30.2
	Babai ndaj vajzave	2.2	1.9	2.4
	Babai ndaj djemve	7.7	8.3	6.6
	Nëna ndaj vajzave	9.2	9.9	6.6
	Nëna ndaj djemve	2.3	2.6	1.4
	Vëllai ndaj motrës	5.4	5.4	4.6
	Nëna ndaj babait	0.9	1.0	0.8
	<i>Nuk ushtron dhunë</i>	<i>52.4</i>	<i>55.1</i>	<i>46.0</i>
	Pa përgjigje	0.6	0.9	2.0

Duket shqetësues, madje disi i habitshëm, pohimi i disa grave sipas të cilave në 58 për qind të rasteve dhunuesit janë "të tjerë, veç familjarëve". Sociologët pohojnë, në studimet e tyre, se të rinjtë e të rejat që socializohen në familjet e dhunëshme janë më të prirur që të përfytyrojnë çoroditje, të "kërkojnë rrugë të lehta", deri të inkriminohen (Dervishi, 2000: 56). Ata janë, pra, më të prirur për të qenë objekt apo kontigjente të trafikimit.

Edhe në linjat e dhunës brenda saj, familja shqiptare shfaqet në

⁸⁹ Dy burimet me të cilat është krijuar tabela 53 janë: 1. QGSH, 2003: 41-42, për ushtruesit e dhunës jashtë apo brenda familjes (vetëm për qytetin e Shkodrës); 2. Dervishi, 2000: 54-56, për diferencimet brenda familjes, anketim kombëtar.

profilin e saj tradicional. Për t'u theksuar është përkujdesja apo tutoria e dhunshme e vëllezërve ndaj motrave, që lidhet me opinionin se vëllezërit kanë për detyrë të ruajnë nderin e motrave, për të mos shkarë në trafikim e prostitucion.

Pse dhunohen gratë? Kushtet e këqia ekonomike konsiderohen si shkak parë i konflikteve dhe i dhunës mbi to (51.1 për qind). Si shkak i dytë, renditet, prej tyre, abuzimi me alkoolin (19.9 për qind). Nivelin e ulët kulturor dhe mungesën e arsimimit, gratë e anketuara e rendisin të tretin (13.3 për qind) dhe, pas tyre superioritetin (e perceptuar) të burrave ndaj tyre (9.4 për qind).

Këto janë disa shkaqe konkrete të pohuara në një anketim konkret (QGSH, 2003: 39). Por tej këtyre, ka një shkak më të përgjithshëm, që del nga intervistat me disa drejtuese të organizatave të shoqërisë civile, me orientim problematikat gjinore: dhunimi i grave ndodh për shkak të një statusi të vçantë, për shkak të të qenit grua, pra për një shkak të përgjithshëm, ose pa shkak. Këtëj buron kërkesa e tyre për trajtimin ligjor të problemit, për mbrojtjen ligjore të grave, mbi bazën e një “statusi të vçantë”.

Mediat raportojnë se në Shqipëri është gjithnjë në rritje numri i grave që denoncojnë dhunën (Gjermani & Bregu, 2003: 7). Por jemi ende në atë stad kur, të paktën dhuna në familje, konsiderohet si një detaj i jetës martesore dhe jo si krim. Ka ardhur koha që të kalohet nga të konstatuarit në hartimin e politikave për zgjidhjen e problemit.

Dilema ‘martesë apo bashkëjetesë’ dhe ndikimi i trafikimit

Me hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Familjes, në vitin 2003, martesë ka filluar të njohë edhe në Shqipëri një “konkurent” tanimë zyrtar: bashkëjetesën e cila, sipas tij (neni 163) është:

... një bashkim fakt midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie.

Sipas anketimeve (tab. 56), del se shkalla e pranueshmërisë së bashkëjetesës (1+2), nga opinionin e sotëm shqiptar është relativisht e madhe (65.8 për qind). Gratë/vajzat janë më të prirura të quajnë

bashkëjetesën si të domosdoshme, madje në masën 20 për qind më shumë se djemtë/meshkujt.

Tabela 56: Vlerësme mbi bashkëjetesën

Përgjigjet e dhëna	Pranueshmëria e bashkëjetesës
E domosdoshme	14.1
E pranueshme	51.7
Jo normale	22.4
Nuk mund ta vlerësoj	11.8
Gjithsej	100.0

Burimi: Sokoli, Lekë. 2004b, fq. 22

Në studimet e viteve të fundit janë dhënë, gjithashtu, opinionet mbi bashkëjetesën nga vajzat beqare, në raport me vlerësimin që kanë nënat për to.

Tabela 57: Çfarë parapëlqejnë më shumë vajzat beqare dhe nënat për vajzat e tyre?

Parapëlqimet	Vajzat beqare	Nënat për vajzat e tyre
Martësën	60.33	77.64
Bashkëjetesën	31.5	13.08
Pa përgjigje	7.87	9.29

Burimi: Dervishi, Zyhdi. 2000, fq. 174

Siç shihet, përqindja e vajzave beqare që e quajnë bashkëjetesën si më të përshtatëshme, kundrejt martesës, është e lartë (31.5 për qind). Ndërsa nënat e shohin dukurinë e bashkëjetesës së vajzave të tyre me syze më të errëta se vetë ato. Në përgjithësi, vërehet një *kontradiktë midis shkallës së lartë të pranueshmërisë së bashkëjetesës apo edhe dëshirës për ta praktikuar atë, nga njëra anë, dhe realizimit të saj në fakt, nga ana tjetër*. Kjo lidhet me praninë e barrierave, të cilat burojnë nga mentaliteti (mospëlqimi i prindërve, i opinionit tradicionalist, i frikës nga mospëlqimi prej bashkëshortit të ardhshëm etj.), si dhe të barrierave ekomomike, që lidhet me pamundësinë e plotësimit të kushteve për bashkëjetesë.

Por rezulton se nuk mund të mos llogaritet, si faktor, edhe mungesa

e besimit dhe dyshimi që kanë vajzat ndaj djemve, i lidhur me mundësinë e trafikimit. Në këtë kohë tranzicioni, pohojnë ato, nuk i zihet besë fejesës dhe martesës që lidhen midis dy palë burrave, jo më bashkëjetesës, e cila i ngjan një gomoneje të pasigurtë në mes të detit....” (Dervishi, 2000).

Dilemat e vajzave ndaj djemve nën efektin ‘trafikim’

Të dhënat e këtij studimi dëshmojnë se forma kryesore e trafikimit është ajo “përmes premtimeve për martesë”. Vajzat, nga ana tjetër, janë të shqetësuara për “avullimin e djemve” dhe vështirësitë për t’u martuar. Kjo më e theksuar për vajzat e zonave rurale. Nga të dhënat e sondazhit ‘kombëtar’ del se ‘mungesa e fatit’ dhe ‘një martesë e palumtur’ i trëmb ato më shumë se gjithçka. Dhe, për të testuar këtë problematikë të trazuar formuluar një pyetje vetëm për vajzat, lidhur me qëndrimin ndaj një djali që do t’u shprehte atyre dashurinë.⁹⁰ Në tabelën 58, janë pasqyruar përgjigjet e të anketuarave, sipas perceptimit të përmasave të trafikimit, nga del se ‘*dyshimi*’ shkon në përpjestim me nivelin e shqetësimit mbi trafikimin.

Tabela 58: Dilemat e vajzave ndaj djemve të ndikuara nga trafikimi.
(Në përqindje)

Dilemat e vajzave	Perceptimi i përmasave të trafikimit		
	Është shqetësim	Nuk është shqetësim	Pa vlerësim
Besimi në sinqeritet	25.8	42.6	42.0
Dyshimi, dëshira për të vërtetuar sinqeritetin	57.7	40.4	26.0
Nuk di ta vlerësoj	16.5	17.0	32.0
<i>Gjithsej</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>

⁹⁰ Pyetja ishte kjo (anketa ‘kombëtare’, pyetja 13): “Për një djalë që ju shpreh dashurinë, ju kërkon të fejohehi me të etj., e para ndjesi që përjetoni është: 1. Besimi se ai është i sinqertë; 2. Dyshimi se ai vetë kërkon t’ju shfrytëzojë seksualisht; 3. Dyshimi se ai kërkon t’ju mashtrojë për t’ju trafikuar; 4. Dëshira për ta vënë në provë; 5. Nuk di ta vlerësoj”.

Në tërësinë e kombinimeve të mundëshme të variablave, lidhur me këtë përgjigje, interes paraqet analiza sipas vendbanimeve, nga del se *vajzat e fshatit besojnë në sinqeriteëin e djemve 4-5 herë më pak se vajzat e qyteteve të mëdha apo të vogla*. Por më shumë se me trafikimin ato e lidhin këtë pohim me dyshimin se djemtë thjesht kërkojnë t'i shfytëzojnë ato seksualisht. Kjo, siç duket, përfaqëson për to një problem më të madh kundrejt vajzave të qyteteve. Janë pak vajza që në mënyrë të drejtpërdrejtë pohojnë dyshimin se "ai/djali" mund t'i mashërojë për t'i trafikuar. Ky tregues varion nga 2.3 për qind (në fshatra) deri në 5.3 për qind (në qyteza). Por është relativisht e madhe përqindja e vajzave që dyshimin e shprehin si dëshirë për të vënë në provë sinqeritetin. Kjo shifër shkon nga 25.8 për qind (qytezat) në 37,6 për qind (fshatrat).

Nga testimi janë marrë edhe të dhëna të tjera, sipas grupmoshës, nivelit të arsimimit, migrimit të familjes, pas vitit 1990, tipit të familjes (numrit të kurorëve), shkallës së integritimit në familje, përkatësisë etnike, shkallës së informimit dhe nivelit të perceptimit të trafikimit etj. Nëse analizojmë, për shëmbull, dukurinë në fjalë, sipas grupmoshave, del se *kur kalon në rritje nga një grupmoshë në tjetrën ulët përqindja e vajzave që besojnë në sinqeritetin e djemve* (nga 33, në 24 për qind). Pikërisht vajzat në moshë martese, 19-21 dhe sidomos mbi 21 vjeç, janë më të prirura për të dyshuar. Dyfishohet, gjithashtu, përqindja e vajzave që për një djalë që u shpreh dashurinë dyshojnë se kërkon të mashetrojë për të trafikuar, nga 4.4 për qind (16-18 vjeç), në 8.8 për qind (mbi 21 vjeç). Të dhënat sipas arsimimit, tregojnë se "koeficienti i dyshimit", i lidhur me trafikimin, është më i vogël te të rinjtë me nivel të ulët arsimor. Kjo mund të shprehi, gjithsesi në mënyrë të tërthortë, njëfarë premise më të madhe të tyre për t'u mashtruar.

Trafikimit në raport me problemet e sotme të Shqipërisë

Trafikimi, si çdo dukuri sociale, është i lidhur dhe i ndikuar edhe nga probleme të tjera sociale. Për të anketuarit ishte e vështirë të "zgjidhnin" problemin më të rëndësishëm, midis problemeve të mëdha të Shqipërisë së sotme. Vështirësia shtohet nga fakti se fenomenet

për të cilat kërkuan të informohemi nuk janë feomene të izoluara. Korrupsioni, varfëria dhe papunësia, niveli i kriminalitetit dhe konfliktualiteti në familje, niveli i shkollës dhe i shoqërisë civile, deri përdorimi i drogës etj., ndikohen dhe ndikojnë mbi njëra-tjetrën, sikurse janë në një raport të caktuar edhe me trafikimin e qenieve njerëzore. Megjithatë kërkesës sonë për të hulumtuar rreth kësaj çështjeje, të anketuarit i janë përgjigjur, si në tabelën 59.

Tabela 59: Problemi më shqetësues, sipas vendbanimeve

Problemi kryesor	Përgjigjet e marra, sipas vendbanimeve			Kampioni 'kombëtar'
	Qytete të mëdha	Qytete të vogla	Fshatra	
Korrupsioni	24.9	25.9	25.1	25.2
Moszbatimi i ligjeve	15.8	19.8	13.3	16.1
Trafikimi i femrave...	5.9	6.0	9.2	6.8
Kriminaliteti	6.5	5.2	12.2	7.7
Përdorimi i drogës	4.2	6.5	0.8	3.8
Niveli i ultë i shkollës	5.7	3.4	4.8	5.0
Varfëria/papunësia	28.1	25.0	23.6	26.2
Mënyra e të bërit politikë	4.3	4.3	7.0	5.1
Shoqëria civile e dobët	2.6	3.0	1.1	2.3
Konfliktet në familje	2.0	0.9	2.9	2.0
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Anketa sociologjike me individë të gjashtë qarqeve të Shqipërisë, 2005

Tabela 60: Rënditja e problemeve sipas shkallës së shqetësimit, në qytete të mëdha, qyteza e fshatra

	Qytete të mëdha	Qytete të vogla	Fshatra
I	Varfëria/papunësia	Korrupsioni	Korrupsioni
II	Korrupsioni	Varfëria/papunësia	Varfëria/papunësia
III	Moszbatimi i ligjeve	Moszbatimi i ligjeve	Moszbatimi i ligjeve
IV	Kriminaliteti	Përdorimi i drogës	Kriminaliteti
V	Trafikimi i femrave...	Trafikimi i femrave...	Trafikimi i femrave...
VI	Niveli i ulët i shkollës	Kriminaliteti	Mënyra e të bërit politikë
VII	Mënyra e të bërit politikë	Mënyra e të bërit politikë	Niveli i ulët i shkollës
VIII	Përdorimi i drogës	Niveli i ulët i shkollës	Konfliktet në familje
IX	Shoqëria civile e dobët	Shoqëria civile e dobët	Shoqëria civile e dobët
X	Konfliktet në familje	Konfliktet në familje	Përdorimi i drogës

Burimi: Anketa sociologjike me individë të gjashtë qarqeve të Shqipërisë, 2005

Siç shihet, trafikimi i grave dhe i adoleshentëve perceptohet si një ndër pesë problemet themelore të shoqërisë së sotme shqiptare. Ai vjen, sigurisht me një diferencë të konsiderueshme në përqindje, pas problemeve të tilla madhore si korrupsioni, niveli i varfërisë, i zbatimit të ligjeve etj. Ai perceptohet më problematik, në raport me nivelin e shkollës, mënyrën e të bërit politikë, nivelin e shoqërisë civile, përdorimin e drogës apo konfliktet familjare. Nga të dhënat e anketimit ‘kombëtar’ rezultojnë, gjithashtu, këto vlerësime, lidhur me perceptimin e trafikimit, në raport me problemet e sotme:

1. Në analizën sipas vendbanimeve të përceptuesve të këtij shqetësmi, nuk rezulton ndonjë diferencim i madh midis qyteteve të mëdha, të vogla dhe fshatrave. Megjithatë në fshatra ai perceptohet si shqetësim kryesor, në masë më të madhe se në qytetet e mëdha apo të vogla. Kjo, siç del edhe nga intervistat, apo diskutimet në grupet e studimit (fokus groups), lidhet më shumë me ndjeshmërinë më të madhe ndaj trafikimit që ka popullsia fshatare shqiptare, kundrejt asaj qytetare. Të dhënat flasin për një diferencim të dukshëm të perceptimit mbi trafikimin, kundrejt dukurive të tjera shqetësuese në qytete e fshatra. Për shëmbull, në qytetet e vogla, trafikimi rënditet i pesti, ndërsa përdorimi i drogës rënditet para tij (i katërti). Në fshatra, përkundrazi, përdorimi i drogës është rënditur i dhjeti, pesë shkallë pas trafikimit.

2. Në analizën sipas grupmoshave, del se kur kalohet, në rritje, nga një grupmoshë në tjetrën, ndryshon edhe renditja e trafikimit, kundrejt problemeve të tjera. Të rinjtë e grupmoshave 16-18 dhe 19-21 vjeç, për shëmbull, e perceptojnë trafikimin si më shqetësues, kundrejt të anketuarve të moshës mbi 21 vjeç. Kjo lidhet me sigurinë më të madhe që ndjejnë grupmoshat e rritura për të mos qenë objekt trafikimi. Ky përfundim konfirmohet edhe nga analiza e të dhënave të tjera të sondazhit tonë, sikurse nga të dhënat cilësore të studimit.

3. Mjaft i qartë është diferencimi i perceptimit të trafikimit, sipas përkatësisë gjinore. *Femrat e konsiderojnë trafikimin më problem se meshkujt, afërsisht, në raportin dy me një.* Në perceptimin e femrave, më problem se trafikimi janë varfëria/papunësia, korrupsioni dhe moszbatimi i ligjeve. Këto janë, njëherësh, edhe probleme me ndikim të madh mbi vetë trafikimin e grave dhe të adoleshentëve. Në

perceptimin e meshkujve, veç këyre te problemeve, më shumë se trafikimi janë edhe dy probleme të tjera: niveli i kriminalitetit dhe ai i përdorimit të drogës. Konstatojmë, kështu, njëfarë ndarjeje relativisht të qartë të “zonave të përfshirjes” në Shqipëri: Trafikimi perceptohet më shumë si një veprimtari që prek gratë e vajzat, kurse krimi apo edhe përdorimi i drogës perceptohen si veprimtari kryesisht mashkullore. Ky përfundim përputheë me të dhëna të tjera të këtij studimi, sikurse me ato të studimeve të tjera⁹¹.

4. Analiza sipas nivelit të arsimit tragon se nuk ka ndonjë diferencim të dukshëm midis perceptimve të atyre që kanë nivel të ulët arsimor (term me të cilin kemi grupuar për efektë analize ata që nuk kanë kurrëfarë arsimit dhe ata që kanë arsim deri në tetëvjeçar), kundrejt atyre me nivel të lartë arsimor (atyre që kanë kryer ose vazhdojnë arsimin e mesëm e të lartë). Diferencimet lidhen më shumë me perceptimin e faktorëve të tjerë që ndikojnë edhe në trafikimin e femrave dhe adoleshentëve. Ata me arsim më të lartë, për shëmbull, e vlerësojnë korrupsionin si shqetësim, më shumë se ata me arsim më të ulët. Ata, gjithashtu, nuk i japin faktorit vafëri/papunësi rëndësinë që i japin të anketuarit me arsim më të ulët, duke theksuar, kështu (qoftë edhe tërthorazi), vlera të tjera të shoqërisë.

5. Nuk rezulton ndonjë ndryshim në analizën sipas përkatësisë fetare. Diferenca fare të vogla konstatohen edhe në perceptimin që kanë mbi trafikimin ata që basojnë shumë, krahasuar me ateistët.

6. Më shumë interes paraqesin përfundimet e analizës që vendos në një vartësi funksionale perceptimin e trafikimit dhe shkallën e integritit në familje. Individët që pohojnë se shumicën e kohës e kalojnë larg familjes e perceptojnë trafikimin si një problem reth dy herë më shqetësues, kundrejt atyre që pjesën më të madhe të kohës e kalojnë në familje. Njëherësh, ata që qëndrojnë larg familjes janë më të ndjeshëm ndaj korrupsionit, ndiejnë më pak se të tjerët peshën e papunësisë e të verferisë (mjafat prej tyre qëndrojnë larg shtëpisë për *arsye punësimi*), dhe përjetojnë më pak se të tjerët edhe konfliktualitetin në familje. Nga sa më

⁹¹ Për shëmbull, në Shqipëri përdoruesit meshkuj të drogës, kundrejt femrave, janë në raportin 6 me 1 (sih: Sokoli, Lekë. 1999. *Droga, historia, përkufizime, klasifikimi, përhapja, efekte, terapia*. Tiranë: Onufri & Fondacioni Soros, fq. 190-91.

sipër, rezulton se familja është, me gjithë ndryshimet e derisotme, sërish barriera më e madhe ndaj trafikimit të grave dhe adoleshentëve. Konfirmohet, gjithsesi, kjo priirje: Niveli i trafikimit të grave dhe adoleshentëve varion në përpjesëim të zhdrejtë me shkallën e integritit dhe cilësinë e jetës në familje.

Rreth vicioz i trafikimit ose trafikimi si ‘shkak’ për ritrafikim

Trafikimi, siç pamë, nuk ka një shkak të vetëm, por një kompleks shkaqesh. Studimi tragon se, në mjaft raste, trafikimi shndërrohet në ‘shkak’ për riciklimin në trafikim, si në një rreth vicioz. Pra, a është trafikimi i grave dhe i adoleshentëve një proces pa kthim apo, në të kundërt, mund të dilet prej tij? Ç’qëndrim mban familja dhe shoqëria me të rikthyerit pas trafikimit? Çfarë barrierash pengojnë riintegrimin e të trafikuarve në shoqërinë shqiptare? Për t’u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, kërkuam opinionet e të anketuarve, përmes dy pyetjeve: “A njihni, një person të trafikuar por të kthyer në shtëpi? (anketa ‘kombëtare, pyetja 23) dhe “Nëse ‘po’, ç’qëndrim ka mbajtur familja e tij dhe shoqëria? (po aty, pyetja 24), me disa alternativa përgjigjesh.⁹²

Tabela 61: *A njihni, një person të trafikuar, por të kthyer në shtëpi?*

Përgjigjet e marra	Frekuenca	
	Në numër	Në përqindje
Po	434	43.0
Jo	575	57.0
Gjithsej	1009	100.0

Të dhënat janë sistemuar në tabelën në vijim (tab. 62). Ato tregojnë se rikthimi i personave të trafikuar është, gjithsesi, i mundur qoftë për shkak të arrestimeve apo ndërhyrjeve të policisë, në vendet ku janë trafikuar, apo edhe në rrethana të tjera, siç janë ndihma e strukturave të shoqërisë civile, e klientëve të prostitucionit, lidhjet e dashurisë etj. Këtë e dëshmon fakti që 43 për qind e të anketuarve

⁹² Alternativat e përgjigjeve janë këto: 1. Familja e mirëpriti, por jo komuniteti; 2. Komuniteti e mirëpriti, por jo familja; 3. E mirëpriten së bashku; 4. Nuk e mirëpriti as familja, as komuniteti; 5. Nuk di ta vlerësoj).

pohojnë se njohin të paktën një nga trafikuarit e rikthyer në Shqipëri dhe japin vlerësimin e tyre për shkallën e pranueshmërisë (ose në të kundërt, të papranueshmërisë), së tyre në familje dhe në komunitet.

Por konstatohen diferencime në “shpërndarjen” sipas prefekturave. Në Elbasan, për shëmbull, të anketuarit që pohojnë se njohin të rikthyer midis të trafikuarve (60.7 për qind), janë gati sa dyfishi i atyre që bëjnë këtë vlerësim nga prefekturë e Kuksit (34.1 për qind) apo Shkodrës (33.5 për qind). Diferencime rezultojnë edhe nga krahasimet qytet-fshat (tab. 63). Përqindja e atyre që njohin të rikthyer nga trafikimi është mjaft më e madhe në fshatra (57.6 për qind), se në qytetet e mëdha (36.9 për qind) ose qytezat (38.9 për qind).

Tabela 62: Rikthimi i të trafikuarve, sipas vendbanimeve

Përgjigjet	Përgjigjet e marra, sipas vendbanimeve			Kampioni kombëtar
	<i>Qytete të mëdha</i>	<i>Qytete të vogla</i>	<i>Fshatra</i>	
Po	36.9	38.9	57.6	43.0
Jo	63.1	61.1	42.4	57.0
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0

Sa e mundur është shkëputja nga trafikimi? Të dhënat cilësore të këtij studimi, sikurse burime të tjera, dëshmojnë vështirësinë e shkëputjes nga trafikimi, sidomos për rastet e trafikimit për shfrytëzim prostitucioni. Por, ç’ndodh me të rikthyerit?

Pastrafikimi, familja & komuniteti

Nga ky studim del se trajtimi i të trafikuarve të rikthyer është një problem me ngarkesë të madhe, sidomos moralo-psikologjike. Ai lidhet me shkëputjen e individëve nga trafikimi dhe integrimin në shoqëri e familje ose, në të kundërt, me riciklimin e tyre në trafikim.

Nga të dhënat e siguruara rezulton se marrëdhëniet ‘familje - i rikthyer nga trafikimi - komunitet’ janë relativisht problematike. Kjo pasqyrohet në shkallën e ndryshme të pranueshmërisë së të kthyerve nga trafikimi në rajone e zona të ndryshme të Shqipërisë. Përqindje e rasteve në të cilat “familja e mirëpriti, por jo komuniteti” varion, për shëmbull, nga 27.5 për qind (Kuksi) në 50.8 për qind (Korça).

Diferencime në shkallën e (pa)pranueshmërisë së të trafikuarve nga familje e komuniteti konstatohen edhe sipas vendbanimeve: qytet-fshat (tab. 63). Përqindja e rasteve “familja e mirëpriti, por jo komuniteti” është më e madhe në fshatra (54.2 për qind), se në qytetet e mëdha (37.7 për qind) e sidomos në krahasim me qytetet e vogla (33.7 për qind).

Por më shumë se diferencimet “gjeografike” (midis zonave apo vendbanimeve), për t’u vlerësuar janë diferencimet që konstatohen midis familjeve dhe komuniteteve (opinionit shoqëror). Rastet e vlerësimeve e qëndrimeve të ndryshme familje-komunitet (1+2) përfaqësojnë shumicën e rasteve të cilave u jemi referuar.

Tabela 63: Qëndrimi ndaj të trafikuarve të rikthyer, sipas vendbanimeve (Në përqindje)

Qëndrimi i mbajtur	Përgjigjet e marra, sipas vendbanimeve			Kampioni kombëtar
	Qytete të mëdha	Qytete të vogla	Fshatra	
1. Familja e mirëpriti, por jo komuniteti	37.7	33.7	54.2	42.4
2. Komuniteti e mirëpriti, por jo familja	6.6	7.9	3.1	5.8
3. E mirëpriten së bashku	10.4	13.9	17.6	13.4
4. Nuk e mirëpriti as familja, as komuniteti	25.7	20.8	18.2	22.2
5. Nuk di ta vlerësoj	19.6	23.7	6.9	16.2
<i>Gjithsej</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>	<i>100.0</i>

Shumë shqetësim përfaqëson niveli mjaft i lartë i brakësisjes së të trafikuarve, njëherësh, nga familja dhe komuniteti. Duket se janë pikërisht faktorët tradicionalë, domethënë ata që frenojnë trafikimin (moral, turpi, presioni shoqëror etj.) që, njëherësh, ndikojnë edhe në mos pranimin, sidomos të grave të kthyer nga trafikimi. Në mënyrë të përafërt mund të pohojmë se kjo përfaqëson edhe përqindjet e rasteve të riciklimit në trafik, i cili mbetet alternativa më e mundshme.

Problemi ka të bëjë me humanizimin e shoqërisë shqiptare, me solidaritetin midis anëtarëve të saj e të çdo institucioni, brenda saj. Edhe pse trafikimi është, gjithsesi, “detyrim nga trafikantët me forcë apo mashtrim, për shfrytëzim seksual ose të ndonjë forme tjetër fitimprurëse, përsëri trafikimi nuk “përthypet” si një fatkeqësi.

Në opinionin shqiptar, sidomos femrat e trafikuar vazhdojnë të stigmatizohen dhe të fajsohen. Një i intervistuar nga Korça shprehet kështu:

Më vjen shumë keq për të gjithë personaë që bien pre (viktimë) e trafikimit, pasi ata vuajnë dy here: një herë kur trafikohen dhe një herë në momentin e kthimit të tyre pranë familjeve, kur nuk pranohen si nga familjet ashëu edhe nga komuniteti dhe kjo për faktin e vetëm se nuk konsiderohen viktima, por fajtoje.

Një e intervistuar, në Shkodër, jep shembullin e dy motrave, shoqe të saj:

Njëra (më e madhja), u fejuar por shpejt u nda. Pastaj përjetoi një lidhje, thjesht për të plotësuar kënaqësitë e trupit. Motra e vogël ishte zanafilla e trafikimit. Ajo u fejuar, por kur mori vesh se i fejuari ishte trafikant, ia mbathi. Veçse nuk përfundon me kaq. Të dy motrat zhduken për disa kohë, për shkak të opinionit mbytës, u rishfaqen sërish por përsëri ikën. Tani punojnë në një lokal të Ulqinit (Mal i Zi): larg familjes që nuk i pranoi, larg shoqërisë....

Një rol më të rëndësishëm në përmbysjen e këtij mentaliteti ndaj të trafikuarve, sidomos grave, mund të luajë media, sikurse shoqëria civile, në mënyrë të vaçantë qendrat pritëse dhe riaftësuese të tipit “Vatra”-Vlorë, Hëna e Re-Elbasan etj. Në çdo rast ‘pritja’ mund të kombinohetë me ndërmjetësimin midis të trafikuarve të rikthyer dhe familjarëve të tyre, që shkallë-shkallë të arrihet në ‘pajtimin’ dhe bashkimin e tyre.

“Nota” e institucioneve të shoqërisë, përkundrejt trafikimit

Cili është vlerësimi i institucioneve të shoqërisë shqiptare, në këndvështrimin e ndikimit mbi trafikimin e grave dhe të adoleshentëve? Në perceptimin e përgjigjedhënësve të anketës sonë ‘kombëtare’, “nota” e vlerësimit për punën e institucioneve kundrejt trafikimit (nga 1-vlerësim shumë i keq në 10- vlerësim i shkëlqyer), pasqyrohet në tabelat 64 e 65.

Tabela 64: *Renditja e institucioneve, për nga shkalla e vlerësimit pozitiv, përkundrejt trafikimit*

Institucionet	Vlerësimet me “notat” 8-10
Mediat	43.6
Shoqatat, Organizata Jo-qeveritare	37.6
Komunitetet fetare	37.4
Komunitetet qytetare dhe opinioni publik	17.1
Policia	7.1
Gjykatat dhe Prokuroria	7.0
Qeveria shqiptare	5.7

Burimi: Anketa sociologjike me individë të gjastë qarqeve të Shqipërisë, qershor 2005

Tabela 65: *Renditja e institucioneve, për nga shkalla negativitetit, përkundrejt trafikimit*

Institucionet	Vlerësimi i negaëivitetit (nota 1-3)
Qeveria shqiptare	66.1
Gjykatat dhe Prokuroria	54.6
Policia	49.0
Komunitetet qytetare dhe opinioni publik	32.9
Komunitetet fetare	27.6
Shoqatat, Organizata Jo-qeveritare	17.9
Mediat	13.9

Burimi: Anketa sociologjike me individë të gjastë qarqeve të Shqipërisë, qershor 2005

Në të dy vlerësimet del ky rezultat: në perceptimet qytetare, institucioni më i vlerësuar kundrejt trafikimit është media. Më pas vjen shoqëria civile, komunitetet fetare, komunitetet qytetare dhe, pas tyre institucionet e shtetit: policia, gjykatat dhe prokuroria. E fundit në vlerësimin e bërë është qeveria shqiptare e cila ka vetëm nga 5.7 për qind e të anketuarve është vlerësuar me notat e larta 8-10.

Shkolla, mediat dhe institucionet e shtetit (refleksione e sugjerime)

Në pjesë të tjera të këtij studimi⁹³ janë pasqyruar disa të dhëna të anketimit të cilat nxjerrin në pah edhe rolin e shkollës në procesin e

⁹³ Për shëmbull, në pjesën “Perceptimi i trafikimit në raport me problemet e sotme të Shqipërisë”.

trafikimit të grave e të adoleshentëve. Të anketuarit dhe të intervistuarit pranojnë nivelin cilësisht të ulët të shkollës në Shqipërinë e sotme. Ata e konsiderojnë këtë si një ndër dhjetë problemet e mëdha të kohës, madje e rendisin në vendin e VI dhe të VII, respektivisht në qytete e në fshatra.

Meriton të nënvizohet fakti që një në çdo tre të trafikuar (32.5 për qind), në momentin e trafikimit ka qenë nxënës apo student. Kjo është më e theksar në fshatra, ku në më shumë se gjysmën e rasteve (51.7 për qind), trafikimi ka ndodhur midis atyre që, në çastin e realizimit, vijonin shkollën. Kjo është një ndër dëshmitë e shumta që tregojnë se shkolla, si institucion, ende nuk mund të konsiderohet një barrierë me peshë në trafikimin e të rinjve, nxënës apo studentë.

Në organikat e shkollave (apo grupshkollave) të sistemit nëntëvjeçarë janë, tanimë, edhe psikologët. Të paktën nëse i referohemi trafikimit, na rezulton se roli i tyre është i papërfillshëm. Duket e nevojshme që në këtë drejtim të orientohen edhe projektet e shoqërisë civile, sidomos të organizatave mendore⁹⁴ brenda tyre, për trajnimin e psikologëve të shkollave, sikurse edhe të drejtuesve të tyre, apo mësuesve të lëndëve shoqërore, sidomos të lëndës së sociologjisë.

Një pjesë e të trafikuarve, në çastin e trafikimit, kanë qenë minorene që kishin braktisur shkollën, ose që nuk kanë filluar atë ndonjëherë. Romët janë komuniteti më i palidhur me shkollën dhe, njëherësh, më i disponueshmi për të nxjerrë kontigjente trafikimi. Ja një shëmbull: Autorët e këtij studimi bashkëbiseduam me një grup fokusi në fshatin Novoselë të Vlorës. Grupi përbëhej nga 13 fëmijë të moshës deri në 12 vjeç. Ata nuk kishin asnjë dijeni për rreziqet e ndonjë trafikimi të mundshëm të tyre. Për më tepër ata nuk figuronin në regjistrat e shtetit shqiptar dhe as që mund të bëhej fjalë për vijimin e ndonjë shkolle. “Disiplinimi” i këtij komuniteti, me mjete ligjore (të paktën për arsimin e detyruar) dhe jo-ligjore (shoqëria civile etj.) dhe sidomos lidhja e këtij komuniteti me shkollën duhet të përbëjë një prioritet më vete.

⁹⁴ Me “organizata mendore” (ang. “think-tanks”), kemi kategorizuar organizata të shoqërisë civile, që kanë për objekt të veprimëarisë së tyre studimin e dukurive të sotme dhe formulimin e politikave publike, përpunimin e opinionit, trainimet etj.

Por braktisja e shkollës apo mosvijimi i saj rezulton të jetë një dukuri që po përhapet kudo në Shqipëri. Në pyetjen mbi nivelin arsimor të të anketuarve, doli se 1.2 për qind e tyre ishin “pa kurrëfarë arsimit” (anketa ‘kombëtare’, pyetja 3). Rikthimi i analfabeëizmit, pas zhdukjes së tij për disa dhjetëvjeçarë, duket se është një tjetër problem me të cilin ballafaqohet shoqëria shqiptare. Të paarsimuarit janë kontigjentet më të predisopzuar për t’u përdorur nga trafikantët, për prostitucion, krime etj.

Në anketimin ‘kombëtar’, del se shkolla as nuk i informon nxënësit për rreziqet e trafikimit. Vetëm 3.5 për qind e të anketuarve në shkollë kombtare (por vetëm 1.5 për qind nga të anketuarit e fshatrave), pohojnë se janë informuar për trafikimin pikërisht nga shkolla/mësuesit. Marrja e informacionit për trafikimin e qenieve njerëzore, në veçanti të femrave dhe adoleshentëve, përmes përfshirjes në programet shkollore apo përdorimit të formave të tjara që aplikon shkolla (siç parashikonin edhe trajnimet e IOM-it, gjatë vitit 2006), duket se është forma më e mirë, në mos e vetmja për institucionalizimin e një informimi të kualifikuar për rininë shkollore, që rezulton të jetë skaloni i parë i përfshirjes në trafikim, sikurse i përdorimit të drogës etj.

Ndër më problematikët, midis institucioneve të shtetit, lidhur me trafikimin, rezulton të jenë gjykatat dhe prokuroritë. Në studime të ndryshme (shih, Leskaj ed al., 2004), është pohuar se ligjet mbi trafikimin janë të buta dhe janë sugjeruar iniciativa ligjore për forcimin e tyre⁹⁵. Por, sipas ligjit në fuqi (pas amendimit të Kodit Penal, shkurt 2004), trafiku i femrave për prostitucion, për shëmbull, dënohet me burgim nga 7-15 vjet. Ndërsa kur trafikimi ka çuar në vdekjen e viktimave, trafikanti dënohet deri me burgim të përjetshëm. Këto dispozita parashikojnë konfiskimin e të gjitha mjeteve dhe përfitimeve të tjera materiale.

Sa më sipër, duket se, përgjithësisht, ligjet antitrafik janë, por ato nuk zbatohen si duhet. Kjo sepse, nga njëra anë, ligjet kanë ndryshuar por mentalitetet jo. Veshët e një gjyqtari nuk janë “mësuar” me termin

⁹⁵ Edhe sipas një sondazhi të bërë me opinionin publik, del se 87 për qind e shqiptarëve pohojnë se duhen ligje më të forë kundër trafikimit (Leskaj ed el, 2004: 64).

‘dënim trafikantësh’, derisa kjo praktikë nuk ka ekzistuar në të shkuarën. Më kryesorja është se gjykatat nuk janë ende realisht të pavarura. Por nëse flitet e kërkohet për pavarësinë e tyre nga politika, lihet disi mënjane fakti që ato janë relativisht të varura edhe nga trafikantët. Studiuesit pohojnë se:

“Trafikantët e seksit janë mirëorganizuar, kanë krijuar rrjete të mirëfillta të tipit mafioz, të aftë për të korruptuar prokurorë, gjyqtarë, policë, politikanë etj. Lidhja që këto rrjete kanë krijuar me segmente të pushtetit përfaqëson problemin themelor”⁹⁶.

Opinionistët tanë (të anketuarit apo të intervistuarit), mendojnë pak a shumë njësoj, kur rëndisin korrupsionin dhe moszbatimin e ligjeve, si dy ndër tre problemet me ndikimin më të madh në trafikimin e grave e të adoleshentëve (tab. 59 & 60).

Në studime të tjera dhe, përgjithësisht, në debatet e përditshme, media ka mbetur e pavlerësuar. Në studimin tonë ajo del si institucioni me ndikimin më të madh pozitiv, lidhur me trafikimin, midis institucioneve të shoqërisë. Ndër problemet që mundëm të konstatojmë është fakti që media, në përpjekjen për të fituar besueshmëri, shndërrohet shpesh në mjet diskriminimi të viktimave të trafikimit. Kjo lidhet me publikimin, me gjenialitete të plota, të të trafikuarve, sidomos të pjesës më të guximshme të tyre: femrave që gjejnë forca të denoncojnë trafikuesit e tyre. Në këtë mënyrë shkelen të drejtat e tyre, reagon opinionin përçmues për to, nxiten të aktivizohen familjarët apo të afërmit e fyer, nxitet vetëgjyqësia etj. Mbi të gjitha, krijohet mendimi se “po denoncove do të bëhesh gazi i botës” (siç pohon J. F, një e trafikuar denoncuese e tutorit të saj, nga rrethinat e qytetit të Shkodrës).

Trafikimi dhe (mos)siguria për të ardhmen

Ç’vënd zë trafikimi midis problemeve që shkaktojnë frikë (pasiguri) apo, në të kundërt siguri e besim për të ardhmen? Për të testuar

⁹⁶ Sipas inëervistës me prof. Luan Omari, jurist i se drejtes, nënkryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

opinionin qytetar formuluar një pyetje të anketës ‘kombëtare’ (pyetja 15): “Çfarë ju tremb më shumë për të ardhmen?”, duke kërkuar që trafikimi të vlerësohej midis një varg problemesh si varfëria, mungesa e fatit, një martesë e palumtur, droga, SIDA etj.

Të dhënat janë përpunuar sipas vendbanimeve, grupmoshës, gjinisë, nivelit të besimit fetar etj. “Përfshirja në trafik” renditet, për të gjithë kampionin ‘kombëtar’, e shtata me 4.7 për qind dhe vlerësohet (trëmb) më shumë se droga, SIDA, lufta etj. Kjo për përgjigjet direkte. Tërthorazi ky shqetësim duhet të ketë ndikuar edhe në vlerësimet shumë të larta për dy elementë me të cilët të anketuarit e lidhin trafikimin, që janë “mungesa e fatit” dhe “një martesë e palumtur” e që, së bashku, përceptohen me shqetësim të madh.

Të dhënat (tab. 66), tregojnë se trafikimi tremb më shumë rininë e qytetave (7.4 për qind) dhe të qyteteve të mëdha (6.0 për qind), por shumë pak ose aspek atë fshatare (vetëm 1.1 për qind). Kjo e dhënë konfirmon përfundimet e mëparshme të këtij studimi.

Tabela 66: Pasiguria për të ardhmen, sipas vendbanimeve

(Në përqindje)

Çfarë tremb më shumë?	Sipas vendbanimeve			Kampioni ‘kombëtar’
	Qytete të mëdha	Qyteza	Fshatra	
Varfëria	20.5	23.5	11.8	18.8
Mungesa e fatit	12.7	10.0	30.1	16.9
Një martesë e palumtur	16.5	13.0	20.1	17.5
<i>Përfshirja në trafik</i>	<i>6.0</i>	<i>7.4</i>	<i>1.1</i>	<i>4.7</i>
Droga	3.6	5.2	1.3	2.5
SIDA	3.8	4.3	1.8	3.4
Vdekja	7.2	7.0	7.5	7.3
Lufta	2.6	1.7	4.3	3.0
Fatkeqësitë natyrore	11.1	12.5	7.2	10.4
Papunësia	12.0	10.7	13.6	12.2
Të tjera	4.0	4.7	1.4	3.5
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Anketa sociologjike me individë të gjashtë qarqeve të Shqipërisë, 2005

Me kalimin në rritje nga një grupmoshë në tjetrën, shqetësimi për përfshirjen në trafik bie në mënyrë të theksuar, për shëmbull, nga 10.7 për qind (16-18 vjeç), në 1.7 për qind (mbi 21 vjeç). Grupmosha

që i trembet më shumë trafikimit është ajo nën 18 vjeç, pikërisht grupmosha më e cënuar nga trafikimi.

Të dhënat e anketimit tregojnë se përfshirjes në trafik i tremben më shumë femrat se meshkujt, më shumë ata që e përceptojnë trafikimin “shumë shqetësim”, kundrejt atyre që mendojnë se “nuk përbën shqetësim (6.4 me 2.4 për qind) dhe më shumë ateistët, se besimtarët (11.5 me 5.8 për qind).

Përfundime e rekomandime

Trafikimi dhe kontrabanda e qenieve njerëzore janë dukuri përgjithësisht të reja të periudhës së tranzicionit, në Shqipëri dhe pothuaj në të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit. Ato lidhen kryesisht me shndërrimet e gjithanëshme politike, ekonomike, demografike, sociale, familjare, moralo-psikologjike etj., të ndodhura në 15-16 vitet e fundit. Ato ndikohet nga një varg faktorësh, si varfëria dhe qëndrimi ndaj saj, niveli i informalitetit të ekonomisë dhe mënyra e pasurimit, shëmbja e komuniteteve tradicionale, komercializimi i marrëdhënieve shoqërore etj.

Trafikimi përceptohet si një ndër pesë problemet themelore të shoqërisë së sotme shqiptare. Ai renditet, me njëfarë diference, pas problemeve të tilla madhore si korrupsioni, niveli i varfërisë, i zbatimit të ligjeve (edhe këto me ndikim mbi trafikimin) dhe përceptohet si më problematik në raport me nivelin e ulët të shkollës, mënyrën e të bërit politikë, nivelin e shoqërisë civile, përdorimin drogës apo konfliktet familjare etj.

Ai përceptohet si fenomen shqetësues nga shumica e shqiptarëve. Vetëm 8.3 për qind e të anketuarve pohojnë se ai nuk përbën shqetësim. Ndër prefekturat e përfshira në sondazhin ‘kombëtar’ ai përceptohet si “shumë shqetësim”, sipas kësaj rënditje: Elbasan (68.1 për qind), Vlorë (59.8 për qind), Shkodër (53.0 për qind), Korçë (43.5 për qind), Kukës (38.2 për qind) dhe Gjirokastrë (23.4 për qind). Ai përceptohet i tillë në nivele që ndryshojnë me deri në tre herë.

Trafikimi i grave dhe i adoleshentëve përceptohet si më shqetësues në fshatra (57.1 për qind), se në qytetet e vogla (45.5 për qind) apo qytetet e mëdha (40.2 për qind). Kjo lidhet më shumë me ndjeshmërinë

ende më të madhe të fshatit shqiptar kundrejt qytatit, sesa me nivelin e të qenit i rrezikuar nga trafikimi.

Mjaft i qartë është diferencimi i perceptimeve të trafikimit, sipas përkatësisë gjinore. Femrat e konsiderojnë trafikimin më problem se meshkujt, afërsisht në raportin dy me një. I qartë është, gjithashtu, vartësia e perceptimit të trafikimit nga shkalla e integritit në familje. Individët që pohojnë se shumicën e kohës e kalojnë larg familjes e përceptojnë trafikimin si “shumë shqetësues”, në masën rreth dy herë më të madhe, kundrejt atyre që pjesën më të madhe të kohës e kalojnë në familje.

Grupmosha që e përcepton më më shqetësim trafikimin është grupmosha 19-21 vjeç (53 për qind). Por mosha më delikate, kundrejt trafikimit, është ajo 12-18 vjeç. Sidomos nga të dhënat cilësore të këtij studimi del se të miturit, ndonëse janë më të rrezikuar nga trafikimi, nuk kanë ndjeshmërinë apo nivelin e perceptimit të të rinjëve të grupmoshave më të rritura, për shkak të mungesës së informimit.

Nga studimi konstatohen disa prirje të lidhura me nivelin e të qenit i rrezikuar nga trafikimi. Për shëmbull, sa më i plotë të jetë integriti në familje, apo në komunitet, aq më i mundur është evitimi i rrezikut të trafikimit dhe anasjelltas. Kur kalohet nga familjet me një prind, në atë me një kurorë dhe në familjet me shumë kurorë, perceptimi i rrezikut të trafikimit bie, nga 57 në 48.8 dhe 39.1 për qind. Familjet më të rrezikuara nga trafikimi janë familjet bërthamë (nukleare) dhe, brenda tyre, familjet me një prind, ku në 8/10 e rasteve prindi kryefamiljar është nëna.

Nuk duket ndonjë diferencim i madh në perceptimin e trafikimit sipas përkatësisë fetare apo nivelit të besimit feëar, megjithëse ata që besojnë shumë, njëherësh e përceptojnë trafikimin më shumë shqetësim (50 përqind), kundrejt indiferentëve, për shëmbull, në çështjen e besimit (35.5 për qind).

Nga të dhënat sasiora e cilësore të studimit tonë, ndryshe nga përfundimet e mëparshme (aprioristike apo të bazuara në studime të pjesëshme), përmbysët disi mendimi se varfëria është shkaku i parë dhe i fundit i trafikimit të grave dhe adoleshentëve. Del, për shëmbull, se në disa qyte si Kuksi apo Kruma, sikurse në mjaft fshatra të largët, si Bushtricë, Shëmri, Zapod (Kukës), Voskop e Drenovë (Korçë),

Picar (Gjirokastrë) etj., nuk ka, ose ka fare pak, individë që të kenë pohuar se janë ndjerë, qoftë edhe një herë të vetme, të rrezikuar për të qenë i trafikuar. Nga hulumtimi lidhur me perceptimin e së ardhmes del, gjithashtu, se trafikimi tremb rininë e qyteteve më shumë se atë të fshatrave.

Nga kjo rezulton pesha e faktorëve të tjerë, të analizuar në këtë punim. Vërtetohet se ka ndryshuar sidomos qëndrimi i shqiptarëve ndaj parasë. Luksi (mirëqenia), emigrimi dhe ëndërra për të parë botën (të gjitha të lidhura me trafikimin), vlerësohen më tepër se jeta normale dhe shumë më tepër se miqësia (një vlerë tradicionale e shqiptarëve). E lidhur me këtë dukuri është edhe rënia e krenarisë tradicionale (*lack of pride*), rënia e nivelit të vlerësimit për vetveten etj.

Përpjekjet për rivendosjen e rendit publik (sidomos në gjysmën e dytë të periudhës së tranzicionit), sikurse reagimi i individëve dhe familjeve të cënuara nga trafikimi për të vendosur drejtësi (qoftë edhe drejtësi primitive, të bazuar në kanunet tradicionale), i kanë detyruar trafikantët të ndërrojnë taktikë: përqindja më e madhe e trafikimeve (rreth 85 për qind), është realizuar me mashtrime. Më e zakonshme ndër to është mashtrimi me premtimin për martesë.

Fakti që trafikimi është bërë më i kamufluar dhe dominohet nga mashtrimi, sugjeron forma më të gjithanëshme të informimit, trainimit, edukimit apo të të mësuarit, sidomos me të rinjtë dhe nga institucionet e shoqërisë: nga familja, shkolla, shoqëria civile, institucionet e shtetit. Nevoja për informim diktohet nga fakti se individët e trafikuar janë, kryesisht, 12-18 vjeçarë (64 për qind), dhe të rinjtë me nivel të ulët arsimor.

Të trafikuarit, në shumicën dërmuese, janë midis adoleshentëve që nuk janë punësuar ndonjëherë. Kjo është gati dyfish më i theksuar në qytete (të mëdha apo të vogla), se në fshatra. Meriton vëmendje fakti që një në çdo tre të trafikuar (32.5 për qind), në momentin e trafikimit ka qenë nxënës apo student, gjë që tregon se shkolla, si institucion, ende nuk mund të konsiderohet një barrierë me peshë në trafikimin e të rinjëve, nxënës apo studentë. Kjo është më e theksuar sidomos në fshatra, ku trafikimi midis atyre që në momentin e realizimit vijonin shkollën, rezulton të jetë dukshëm më më i theksuar se në qytete (51.7 me 24.5).

Të dhënat tregojnë se suksesi lidhur me parandalimin e fenomenit të trafikimit të grave dhe adoleshentëve varet shumë nga shkalla e njohjes dhe informimit të rinjëve për mundësitë e trafikimit dhe format konkrete të realizimit të tij. Por në rreth $\frac{1}{2}$ e rasteve nuk merret një informacion i adresuar, pra informim tjetër, veç atij që merret nga media. I konsiderueshëm është vlerësimi i masës së informimit nga shoqatat, përmes përfshirjes në projekte. Por, në fshat, ky “zë” informimi është vetëm 0.7 për qind. Vihet re rënia e nivelit të informimit nga familjarët apo të afërmit, me kalimin në rritje nga një grupmoshë në tjetrën (nga 19.4 në 12.2 për qind) dhe rritje, thuajse në të njëjtën masë e rolit të institucioneve të shoqërisë, sikurse ndikimi më i madh i familjes mbi vajzat dhe i shoqërisë mbi djemtë.

Papunësia dhe varfëria perceptohen si faktorët me ndikimin negativ më të madh në trafikimin e grave dhe të adoleshentëve, më shumë si faktorë që krijojnë klimën e përgjithshme (të nivelit makro), të përshtatëshme për trafikim. Faktorët që vinë pas tyre janë mungesa e stabilitetit politik, degradimi moral i meshkujve trafikantë (57.7 për qind) dhe i femrave që përshihen në trafik (42.5 për qind), dëshira e papërmbajtur për para, sidomos te djemtë (55.3 për qind) por edhe te vajzë (34.8 për qind), mungesa e shpresës etj.

Marrëdhënieë “familje-i rikthyer nga trafikimi-komunitet” rezulton të jenë relaëivisht problematike. Shqetësim përfaqëson sidomos niveli mjaft i lartë i braktisjes së të trafikuarve, njëherësh, nga familja dhe komuniteti, që shkon nga 18.8 për qind (Korça), në 42.5 (Kuksi). Kjo përfaqëson, afërsisht, edhe përqindjet e rasteve të riciklimit në trafik, i cili mbetet alternativa më e mundëshme.

Në perceptimet qytetare, institucioni më i vlerësuar kundrejt trafikimit është media. Më pas vjen shoqëria civile, komunitetet fetare, komunitetet qytetare dhe, pas tyre, policia, gjykatat dhe prokuroria. E fundit në vlerësimin e bërë është qeveria e cila vetëm nga 5.7 për qind e të anketuarve është vlerësuar me “notat” e larta 8-10.

Shkolla vlerësohet si një nga institucionet që ende ndikon pak ose aspak në minimizimin e trafikimit. Marrja e informacionit për trafikimin, përmes përfshirjes në programet shkollore apo përdorimit të formave të tjara që përdor shkolla, duket se është forma më e mirë, në mos e vetmja për institucionalizimin e një informimi të kualifikuar për rininë shkollore.

Një pjesë e të trafikuarve kanë qenë, në çastin e trafikimit, minorene që kishin braktisur shkollën, ose nuk e kanë filluar atë ndonjëherë. Romët janë komuniteti më i palidhur me shkollën dhe, njëherësh, më i disponueshmi për të nxjerrë kontigjente trafikimi. Por braktisja e shkollës apo mosvijimi i saj rezulton të jetë një dukuri që po përhapet me shpejtësi. Rikthimi i analfabetizmit, pas zhdukjes së tij për disa dhjetëvjeçarë, duket se është një tjetër problem me të cilin ballafaqohet shoqëria shqiptare. Të paarsimuarit janë kontigjentet më të predisopzuar për t'u përdorur nga trafikantët, për prostitucion, krime etj.

Një përfundim i rëndësishëm i këtij studimi lidhet me reagimin e mundëshëm ndaj trafikimit. Reagimi ndaj situatave të ndryshme hipotetike është një tregues sintetik i nivelit të njohurive dhe i perceptimit të të anketuarve mbi trafikimin dhe kontrabandën. Për të vlerësuar reagimin e mundshëm ndaj trafikimit ishte hartuar një pyetje që lidhet me faktin se ku do të kërkonin ndihmë të anketuarit në rast se do të kërcënoheshin për t'u bërë personalisht viktima të trafikimit. Atyre u është kërkuar që të zgjidhnin disa alternativa përgjigjesh (tab. 67).

Tabela 67. *Ku do të kërkonin ndihmë në rast kërcënimi për trafikim?*

Ku do të kërkonit ndihmë?	I	Përgjigjet e përzgjedhura					Shuma
		II	III	IV	V	VI	
Familja/shokët	709	2					711
Ambasada	609	169					778
IOM/UNHCR	382	439	96				917
Policia	482	379	346	58			1265
Nuk e di	144	33	21	5			203
Askund	47	4	3	4	3	3	64
Shuma	2373	1026	466	67	3	3	3938

Burimi: Anketa sociologjike me nxënës dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, 2006

Të anketuarit (2373 persona), kanë zgjedhur mesatarishë 1.7 alternativa përgjigjesh (gjithësej 3938 përgjigje). Reth 1/3 e tyre (32,1 për qind), lidhen me pohimin se në rast kërcënimi për trafikim ata do të shkonin në polici. Bën përshtypje fakti që 23.3 për qind e të anketuarëve pohojnë se, në një rast të tillë, do t'u drejtoheshin zyrave të IOM-it ose të UNHCR Rreth 20 për qind e të anketuarve pohojnë

se do t'u drejtoheshin ambasadave të vendeve të tyre. Ndërsa 18.1 për qind pohojnë se do t'u drejtoheshin familjeve ose shokëve.

Këto përgjigje dëshmojnë se individtë e anketuar, në rast kërcënimi për trafikim, e kërkojnë zgjidhjen më shumë tek institucionet. Sumë pak, prej tyre vetëm 1.6 për qind), pohojnë se një situatë të tillë do t'a zgjidhnin individualisht. Sidoqoftë, përqindja e të anketuarve që nuk dinë ku të drejtohen në një situatë kërcënimi nga trafikimi është relativisht e vogël. Ajo varion nga 8.6 për qind në Maqedonia në 2.1 për qind në Kosovë.

Anketa 'kombëtare' e përdorur

Numri i anketës.....

data

shteti

qyteti / fshati

kohëzgjatja në minuta

1. I ç'gjinie jeni?

1. Femër; 2. Mashkull

2. Ç'moshë keni?

1. 14 vjeç; 2. 15; 3. 16; 17

3. Arsimi që keni kryer apo vazhdoni:

1. I(e) pashkolluar; 2. Fillor; 3. 8 vjeçar; 4. I mesëm; 5. I lartë

4. Gjendja juaj civile:

1. Beqar; 2. I (e) martuar; 3. I (e) divorcuar; 4. I (e) ve

5. Në qendrën e sotme të banimit:

1. Keni banuar edhe para vitit 1990; 2. Keni ardhur pas vitit 1990

6. Shumicën e ditëve të javës i kaloni pranë familjes apo larg saj (dmth në konvikte, hotele, apartamente me grupe shoqesh/shokësh etj.)?

1. Pranë familjes; 2. Larg familjes

7. Në vitin 1990 familja juaj, ka qenë:

1. Me shumë kurora (çifte të martuarish); 2. Me një kurorë (dy prindër dhe fëmijët); 3. Me njërin prind (babai ose nëna).

8. Sot familja juaj është:

1. Me shumë kurora; 2. Me një kurorë; 3. Me njërin prind.

9. Cilit komunitet etnik i përkisni?

1. Shqiptar etnik; 2. Rom ose egjiptian; 3. Grek; 4. Vllah; 5. Maqedonas; 6. Të tjerë

10. Cilit besim fetar i përkisni?

1. Mysliman; 2. Ortodoks; 3. Katolik; 4. Bektashi; 5. Të tjerë

11. Cili është niveli juaj i besimit fetar:

1. Besoj shumë; 2. Besoj pak; 3. Jam indiferent; 4. Jam ateist

12. A jeni ndjerë, qoftë edhe njëherë në jetën tuaj, i/e rrezikuar për t'u trafikuar nga dikush:

a. I/e rrezikuar për t'u rrëmbyer me forcë, për prostitucion:

1. Po; 2. Jo.

b. Me mashtrime, përmes premtimeve për matesë:

1. Po; 2. Jo.

c. Me anë të premtimeve për punësim jashtë shtetit:

1. Po; 2. Jo.

d. Me premtime për vazhdimin e shkollës jashtë shtetit:

1. Po; 2. Jo.

e. Me premtime për të fituar SHPEJT para në rrugë të ndryshme

1. Po; 2. Jo.

f. Për t'u bërë lypës:

1. Po; 2. Jo.

g. Duke u joshur në rrugë të tjera:

1. Po; 2. Jo

13. (Vetëm për vajzat). Për një djalë që ju shpreh dashurinë, ju kërkon të fejoheni me të etj., e para ndjesi që përjetoni është:

1. Besimi se ai është i sinqertë; 2. Dyshimi se ai kërkon t'ju shfrytëzojë seksualisht; 3. Dyshimi se ai kërkon t'ju mashtrojë për t'ju trafikuar; 4. Dëshira për ta vënë në provë; 5. Nuk di ta vlerësoj.

14. Nëse jeni informuar për rreziqet e trafikimit, nga kush e keni marrë këtë informacion?

1. Nga nëna; 2. Nga babai; 3. Nga të afërm; 4. Nga mësuesit; 5. Nga media (gazeta, TV, radio); 6. Nga shokët/shoqet; 7. Nga një person që ka qënë më parë i trafikuar; 8. Nga shoqatat, shoqëria civile; 9. Nga të tjera burime; 10. Nuk jam informuar nga askush

15. Çfarë ju tremb më shumë për të ardhmen?

1. Varfëria; 2. Mungesa e fatit; 3. Një martesë e palumtur; 4. Përfshirja në trafik; 5. Droga; 6. SIDA; 7. Vdekja; 8. Lufta; 9. Fatkeqësitë natyrore; 10. Papunësia; 11. Të tjera

16. Në ç'masë trafikimi i grave dhe adoleshentëve është shqetësim për komunitetin tuaj?

1. Shumë shqetësim; 2. Pak shqetësim; 3. Aspak shqetësim; 4. Nuk di ta vlerësoj.

17. A njihni (personalisht ose me të dëgjuar) të paktën një person të trafikuar?

1. Po; 2. Jo.

Shënim: Pyetjet në vijim (18-22) janë vetëm për ata që kanë dhënë përgjigjen "PO".

18. Nëse "PO", trafikimi i tij/saj u realizua:

1. Me mashtrime, përmes premtimeve për martesë; 2. U rrëmbyer me force nga dikush; 3. U mashtrua me premtime për punësim jashtë shtetit; 4. U mashtrua me premtime për vazhdimin e shkollës jashtë shtetit; 5. U mashtrua me premtime për të fituar shpejt para, në rrugë të ndryshme; 6. U trafikuar për t'u bërë lypës; 7. U josh nga premtimet për të parë botën; 8. U trafikua me joshje, mashtrime apo në rrugë të tjera.

19. Referuar këtij rasti konkret, ç'moshë kishte i(e) trafikuari (a):

1. 12-15 vjeç; 2. 16-18; 3. 19-21; 4. Mbi 21 vjeç.

20. Referuar këtij rasti konkret, ç' nivel arsimor kishte:

1. I (e) pashkolluar; 2. Fillor 3. Deri 8 vjeçar; 4. I mesëm; 5. I lartë

21. Referuar këtij rasti konkret, ky person në kohën e trafikimit ishte:

1. I/e punësuar; 2. I papunësuar ndonjëherë; 3. Nxënës(e) ose student(e); 4. Minoren (nën 16 vjeç) që kishte braktisur shkollën

22. Referuar këtij rasti konkret, ky person në kohën e trafikimit, jetonte:

1. Me të dy prindërit; 2. Vetëm me nënën; 3. Vetëm me babain; 4. Bashkëjetonte me një partner; 5. Me bashkëshortin(en); 6. Më vete, me të afërm, në konvikte, jetimore etj.

23. A njihni, një PERSON të trafikuar por të kthyer në shtëpi?

1. Po; 2. Jo.

24. Nëse "Po", ç' qëndrim ka mbajtur familja e tij dhe shoqëria?

1. Familja e mirëpriti, por jo komuniteti; 2. Komuniteti e mirëpriti, por jo familja; 3. E mirëpriten së bashku; 4. Nuk e mirëpriti as familja, as komuniteti; 5. Nuk di ta vlerësoj

25. Sipas jush, cili nga fenomenet e mëposhtme shqetëson më shumë shoqërinë e sotme shqiptare:

1. Korrupsioni; 2. Moszbatimi i ligjeve; 3. Trafikimi i femrave/adoleshentëve; 4. Kriminaliteti 5. Përdorimi i drogës; 6. Niveli i ulët i shkollës; 7. Varfëria/papunësia; 8. Mënyra e të bërit politikë; 9. Shoqëria civile e dobët; 10. Konfliktet në familje.

26. Vini "notën" e vleresimit për faktorët që ndikojnë negativisht në trafikim. Shënoni nga 1 (ndikim negativ shumë i madh) deri në 10 (ndikim negativ të papërfillshëm):

- a: Mungesa e stabilitetit politik
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).
b: Varfëria

- (1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).
- c: Papunësia
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).
- d: Dobësimi i familjes
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).
- e: Statusi i ulët i femrës në shoqërinë shqiptare
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).
- f: Dhuna mashkullore ndaj grave
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).
- g: Mungesa e shpresës
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).
- h: Synimi për tu martuar me çdo kusht
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).
- i: Dëshira e papërmbytur për para, te djemtë
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).
- j: Dëshira e papërmbytur për para, te vajzat
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).
- k: Degradimi moral i femrave që trafikohen
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).
- l: Degradimi moral i meshkujve trafikantë
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10)
- m: Ndikimi i shtetasve të huaj
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10)

27. Vini “notën” e vlerësimit për punën e institucioneve të mëposhtme kundrejt trafikimit (nga 1-vlerësim shumë i keq në 10-vlerësim i shkëlqyer):

- a: Qeveria shqiptare
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).
- b: Policia
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).
- c: Gjykatat dhe Prokuroria
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).
- d: Shoqata, Organizata Jo-qeveritare
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).

- e: Komunitetet qytetare dhe opinioni publik
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).
- f. Mediat
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).
- g: Komunitetet fetare
(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 ose 10).

Anketa 'rajonale' e përdorur

Numri i anketës
data
Emri i shkollës
Lloji i shkollës
1. Shteti
2. Qyteti/qarku

Plotësoni kutinë me numrin që i korrespondon përgjigjes suaj. Ju lutem zgjidhni vetëm një përgjigje për çdo pyetje (përveç pyetjes numër 27). Nëqoftëse më shumë se një përgjigje duket e saktë, atëherë zgjidhni atë që duket më e saktë:

3. Keni marrë pjesë në ndonjë kurs apo aktivitet mbi trafikimin e njerëzve:

1. Po; 2. Jo.

4. Gjinia:

1. Femër; 2. Mashkull.

5. Moshë:

1. Deri në 12 vjeç; 2. 13-14; 3. 15-16; 4. 17-18; 5. 19 -21;

6. Ku jetoni?

1. Qytet (qytezë); 2. Fshat.

7. Keni qenë ndonjëherë jashtë shtetit?

1. Po; 2. Jo.

8. Nëqoftëse po, ishit për:

1. Pushime; 2. Punë; 3. Studime; 4. Jetova jashtë me prindërit; 5. Tjetër

9. Keni dëgjuar për trafikimin e njerëzve?

1. Po; 2. Jo; 3. Nuk jam i/e sigurt

10. Nëse “po”, nga kush keni dëgjuar për herë të parë?

1. Nga media (TV, radio, gazetat, etj); 2. Shokë/Shoqe; 3. Familja; 4. Mësuesit; 5. Tjetër

11. Sipas jush, cili nga përkrahjet e mëposhtme është përcaktimi më i saktë i trafikimit:

1. Të transportosh një fëmijë jashtë për të lypur, me forcë ose nën kërcënimin e forces; 2. Të mos i paguash rrogën ose të paguash më pak se është premtuar një emigrant pune jashtë; 3. Të transportosh një person për shfrytëzim seksual ose shfrytëzim për punë, me forcë ose nën kërcënimin e forcës; 4. Të detyrosh një njeri me forcë të punojë si prostitutë; 5. Nuk e di.

12. Sipas jush, pohimet e mëposhtme janë apo nuk janë të vërteta :

- a) “Një djalë/burrë mund të jetë viktimë e trafikimit”
1. E vërtetë; 2. E pavërtetë; 3. Nuk di ta vlerësoj.
- b) “Trafikimi gjithmonë përfshin prostitucionin ose shfrytëzimin seksual”
1. E vërtetë; 2. E pavërtetë; 3. Nuk di ta vlerësoj.

13. Situata: Një fëmijë 10-vjeçar jetonte në një familje jashtëzakonisht të varfër, me dy prindër të papunë dhe shumë motra e vëllezër. Një ditë prindërit i propozuan fëmijës të shkonte me një mik të familjes në një vend perëndimor dhe me të ardhurat që do të fitonte nga puna të ndihmonte familjen. Fëmija pranoi me gadishmëri dhe u nis me mikun e familjes. Është ky fëmijë viktimë e trafikimit apo jo? Lutemi të zgjidhni vetëm një nga përgjigjet e mëposhtme:

1. Po, edhe pse fëmija pranoi, ai/ajo është shumë i vogël për të marrë një vendim të tillë; 2. Po, sepse në këtë mënyrë, fëmijë nuk do të mund të arsimohet; 3. Jo, sepse familja ra dakort që fëmija të largohej; 4. Jo, sepse fëmija dëshironte të largohej; 5. Nuk di ta vlerësoj

14. Keni dëgjuar ndonjëherë për kontrabandën e qënieve njerëzore?

1. Po ; 2. Jo ; 3. Nuk e di.

15. Nëse « po », nga kush keni dëgjuar mbi të?

1. Media (TV, radio, gazetat, etj.); 2. Shokë/Shoqe; 3. Familja; 4. Mësuesit; 5. Tjetër

16. Sipas jush, cili nga përshkrimet e mëposhtëme është përcaktimi më i saktë i kontrabandës së qënieve njerëzore

1. Kur një person hyn ilegalisht me ose pa dokumenta, apo me dokumenta fallco, në një vend tjetër, në të cilin ai nuk është shtetas apo banor; 2. Kur një person paguan dikë tjetër ta ndihmojë për të hyrë ilegalisht në një vend tjetër, në të cilin ai nuk është shtetas apo banor; 3. Kur një person udhëton ligjërisht në një vend tjetër ku ai ose ajo nuk është shtetas ose banor dhe punon pa leje pune; 4. Kur një person hyn ligjërisht në një vend tjetër ku ai ose ajo nuk është shtetas ose banor dhe i duhet të punojë atje nën kërcënim pa marrë rrogë; 5. Nuk e di.

17. Sipas jush, pohimet e mëposhtëme janë apo nuk janë të vërteta :

a) “Është e kundraligjshme të marrësh para për të ndihmuar dikë që të kalojë ilegalisht kufirin kombëtar”

1. E vërtetë; 2. E pavërtetë; 3. Nuk e di.

b) “Kontrabanda në më të shumtën e rasteve ndodh nën forcë ose nën kërcënimin e forcës”

1. E vërtetë; 2. E pavërtetë; 3. Nuk e di.

18. Një burrë ka paguar dikë ta ndihmojë të kalojë kufirin e vendit të këtij personi ilegalisht. Më vonë ai është detyruar me forcë të punojë për llogari të dikujt tjetër. Është kjo një situatë:

1. Trafikim; 2. Kontrabandë; 3. Të dyja; 4. Nuk e di

19. **Situatë:** Një djalë 22-vjeçar i shpreh dëshirën për t'u martuar një vajze 19 vjeçare. Ai paguan një burrë dhe një grua të hiqeshin si prindërit e tij dhe të shkonin te familja e vajzës që të bënin një propozim zyrtar për martesë, derisa familja e vajzës dhe vajza të pranonin. Djali

dhe vajza shkojnë jashtë, por një javë më vonë, djali e nxjerr vajzën në rrugë të shesi trupin e saj. Vajza e kupton situatën në të cilën ndodhet, por nuk mund t'i shpëtojë. Ajo bëhet prostitutë, duke pritur ditën kur ajo do të mund te shpëtohet. Si do ta përshkruanit situatën e kësaj vajze:

1. E martuar; 2. E mashtruar dhe e abuzuar, por jo një viktimë e trafikimit; 3. Një viktimë e trafikimit; 4. Nuk e di

20. Një burrë nga një fshat i thellë malor, i punësuar jashtë, i kërkon një shoku të tij, një studenti 18-vjeçar, të linte shkollën dhe të shkonte jashtë, në vendin ku ai ishte punësuar për shumë vitesh. Studenti pranoi dhe filloi punë në një fabrikë. Koha kalonte por ai nuk merrte rrogë. Kur ai vendosi t'a linte punën, roja duke i vënë armën në kokë i thotë: "Ne kemi paguar shumë para për të të sjellë këtu. Na i kthe paratë dhe ne do të lejojme të largohesh, përndryshe..." Një vit më vonë djali vazhdonte të punonte nën të njëjtat kushte. Është ky djalë viktimë e trafikimit?

1. Po; 2. Jo; 3. Nuk e di.

21. Një vajzë e talentuar në mësimë kishte shumë dëshirë për të vazhduar studimet në një shkollë prestigjioze jashtë. Shoku i saj, një person i pasur që punonte jashtë, i tha t'a merrte me vete. Vajza pranoi, por i dashuri doli mashtrues. Ai e detyroi atë të bëhej prostitutë. Si do ta vlerësonit këtë situatë?

1. Trafikim; 2. Mashtrim, por jo trafikim; 3. Nuk e di.

22. Burrë e grua, të martuar, kanë dy fëmijë të vegjël. Por burri vdiq në një aksident automobilistik, gruaja mbeti e vetme me fëmijët. Ajo ishte e paarsimuar, nuk kishte punuar kurrë dhe nuk kishte askënd nga familja për ta ndihmuar. Ajo u përpoq të gjente punë të thjeshta, deri të lypte në rrugë, por në fund ajo i kërkoi shitësit të dyqanit ta lejonte të merrte ushqime me listë. Një natë shitësi erdhi në shtëpinë e gruas për të kërkuar paratë. Kur ajo i shpjegoi se akoma nuk i kishte, ai i kërkoi të bënte seks më, në këmbim. Ajo refuzoi. Por një ditë djali iu sëmur rëndë. Ajo nuk kishte para për të paguar doktorin. Shitësi vazhdon të presionin, derisa ajo pranoi.

a) Sipas jush, kjo grua është:

1. Viktimë e trafikimit; 2. Prostitutë; 3. Një grua e varfër, e shfrytëzuar nga të tjerët; 4. Nuk e di

b) Sipas jush, shitësi është:

1. Një burrë që ndihmon një femër në një moment të dobët;
2. Një burrë i cili përfitoi nga një grua në një moment dobësie;
3. Një trafikant;
4. Një tutor;
5. Nuk e di

23. Cili nga situatat e mëposhtëme, të ndodhura brenda familjes ose jashtë saj, mund të konsiderohen si dhunë në familje - që do të thotë, mund të konsiderohet dhunë nga partnerë të afërt dhe nga pjesëtarë të familjes?

a) Një burrë që në mënyrë të vazhdueshme poshtëron gruan e tij në mes të njerëzve të tjerë dhe i thotë gjëra agresive asaj gjatë gjithë kohës, disa herë duke e kërcënuar se do të largohet nga ajo, do ta abandonoj atë.

1. Po;
2. Jo;
3. Nuk e di

b) Kur një vajzë kryen marrëdhënie seksuale me shokun e saj vetëm se ai e detyron atë ta bëj një gjë të tillë.

1. Po;
2. Jo;
3. Nuk e di

c) Kur një burrë refuzon ta lejojë gruan e tij të vizitojë familjen e saj ose shoqërinë.

1. Po;
2. Jo;
3. Nuk e di

24. Sipas jush, sa e zakonshme është për emigrantët e punës të ballafaqohen me situatat e mëposhtëme:

a) Ato marrin një shkollim të mirë dhe/ose një punë të mirë:

1. Ndodh shpesh;
2. Ndodh;
3. Nuk ndodh kurrë;
4. Nuk e di.

b) Ata trajtohen keq nga njerëzit në vendin e ri sepse ata janë ndryshe:

1. Ndodh shpesh;
2. Ndodh;
3. Nuk ndodh kurrë;
4. Nuk e di.

c) Punëdhënësi jashtë refuzon të paguajë punëtorin në fund:

1. Ndodh shpesh;
2. Ndodh;
3. Nuk ndodh kurrë;
4. Nuk e di.

d) Ata bëhen të pasur:

1. Ndodh shpesh;
2. Ndodh;
3. Nuk ndodh kurrë;
4. Nuk e di.

25. Çfarë do të bënit ju nëse një i njohuri ose shoku juaj, ju ofron një punë jashtë?

1. Të pranoja, me kusht që puna të ishte e ligjshme ; 2. Ta konsideroj këtë punë edhe pse nuk e di ligjshmërinë e saj; 3. As nuk

duhet të konsiderohet diçka e tillë sepse nuk do të mund ta verifikoj/riverifikoj punën; 4. Refuzoj punën; 5. Nuk e di.

26. Motrës tuaj i është propozuar martesë nga një burrë që e ka njohur për pak kohë, me propozimin se ata do të jetonin jashtë. Si do ta këshillonit ju motrën tuaj?

1. Do ti thoja ta pranonte menjëherë, si një shans për një jetë më të mire; 2. Do ti thoja ta diskutonte me familjen dhe shokët e saj dhe të kërkonte më tepër mbi njeriun dhe situatën në vendin e ri, përpara se të vendoste; 3. Do ta këshilloja atë ti thoshte “jo”; 4. Nuk e di.

27. Nëse ju do të punonit jashtë si një emigrant pune dhe të bëheshit viktimë e kërcënimeve dhe shfrytëzimit, dini ku të kërkonte ndihmë? (Zgjidhni sa më shumë përgjigje ju pëlqejnë)

1. Po, do të shkoja tek familja dhe shokët për mbështetje; 2. Po, do të shkoj në Ambasadën e vendit tim; 3. Po, do të kërkoja ndihmën e organizatave si IOM dhe UNHCR; 4. Po, do të shkoja tek Policia; 5. Jo, nuk e di ku të kërkoj ndihmë dhe nuk i di shërbimet në dispozicionin tim; 6. Nuk do të kërkoja ndihmë

Bibliografia

- Arlecchi, Pino. 2000. *Parathënie e Skllavet e Perëndimit*. Tiranë: Korbi
- Alia, Ramiz. 1986. *Raport to the 9-th congress fo the Party of Labour of Albania*. Tiranë: 8 nëntori
- Beard, Mary and Henderson, John. 1997. Sacret Prostitution in Antiquity. *Gender and History*, 93, pp. 480-503
- Bagnall, S. R. 1991. The Prostitution Tax in Roman Egypt. *Bull. Am. Soc. Papyr* 28, pp. 5-12
- Benzi, Don Oreste. 2003. *Prostitutat do t'ju kalojnë pranë në mbretërinëqiellore*. Tiranë: Marin Barleti.
- Beqja, Hamit & Lekë Sokoli. 2003. *Divorci, vrojtime e refleksione*. Tiranë: Dudaj & Rinia.
- Brown, P. 1990. Plots and Prostitution in Greek New Comedy. *Pap. of Leeds Int'l Semminar* 6, pp. 241-266
- _____. 1993. Love and Marriage in Greek New Comedy. *CQ* 43, pp. 184-205
- Bryan, J. James. 1968. Apprenticeships in Prostitution. *Sociology and everyday life*. New Jersey: Prentice Hall INC, pp. 257-268
- Çupi, Alma. 2001. *Prostitucioni, epidemi pa fund*. Gazeta Albania: 18 prill
- CRCA (Children's Human Rights Center of Albania). 2003. *Trafikimi i fëmijëve në Shqipëri*. Tiranë, qershor.
- Dervishi, Zyhdi. 2000. *Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe perspektiva*. Tiranë: Dora D'Istria".
- DeMause, L. 1982. *Foundations of Psychohistory*. New York: Creative Roots, Inc.
- De Sotto, Harmine, Sabine Beddies & Ilir Gëdeshi. 2005. *Roma and Egyptians in Albania. From Social Exclusion to Social Inclusion*. World Bank, Washington DC.
- Drobler, C. 1991. Women at Work: reader for 1st European Prostitutes Congress Frankfurt October 16-18th.
- Durham, Edith. 1990. *Brenga e Ballkanit*. Tiranë: 8 nëntori
- Edwards, Catharine. 1997. Unspeakable Professions: Public Performance and Prostitution in Ancienr Rome, in *Roman Sexuality*, edited by Hallett et. al, USA, Princeton: Princeton University Press, pp. 66-95
- Fantham, E. 1975. Sex, Status, and Survival in Hellenistic Athens: A Study of Women in New Comedy. *Phoenix* 29, pp. 44-74

- Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*. 1985: Tiranë: Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.
- Flemming, Rebeca. 1999. Quae corpore quaestum facit: the Sexual Economy of Female prostitution in the Roman Empire, *Journal of Roman Studies* 89, pp. 38-61
- Fletorja zyrtare, nr. 30, gusht 1922, fq. 4
- Ford, Massyngberd, J. 1993. Prostitution in the Ancient Mediterranean World. *Biblical Theology Bulletin* 23, pp. 128-184
- Gazeta *Express*, 8 korrik 2005.
- Gazeta *Korrieri*, 24 dhjetor 2000.
- Gazeta *Shekulli*, "E masakruara "Stela" që denoncoi agjentët e antitrafikut". 2 gusht 2005.
- Gjedia, Robert, Ruth Rosenberg, Ana Bergtsson & Silvana Haxhia. 2005. *Trafficking Prevention Training Module for Teachers*. Tirana: International Organisation for Migration.
- Gjermeni, Eglantina & Majlinda Bregu. 2003. *Monitorimi i shtypit mbi dhunën në familje 2001-2002*. Tiranë: Publikuar nga Qendra e Gruas
- Gëdeshi, Ilir & Lekë Sokoli. 2006. "Vështrim sociologjik mbi trafikimin e grave dhe adoleshentëve në Shqipëri". Rervista *Gaia*, Nr. 2.
- Gëdeshi, Ilir, et al. 2004. *Romët dhe evgjijtët në Shqipëri*. Tiranë: Banka Botërore
- _____. 2005. "Roli i kapitalit social si faktor i zhvillimit lokal në Shqipëri" (Bilanci i OJQ-ve të Shkodrës), *Arcadia*, 6-12.
- _____, Hermine De Soto, Peter Gordon & Zamira Sinoimeri. 2002. "Vlerësimi cilësor i varfërisë në Shqipëri", *Politika & Shoqëria* (2002), 5, 1(10): 21-38
- _____. 2002. "The Role of Remittances from Albanian Emigrants and their Influence in the Country's Economy", *Eastern European Economics* (2002), 40 (5).
- _____. 2000. "Roli i remitançave të emigracionit shqiptar dhe ndikimi i tyre në ekonominë e vendit", *Poliëika & Shoqëria*, 3, 2(7): 55-68.
- Hëna e Re. 2006. *Pabarazia, dhuna ndaj grave e trafikimi*. Elbasan: Qendra e gruas.
- Horton B. Paul, Leslie R. Gerald, Larson F. Larson. 1991. *The Sociology of Social Problems*, New Jersey: Printice-Hall, Inc.
- Housel, Samuel, J. 1998. Eros and Aphrodisia in the Works of Dio Chysostom, *Classical Antiquity* 29.
- Hoxha, Edmond. 2005. Mbi femrat e zhdukura në Shqipëri. *Gazeta Metropol*, 21 korrik
- INSTAT, 2003. *Vjetari statistikor 1993-2001* (Të dhënat e regjistrimit të popullsisë dhe të banesave të vitit 2001). Tiranë
- Kadare, Ismail. 2000. Moda antishqiptare dh ndërjegjia europiane. Revista *Politika & Shoqëria*. Vëll. 3, Nr. 2(7): 5-8
- Katro, Jeta & Liri Shimani. 1999. *Prostitucioni dhe trafiku i gruas në Shqipëri*. Tiranë: Lilo

- Këshilli i Evropës. 2006. *Konventa mbi trafikimin e qënieve njerëzore* (broshurë). Tiranë: KE
- Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë* (KF). 2003. Tiranë: Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë* (KPP). Tiranë: Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
- Kuteli, Mitrush. 2001. “Vjeshta e Xheladin Beut”, në *Prozë dhe vargje të zgjedhura*, Vëll. 1, Tiranë: SHB Kuteli
- Leskaj, Valentina, Edmond Dragoti, Theodhori Karaj & Fiona Todhri. 2004. *Shoqëria shqiptare përballë sfidave të trafikut të grave dhe vajzave*. Tiranë, qershor
- McGinn, Thomas, A.J. 2002. *Prostitution, Sexuality, and the Law in Ancient Rome*. Vanderbilt University
- Monteskjë, Charl. 2004. *Madhështia dhe rënia e romakëve*. Tiranë: fan Noli
- Moroli, Emanuela & Roberta Sibona. 2000. *Skllavet e Perëndimit. Pas gjurmëve të tregtarëve të mishit të bardhë*. Tiranë: Korbi
- OKB. 1948/1998. *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*. Tiranë: Botim i Qendrës Shqiptare të të Drejtave të Njeriut.
- ORT. 1998. *Albanian's road to democracy. A fascinating Country in Transition*. Washington DC, July
- Papa, Asti. 2004. Zhak Burkari, Shqipëria dhe shqiptarët. *Politika & Shoqëria*, Vëll. 7, Nr. 2(14), fq. 136-138
- Qendra e Gruas Shkodër (QGSH). 2002. *Mbi kushtet e jetesës së grave në qytetin e Shkodrës*. Shkodër: Volaj.
- Revista *Spektër*, (Spektër, 2003). Prostitucioni, holokausti shqiptar. Nr. 171, 19 prill, fq. 19-21
- Raufer, Xavier & Stefane Quere. 2003. *Mafia shqiptare - një rrezik për Europën*. Tiranë: Kumi.
- Robinson, E. Cyril. 1963. *A history of Rome*. London: Methuen & Co LTD
- Rosenberg, Ruth, Silvana Haxhijaj, Ilir Gëdeshi & Lekë Sokoli, 2006. “Trafikimi, ndikimi i informimit dhe edukimit në perceptimin e parandalimin e tij (Sondazh rajonal). Revista *Politika & Shoqëria*, Vëll. 9, Nr. 1(16), fq. 11-26.
- Rush, F. 1980. *The best kept secret: Sexual abuse of children*. New York: McGraw-Hill Book Company.
- Sokoli, Lekë. 1999. *Droga, historia, përkufizime, klasifikimi, përhapja, efektet, terapia*. Tiranë: Onufri & Fondacioni Soros.
- _____. 2003. Prostitution and the Human Rights. In *Balkan Yearbook of Human Rights*, pp. 174-195
- _____. 2004a. Prostitucioni, një studim ‘klandestin’ për një biznes klandestin. Revista *Politika & Shoqëria*, Vëll. 7, Nr. 1 (13): pp. 21-37.
- _____. 2004b. Familja tradicionale shqiptare dhe alternativat “jo-tradicionale” të saj.

- Revista *Politika & Shoqëria*, Vëll. 7, Nr. 2 (14): pp. 15-27.
- _____. 2005b. Prostitucioni profesionist në Shqipëri dhe debatet rreth (kqe)vlerësimit “prostitucioni është një fenomen tipik shqiptar!”. Revista *Të drejtat e njeriut*. Nr. 2(42), pp. 55-72.
- _____. 2006a. “Babai dhe vajza e trafikuar”, *Tirana Observer*, 21 maj.
- _____. 2006b. “Integrimi dhe morali tradicional”, *Tirana Observer*, 17 gusht.
- _____. 2006c. “Shtëpitë publike në Shqipëri”, *Tirana Observer*, 24 gusht.
- _____. 2006d. *Prostitucioni si profesion (Vështrim sociologjik)*. Tiranë: Rinia & Instituti i Sociologjisë.
- Sulstarova, Enis. 2006. *Arratisje nga Lindja*. Tiranë: Botimet Dudaj.
- Surtees, Rebecca. 2005. *Second Annual report on Victims of Trafficking in South Eastern Europe*. Geneva: International Organisation for Migration (IOM).
- The Code of Lekë Dkagjini* (Kanuni i Lekë Dukagjinit). 1989. New York: Gjonlekaj Publishing Company
- Tushi, Gëzim. 2006. *Probleme dhe dilemma sociale. Studime sociologjike*. Tiranë: Botimet Dudaj.
- Vatra - Qendra Psiko-Sociale. 2002. *Vajzat dhe trafikimi*. Vlorë: Vatra
- UNDP. 1998. *Raporti i zhvillimit njerëzor në Shqipëri*, Tiranë, maj
- _____. 1999. *Albanian National Women Report*. Tiranë, dhjetor
- UNICEF. 2000. *Gratë dhe fëmijët në mileniumin e ri-Shqipëria*. Tiranë, dhjetor.
- Zholi, Albert. 2002. Greqia, tregu illegal i prostitutave shqiptare. *Gazeta Ballkan*: 15 dhjetor
- Zingarelli, Nicola. 1970. *Vocabolario della lingua italiana*. Bologna: Zanichedi SPA
- Webster's Encyclopedic Unabridged Dictionary of English Language (New Revised Edition). 1989

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Sokoli, Lekë

Trafikimi : rasti i Shqipërisë / Lekë Sokoli, Ilir Gëdeshi. -
Tiranë : Rinia, 2006.

146 f. ; 14.5 x 20.5 cm

ISBN 99943-937-0-7

I. Gëdeshi, Ilir

316.33(496.5) :343.43

351.76(496.5) "1991/2005"

ISBN 99943-937-0-7

Çmimi: 500 Lekë